

ISH-USHTARAKET, SI MERRET PENSIONI ME LIGJIN E RI

Zbardhet sqarimi i ISSH për përfitimin e pensionit të pleqërisë. Ish ushtarakët me 15 vite punë pension të parakohshëm. Shembulli sa përfitohet në çdo rast

► FAQE 9



FADIL KEÇI: PËRFITIMET E DETYRIMET E PENSIONISTËVE QË PUNOJNË NË PRIVAT

Eksperti i çështjeve të pensioneve sqaron qytetarët në Report TV. Si merret pensioni i invaliditetit, procedura e dokumentat

► FAQE 8

[SHQIPTARJA.com]

RRITET TENSIONI

LLALLA SULMON LU, DOSJA I KALON TEK KRIMET E RENDA, PRITET ARRESTIMI?

Çështja për ish-kryeprokurorin do hetohet në Tiranë, nën hetim për 4 akuza. Deklarata e Llallës: Lu të ndalet! Po sillet si prokuror e gjykatës në Shqipëri

► FAQE 7

OPINIONI NE SOCIAL MEDIA

“Dënimi i Berishës, shenja e parë që drejtësia shqiptare po ndryshon”

Vendimi i gjykatës së Tiranës për të ndëshkuar ish-kryeministrin jehonë pozitive, shihet si një hap i parë për ndryshimin e drejtësisë, ja reagimet në Facebook

► FAQE 5



SUPLEMENTI "RILINDASI"

TAVA E ELBASANIT, FAMA QE I DHA MEHMETI II KUR PUSHTOI KRUIJEN

Kulinaria, Ushqimi dhe mënyra e të ngrënit tradicional në Shqipëri në shekullin XV-XX

NGA DR. ARIOLA PRIFTI



"ANIJA VLORA", SI SILLESHIN NË KUSHTE SEKRETI ABSOLUT RAKETAT NGA KINA NË DURRËS

NGA MARK BRUNGA

IDENTITE TË LËVIZSHME, RASTI I ELENA GJKËS NË LËVIZJEN KOMBËTARE SHQIPTARE

NGA DR. DORIAN KOÇI



INTEGRIMI

► FAQE 2

Mediat gjermane: KE hap negociatat e Shqipërisë me BE

NDRYSHIMET NË STATUT

► FAQE 3

Ndëshkim kush tradhton PD, veprimet që ndalohen

RAPORTI I PAZAKONTË

► FAQE 4

Avokatja e Popullit hakmerret për pallatin e Bashës

LOBIMI / RAMA DO TAKOJË MERKEL DHE MACRON

Mediat gjermane: KE hap negociatat e Shqipërisë me BE-në

Komisioni Evropian do të rekomandojë hapjen e negociatave të anëtarësimit për dy vendet ballkanike, Shqipërinë dhe Maqedoninë. Ndërkohë Komisioni vendosi një barrierë të madhe në rrugën e Turqisë drejt bisedimeve për anëtarësim, pasi tha se Ankaraja zyrtare ka ndërmarrë hapa seriozë që e largojnë nga Bashkimi Evropian. Rekomandimi për Maqedoninë nuk është surprizë pasi prej kohësh kishte ardhur "OK" nga Komisioni, por Greqia e kishte bllokuar për shkak të problemit të emrit të këtij shteti. Mediat gjermane që kanë publikuar pjesë të raportit, shkruajnë se në dokument theksohet perspektiva për anëtarësim për gjashtë vendet e Ballkanit Perëndimor. Negociatat po zhvillohen aktualisht me Serbinë dhe Malin e Zi, ndërsa Komisioni kërkon që t'i

zgjerojë dhe në kuadër të progresit të arritur, ka rekomanduar hapjen e tyre edhe me Maqedoninë e Shqipërinë. Shefja e diplomacisë evropiane, Federica Mogherini do të vijë në Tiranë të martën 17 prill për të dorëzuar raport-progresin dhe më pas do të udhëtojë edhe në Shkup, ndërkohë që Komisioneri për Zgjerimin, Johannes Hahn do të qëndrojë në Bruksel për të komunikuar zyrtarisht vendimin e komisionit. Vetë prania e Mogherinit në Tiranë shihet si një konfirmim për një qëndrim pozitiv ndaj Shqipërisë. Komisioni kërkon që qeveritë e këtyre vendeve të mos lënë vend për dyshime për orientimin dhe angazhimin e tyre strategjik dhe të shfaqin vendosmëri e progres të pakthyesëm. Raporti për të gjithë kandidatët nga Ballkani Perëndimor dhe Turqinë, thekson korrupsionin dhe krimin e



Rekomandimi

KE do të rekomandojë hapjen e negociatave të anëtarësimit për dy vendet ballkanike, Shqipërinë dhe Maqedoninë.

organizuar si probleme shumë të theksuara. Pas rekomandimit, vendimi përfundimtar për hapjen e negociatave do të merret në qershor kur duhet të anashkalohej skepticizmi i Francës, Gjermanisë dhe Holandës, të cilat deri tani kanë qenë kritike ndaj Shqipërisë. Në javët në vijim pritet një punë intensive nga ana e kryeministrit Edi Rama, i cili do të takohet me Angela Merkel dhe Emanuel Macron për t'i bindur këta të fundit që të japin një mbështetje për Shqipërinë.



Gati vezët e patatet

Partia Demokratike ka organizuar dje një protestë në qytetin e Shkodrës me një grup tregtarësh të vegjël, të cilët kundërshtojnë përfshirjen në skemën e TVSH-së. Demokratët ishin informuar dy ditë më parë se kryeqendrën e veriut do ta vizitonte gjatë ditës së djeshme edhe kryeministri Edi Rama dhe kishin mobilizuar tregtarët, por një gjë e tillë nuk ka ndodhur. Protestuesit kishin vendosur ta prisnin Ramën me vezë dhe patate, me të cilat thanë se do godisnin kryeministrin. "Këto i kemi për Edi Ramën. Kemi edhe vezë. 140 kokrra do ia rrasim në luletë ballit. E meriton, kjo nuk ishte kurrë gja", tha një prej protestuesve. Protesta ishte njoftuar një ditë më parë nga dega e PD në Shkodër, ndërsa asistohet nga deputetët të PD. Dy ditë më parë, të rinj të PD dhe LSI i zunë pritë kryeministrin Edi Rama në Surrat.

REAGON KRYEMINISTRIA

Në reagimin e saj Kryeministria ka thënë që Rama nuk ka pasur asnjë plan për të vizituar qytetin e Shkodrës, dhe se vizita e tij ishte e supozuar dhe e shpikur nga Partia Demokratike. E gjithë kjo, thuhet në reagimin e Kryeministrit, është bërë për të nxjerrë një tension të kotë në luftën e dëshpëruar me pafuqinë e saj nga ana e PD. Dje Edi Rama ndodhej në qytetin e Vlorës për të marrë pjesë në takimin e planifikuar me rastin e 100-vjetorit të Shërbimit Stomatologjik në Shqipëri, thuhej në reagim. Nga ana e tij, deputeti i PD në Qarkun e Shkodrës, Bardh Spahia i cili ishte me protestuesit, postoi edhe një video në Facebook, nga ku deklaroi se kryeministri Rama kishte anuluar vizitën nga frika. "Kryeministri ka vendosur të anulojë vizitën e tij në Shkodër. Ai është trembur nga shkodranët. Jam këtu me të rinjtë dhe të

PD del bluf me protestën në Shkodër, Rama s'shkon

Sqarim i Kryeministrit: Edi Rama s'e kishte në plan. Reagon PD: Rama u tremb si frikacak nga protestuesit

→ BLOFI

Demokratët ishin informuar dy ditë më parë se kryeqendrën e veriut do ta vizitonte gjatë ditës së djeshme edhe kryeministri Edi Rama dhe kishin mobilizuar tregtarët, por një gjë e tillë nuk ka ndodhur.

→ KRYEMINISTRIA

Në reagimin e saj Kryeministria ka thënë që Rama nuk ka pasur asnjë plan për të vizituar qytetin e Shkodrës, dhe se vizita e tij ishte e supozuar dhe e shpikur nga Partia Demokratike.

rejat e Shkodrës që e trembën kryeministrin Rama. Le të vijë e të përballet me ta", tha deputeti demokrat Bardh Spahiu.

REAGON PD: RAMA FRIKACAK

Partia Demokratike reagoi me anë të një deklarate për mediat pas sqarimit të Kryeminis-

trisë se Rama nuk kishte planifikuar të vizitonte Shkodrën. Sipas selisë blu, Rama anuloi vizitën nga frika e përballjes me shkodranët. "Edi Rama u fsheh si frikacak sot nga shkodranët, duke anuluar vizitën e bërë publike një ditë më parë nga mediat e kontrolluara prej tij. I çekuilibruar psikologjisht, për shkak të protestave që po e ndjekin deri tek dera e shtëpisë, Edi Rama gënjeu sot publikisht shqiptarët, kur tha se nuk kishte në plan të shkonte në Shkodër, por në Vlorë. Kryeministria e ka shpërndarë njoftimin për axhendën e Edi Ramës në Shkodër tek disa nga gazetarët që mbulojnë aktivitetin e Ramës, tek Partia Socialiste e Shkodrës dhe deputetët e saj. PD u bën thirrje mediave të publikojnë mesazhet e shpërndara nga kryeministria, të jenë në lartësinë e misionit të tyre për të informuar publikun me vërtetësi dhe paanshmëri. Propaganda bajate nuk e mbulon dot as frikën e Ramës as nga shqiptarët, as faktin se, në çoroditje e sipër nga protesta e shkodranëve, gazetarët e Vlorës u lajmëruan me urgjencë nga Bashkia për praninë e Ramës në ceremoni vetëm 10 minuta para nisjes së saj", tha Partia Demokratike.



Ish e përndjekura: PD tradhtoi shkodranët, të kërkojë falje

Në protestën e zhvilluar nga ana e Partisë Demokratike në Shkodër, e cila u organizua për shkak të një vizite që kryeministri i vendit Edi Rama do të zhvillonte në Shkodër, ka pasur edhe zëra kundër demokratëve. Një zonjë e persekutuar në kohën e diktaturës është shprehur në mes të protestës se Partia Demokratike ka tradhtuar qytetarët e Shkodrës. "Një kjo PD që ne shkodranët e vjetër e të rinj e kemi dashur kaq fort, ka tradhtuar ideat tona. Që në



fillim askush nuk iu dha të drejta të persekutuarve politik. Po e them si njeriu që e ka dashur", tha ajo. Zonja në fjalë ka kërkuar që Partia Demokratike e Shkodrës duhet të kërkojë falje publike për tradhtinë që i ka bërë të persekutuarve nga diktatura. "Nëse nuk i kërkon falje qytetarëve të saj të tradhtuar, nëse nuk kërkon falje publike dhe nuk përcakton qartë, ne nuk duam as PD, as PS dhe asnjë parti tjetër, ne duam qeveri antikorruption dhe teknike", tha ai.

Ndëshkim kush tradhton PD, veprimet që ndalohen

Grupi i punës propozon futjen e konceptit të "dëmit ndaj partisë", ndalohet publikimi i informatave sensitive. Imami: Të vendoset qartë se kur ikën kryetari

ADRIATIK DOÇI
TIRANE

Kryesia e Partisë Demokratike u mbledh dje për të diskutuar mbi ndryshimet e mundshme në statutin e saj. Ndryshimet janë përgatitur nga një grup pune, ndërsa u lexuan para Kryesisë nga Sekretari i Përgjithshëm i PD, Arben Ristani. Krahas grupit të punës, i cili përfaqëson linjën e Lulzim Bashës, kundërshtarët e kryetarit të partisë kanë paraqitur dy paketa me propozime, për ndryshimin e statutit të PD. Ndryshimet e tyre konsistojnë në përsëritjen e zgjedhjeve për kryetarin Lulzim Basha si dhe në ndalimin e kryetarit për të rikandiduar nëse humbet zgjedhjet e përgjithshme parlamentare. Por tekta grupi kundërshtar kërkon largimin e kryetarit nëse humbet zgjedhjet, grupi i punës i përbërë nga Edi Paloka, Edmond Spaho, Arben Ristani, Enno Bozdo, Fatbardh Kadilli dhe Genti Malko, kanë propozuar masa për ata që tradhtojnë partinë. Konkretisht, është propozuar që një statusin e ri të përfshihet e konceptit të "dëmit ndaj partisë", si parim që përdoret nga CDU gjermane. Propozimi parashikon rastet kur anëtari kalon në grup tjetër parlamentar; merr pjesë në aktivitete të kundërshtarëve politikë; mban publikisht qëndrim kundër politikës së partisë, publikon informata konfidenciale dhe sensitive; shkel ligjet dhe kryen akte të rënda në kundërshtim me etikën qytetare.

IMAMI PAS MBLEDHJES

Anëtar i Kryesisë së Partisë Demokratike, Arben Imami, pas mbledhjes së djeshme, u shpreh se në statusin e ri duhet të vendoset qartë se kur ikën kryetari i partisë. "Duhet vendosur qartë sa palë zgjedhje duhet që një kryetar që të ikë. Të bëhet një deklaram statutor. Dokumenti politik ishte një përpjekje për të vazhduar. Ky është problemi, pasi vetë kryetari nuk ka një qëndrim të qartë në lidhje me kohëzgjatjen e mandatit. Unë personalisht nuk jam për zgjedhje çdo dy vite, por mendoj se në rast problemesh politike, mund të kërkohej votëbesim në çdo periudhë, ashtu siç është përshkruar në mënyrë mjaft të saktë nga drafti Harxhi-Kulluri", tha Imami. Arben Imami nuk la pa thumbuar edhe kryetarin Lulzim Basha lidhur me



Imami

"Duhet vendosur qartë sa palë zgjedhje duhet që një kryetar që të ikë. Të bëhet një deklaram statutor. Dokumenti politik ishte një përpjekje për të vazhduar. Nuk është e nevojshme që kryetari i partisë të zgjidhet çdo 2 vjet. Nëse humb zgjedhjet, ai duhet të largohet".



PROCESI ËSHTË UDHËHEQUR NGA DY PARIME:

- Sigurimi i hapësirave dhe garancive demokratike në parti
- Përfshirja në vendimmarrje e anëtarësisë.

BURIMET PËR REKOMANDIMET E NDRYSHIMIT TË STATUTIT VIJNË NGA:

- Propozimet e dala gjatë analizës
- Praktika e partive simotra në Gjermani dhe Britani
- Propozimet e dyflukseve të ndryshme, që kanë paraqitur platforme politike dhe draft statut krejt të ri
- Propozime individuale nga anëtarë, kryetarë degësh dhe anëtarë të forumeve të partisë.

Propozimi

Tekta grupi kundërshtar kërkon largimin e kryetarit kur humbet zgjedhjet, grupi i punës i përbërë nga Edi Paloka, Edmond Spaho, Arben Ristani, Enno Bozdo, Fatbardh Kadilli dhe Genti Malko, kanë propozuar masa për ata që tradhtojnë partinë.

Ja ndryshimet statutor brenda PD

-Propozimi për përfshirjen e anëtarësisë në procesin e përzgjedhjes së kandidatëve për deputetë. Kandidaturat, pa asnjë kufizim, që plotësojnë kriteret, kalojnë në filtrin e anëtarësisë përpara se institucionet qendrore, Kryesia dhe Këshilli Kombëtar të marrin vendimin përfundimtar.

-Ndryshimet u japin kompetenca të qarta organeve qendrore (Kryesi, Këshilli Kombëtar dhe Kuvend Kombëtar) për vendimmarrje të rëndësishme politike të partisë, duke përfshirë miratimin e propozimeve për kandidatura, për koalicionet dhe aleanca, për strategjitë dhe programet politike dhe elektorale.

-Vendosja e parimeve dhe garancive për zgjedhje transparente dhe demokratike në çdo nivel. Parimi i transparencës, garantimi i barazisë së kandidatëve në garë dhe garancia mbi kontrollin e procesit zgjedhor. Të detajohen plotësisht në Rregulloren e Brendshme të Partisë që duhet të miratohet nga Këshilli Kombëtar.

-Forcimin e rolit të institucionit të kontrollit të partisë, Komisioni Apelimt/Gjykatës, dhe ngritja e tij të bëhet që në mbledhjen e parë të Këshillit Kombëtar. Për të bërë një instrument real që ka besueshmëri për anëtarësinë është propozuar që Komisioni të jetë në nivel nacional.

-Standardet etike të bashkëjetesës dhe disiplinës së partisë. Futja e konceptit të "dëmit ndaj partisë", si parim që përdoret nga CDU gjermane dhe parashikon rastet kur anëtari kalon në grup tjetër parlamentar; merr pjesë në aktivitete të kundërshtarëve politikë; mban publikisht qëndrim kundër politikës së partisë, publikon informata konfidenciale dhe sensitive; shkel ligjet dhe kryen akte të rënda në kundërshtim me etikën qytetare.

-Rregullimet për ngritjen dhe funksionimin e Komitetit të Seleksionimit të Kandidaturave, që do të funksionojë mbi bazën e një rregulloreje të miratuar nga Këshilli Kombëtar. Është propozim i shpallur në projekt-statutin e dy anëtarëve të KK, i përshtatur për kushtet tona nga modeli origjinal i Artise Konservatore Angleze.

çështjen e lobimit rus. Imami tha se kishte kërkuar që në parti të ngrihej një bord për kontrollimin e financimeve

dhe shpenzimeve të partisë. "Propozova që të krijohet një bord që të kontrollojë financimet dhe shpenzimet e partisë",

u shpreh ai. Ndërkaq, gjatë mbledhjes, anëtarja e Kryesisë së PD, Endira Bushati ka kritikuar ndryshimet. "Nuk është

statuti problemi, e thamë edhe më parë. Problemi është si ta shndërrojmë partinë në fitimtare. Ta bëjmë një parti vlerash. Nuk është puna të seksionet dhe grup seksionet. Të dalim mbi veten e të gjejmë moton për publikun. Jemi qesharakë me kryetarët e degëve e grup seksionet dhe si vlerësojmë anëtarët", ka thënë ajo.

FABIAN TOPOLLAJ

Këshilltari i PD në Bashkinë e Tiranës, Fabian Topollaj ka reaguar pas përfundimit të mbledhjes së Kryesisë së PD për ndryshimet statutor. Sipas tij, Basha ka pranuar se ka manipuluar zgjedhjet në PD. "Të propozosh si ndryshime statutor vendosjen e rregullave si për shembull: realizimin e zgjedhjeve të lira brenda partisë; dhënie fuqi anëtarësisë dhe forumeve kolegjiale për zgjedhjen e përfaqësuesve partiakë; apo përjashtimin e anëtarëve që bashkohen me formacione të tjera politike, më e pakta është të pranosh që deri më tani partia as ka bërë zgjedhje të lira brenda saj, as nuk ka respektuar forumet dhe as ka vlerësuar kontributet e anëtarësisë që i ka qëndruar PD-së në ditë të lehta dhe të vështira", shkruan Topollaj.



Kreu i PD

Basha shpalos programin për bujqësinë në Elbasan



Kryetari i Partisë Demokratike bashkëbisedoi dje me fermerë dhe banorë të njësisë Administrative, Shushicë të Elbasanit, ndërsa ka shpalosur edhe programin për bujqësinë. Në vijim Basha u tha banorëve dhe fermerëve të Shushicës se vendosja e Nipt-it nga e ana e qeverisë ishte karriem për të vendosur TVSH për fermerët. "Të gjithë fermerët që bëjnë një xhiro prej 2 milionë lekë jeni subjekt i TVSH-së, njësoj si bizneset e tjera të vogla edhe ju, prandaj iu është kërkuar që të futet NIPT, pas NIPT-it do t'ju merret TVSH-ja. Nuk do të ndodhë vetëm me biznesin e vogël, do të ndodhë me këdo që përmbush këto kushte, të bësh mbi 2 milionë lekë xhiro. Prandaj plani për të vënë NIPT-in që pastaj t'ju regjistrojnë dhe t'ju matrikullojnë edhe ju dhe t'ju tatojnë edhe ju, të marrin TVSH-në njësoj siç ia marrin biznesit të vogël", u shpreh Basha.

Avokatja e Popullit hakmerret për pallatin e Bashës

Erinda Balanca 'nxin' IKMT dhe IMT, organet që prishën pallatin e vjehrrit të Bashës në Vlorë, ja 8 akuzat

ADRIATIK DOÇI
TIRANE

Avokatja e Popullit, Erinda Balanca, hakmerret për prishjen e pallatit të vjehrrit të Lulzim Bashës, në Vlorë, në të cilin kishte një apartament. Në raportin për veprimtarinë vjetore të Avokatit të Popullit, zonja Balanca kritikon ashpër Inspektoriatin Kombëtar të Mbrojtjes së Territorit (IKMT) dhe Inspektoriatin e Mbrojtjes së Territorit (IMT), dy organe këto që shembën në vitin 2013 pallatin e vjehrrit të Lulzim Bashës në Vlorë, për ndërtimin e Lungomares. Asokohe IKMT quhej INUK. Erinda Balanca, edhe si e dëmtuar në këtë proces, mbrojti në Strasburg vjehrrin e Bashës kundër Shqipërisë. Gjykata

e Strasburgut dënoi shtetin shqiptar, duke e detyruar t'u paguajë palëve të dëmtuara 14.2 milionë euro. Ndërkaq, Erinda Balanca, tashmë në pozicionin e Avokates së Popullit, 'nxin' IKMT dhe IMT, duke i konsideruar këto organe jo transparente dhe që kanë cenuar në mënyrë të përsëritur pronën private me ndërhyrjet e tyre. Avokatja e Popullit i kushton një kapitull të posaçëm veprimtarisë, sipas saj abuzive, të organeve përgjegjëse për mbrojtjen e territorit nga ndërtimet e kundërligjshme. "Në veprimtarinë e Inspektoriatit Kombëtar të Mbrojtjes së Territorit (IKMT) dhe Inspektoriatit të Mbrojtjes së Territorit (IMT), në bashki konstatohet mungesë transparence; raste të përsëritura të situatës së cenimit të pronës pa respektuar procedurën

e njoftimit zyrtar mbi vendimmarrjen konkrete ndaj subjektit përkatës; veprimtari e IKMT-së, fragmentare, jo analizuuese dhe jo reaguese, në rastet kur i kërkohet të ndërmerre veprime të caktuara, nga ana e institucioneve të tjera shtetërore gjë që çon në mungesën e zhvillimit të një procesi të rregullt dhe të ligjshëm administrativ, shpesh edhe me shkaktim dëmi, ndërkohë që vazhdon gjendja e mosreflektimit ndaj kësaj paligjshmërie, duke përkeqësuar situatën juridike të subjekteve që kanë në pronësi, ose posedim ndërtimesh me statuse të ndryshme ligjore", thuhet në raport.

RAPORT I VEÇANTË PËR IKMT

Avokatja e Popullit, Erinda Balanca, thotë gjithashtu se përpos kapitullit në raportin



Konstatimi

Erinda Balanca, tashmë në pozicionin e Avokates së Popullit, 'nxin' IKMT dhe IMT, duke i konsideruar organe jo transparente dhe që kanë cenuar në mënyrë të përsëritur pronën private me ndërhyrjet e tyre.

vjetor, është hartuar edhe një raport i veçantë mbi veprimtarinë e IKMT. Por, sipas saj, ky raport nuk është shqyrtuar nga Kuvendi. "Sikurse

kemi informuar në dy raportet paraardhëse më të fundit vjetore, nga ana e Avokatit të Popullit është përgatitur një raport i veçantë, mbi



Hakmarrja

Avokatja e Popullit, Erinda Balanca, hakmerret për prishjen e pallatit të vjehrrit të Lulzim Bashës, në Vlorë, në të cilin kishte një apartament, duke sulmuar me anë të një raporti IKMT.

veprimtarinë e IKMT-së, për periudhën Shtator 46 2014 - Maj 2015. Ky raport i është dërguar Kuvendit, në datën 22.12.2015. Raporti analizon veprimtarinë e IKMT-së, konkretisht për disa zona si ajo e Selitës, Tiranë (ku po zbatohet projekti i ndërtimit të unazës së re të qytetit); zona e Udenishtit, Pogradec, (ku po zbatohet projekti i rehabilitimit të segmentit rrugor Lin-Pogradec), si dhe zona e segmentit rrugor Rrogzhinë-Lushnjë. Raporti i Veçantë, mbi veprimtarinë e IKMT-së, për periudhën shtator 2014 - maj 2015, nuk është diskutuar ende në Kuvend, megjithëse problematika e tij mbetet ende aktuale për faktin se, veprimtaria e IKMT-së, vazhdon të mbetet në të njëjtat çështje problematike", thuhet në raport.

Raporti i Avokates së Popullit kundër IKMT dhe IMT

1. Konstatohet mungesë transparence në veprimtarinë e këtyre organeve, e referuar shpesh nga ankuesit në ankesat e tyre, por edhe e evidentuar konkretisht gjatë veprimtarisë sonë institucionale.

2. Konstatohen raste të përsëritura, kur ankuesit janë gjendur para situatës së cenimit të pronës së tyre, nga ndërhyrjet e IKMT-së, apo IMT-ve në bashki, pa u vënë në dijeni dhe pa patur paraprakisht një njoftim zyrtar, mbi vendimmarrjen për ndërhyrjen që do të kryhej. Kjo gjë ka cenuar të drejtën e ankuesve për zhvillimin e një procesi të rregullt ligjor.

3. Megjithëse në disa ankesa është kërkuar informacion i ndërthurur, qoftë nga ana e IMT ve në bashki, apo qoftë edhe nga ana e IKMT-së, konstatohet se mënyra e raportimit të IMT-ve pranë IKMT-së, për çështje konkrete mbetet problematike, pasi ka vonesa dhe shpesh mungesë informacioni në vartësinë vertikale të detyrimit ligjor në këtë rast.

4. Veprimtaria e IKMT-së, shfaqet fragmentare, jo-analizuuese dhe jo-reaguese, në rastet kur i kërkohet të ndërmerre veprime të caktuara, nga ana e institucioneve të tjera shtetërore. Në këto raste, IKMT-ja, shërben dhe duhet të shërbejë edhe si një filtër i ligjshmërisë së vendimmarrjeve paraprake të organeve të tjera, gjë që kërkon angazhimin e tij të drejtpërdrejtë administrativ, përmes ezaurimit të procedurave përkatëse administrative, në kuadër të zbatimit të ligjshmërisë në fushën e inspektimit të ndërtimit. Çdo procedurë

administrative që fillohet nga ana e IKMT-së, nuk duhet dhe nuk mund të trajtohet thjesht si zbatim i një vendimmarrje paraprake nga një organ tjetër, që vepron në një juridiksion të ngjashëm me atë të IKMT-së. Procedurat konkrete administrative, që duhet të zhvillohen rast pas rasti nga IKMT-ja, nevojitet të kenë si një element të domosdoshëm hetimin aktiv nga ana e vet këtij organi, të rrethanave, provave, veçantisë së problematikës së paraqitur, me qëllim që të parandalohen shkelje të ligjit. Nëse mungon kjo mënyrë veprimi, atëherë kemi mungesën e zhvillimit të një procedimi të rregullt dhe të ligjshëm administrative, sikurse konstatohet edhe mungesë bashkëpunimi dhe harmonizimi të nevojshëm të veprimtarisë me organe të tjera që veprojnë në fushën e urbanistikës.

5. Në procesin e prishjes së ndërtimeve informale, rezultojnë se lidhur me këto ndërtime, IKMT-ja, por edhe IMT-ja në bashki, kanë mangësi në procesin e verifikimit të procedurave ekzistuese të aplikimeve pranë organit të ALUIZNI-t, për legalizimin e objekteve, në të cilat ose është ndërhyrë me prishje, ose janë sanksionuar me vendime për prishje. Ky mosveprim bie ndesh me parashikimin e kryer në nenin 66/1, të Kodit të Procedurave Administrative, ndërkohë që konstatohet mungesë e bashkëpunimit dhe harmonizimit të nevojshëm të veprimtarisë së IKMT-së, me organe të tjera që veprojnë në fushën e urbanistikës dhe mbrojtjen e territorit.

6. Dëmi financiar i shkaktuar nga ana e IKMT-së, apo të IMT-ve në bashki, gjatë prishjes së objekteve

të ndërtuara me leje që, paraprakisht janë përfshirë në procesin e shpronësimit për interes publik, por që ende nuk kanë marrë vleftën e dëmshpërblimit që i takon, si dhe të objekteve informale të përfshira në procesin e legalizimit dhe për të cilat nuk ka patur ende vendimmarrje përfundimtare nga ana e ALUIZNI-t, përbën kosto shtesë që në mënyrë të kundërligjshme i shtohet detyrimeve që shteti duhet t'u paguajë në këto raste subjekteve të dëmtuara. Ky veprim e vendos veprimtarinë e këtyre organeve në kushtet e parashikuara nga ligji nr. 8510 datë 15.07.1999 "Për përgjegjësinë jashtëkontraktore të organeve të administratës publike", i ndryshuar.

7. Në këtë veprimtari, vërehen shkelje ligjore që cenojnë të drejta dhe liri të ligjshme të individit, ndërkohë që vazhdon gjendja e mosreflektimit ndaj kësaj paligjshmërie, duke përkeqësuar situatën juridike të subjekteve që kanë në pronësi, ose posedim ndërtime me statuse të ndryshme ligjore.

8. Në kundërshtim me përcaktimet ligjore, të dhëna në pikën "c", të nenit 21, të ligjit nr. 8454 datë 4.02.1999 "Për Avokatin e Popullit", i ndryshuar, nuk ka patur reagim nga ana e organeve eprore të drejtorive rajonale të IKMT-së, apo të IMT-ve në bashki, lidhur me rekomandime tonat mbi marrjen e masave disiplinore ndaj inspektorëve përkatës, të cilët kanë qenë në kushtet e refuzimit për bashkëpunim me Avokatin e Popullit, gjatë shqyrtimit të ankesave të caktuara nga ana e këtij të fundit.

“Dënimi i Berishës, shenja e parë që drejtësia shqiptare po ndryshon”

Vendimi i gjykatës së Tiranës për të ndëshkuar ish-kryeministrin jehonë pozitiv, shihet si një hap i parë për ndryshimin e drejtësisë, ja reagimet në “Facebook”

Dënimi i Sali Berishës nga gjykata e Tiranës për shpifje në dëm të gazetarit Carlo Bollino ka bërë një jehonë të madhe ne opinionin publik shqiptar. Fakti se është hera e parë që një gjykatë shqiptare merr guximin dhe dënon një figurë të një stature kaq të lartë si Sali Berisha ka sjellë reagime positive në shumicën e publikut shqiptar. Kjo duket mjaft qartë në komentet e qytetarëve të thjeshtë në rrjetet sociale si Facebook apo nëpër portalet informative, ku shumica e tyre e cilësojnë si një ndryshim pozitiv në drejtësinë shqiptare.



KOMENTET NE FACEBOOK

DËNIMI I BERISHËS

Për herë të parë në karrierën e tij të gjatë politike, Sali Berisha është dënuar nga një gjykatë shqiptare. Ish-kryeministri është dënuar më 11 prill për shpifje nga Gjykata e Tiranës me gjobë 1 milion lekë të vjetra dhe detyrimin për të paguar shpenzimet gjyqësore. Berisha është paditur para 2 vitesh për shpifje nga gazetari dhe botuesi Carlo Bollino për disa publikime me akuzë që ka bërë ish-kryeministri në adresën e tij zyrtare në Facebook dhe gjatë një interviste televizive. Akuzat që ka bërë publikisht Berisha ndaj gazetarit Bollino dhoma civile e gjykatës së Tiranës i ka cilësuar si shpifje duke e dënuar liderin historik të Partisë Demokratike. Padia e gazetarit Bollino nuk ishte e para që bëhej ndaj Sali Berishës, i cili është paditur disa herë nga gazetarë e politikanë për shpifje, por deri më tani asnjë gjykatës nuk kishte marrë guximin për ta dënuar. Berisha deri më tani ishte mbrojtur me pretendimin se si politikan që është deklaruar e tij janë politike ndaj nuk mban përgjegjësi ligjore si çdo qytetar i thjeshtë. Por në rastin e gazetarit Bollino, gjykata e Tiranës pranoi argumentin logjik se këtu nuk kemi të bëjmë me një betejë politike por çënimin e një qytetari të thjeshtë.

KOMENTET

Në komentet e shumta të qytetarëve të thjeshtë nëpër portalet informative por më tepër në rrjetin social Facebook, aty ku ata nuk janë anonimë, reagimet thuajse të gjitha positive ndaj vendimit të gjykatës

së Tiranës për dënimin e Sali Berishës për shpifje në dëm të gazetarit Carlo Bollino. Për të ilustruar këtë reagim kemi mar-

rë disa komente që qytetarët kanë komentuar në profilin e Facebook-ut të gazetarit Carlo Bollino. Shumica e tyre e shi-

konjë këtë vendim si një hap i parë për ndryshimin e drejtësisë, duke e theksuar se tashmë po i afrohem ditës kur: “të gjithë

të barabartë para ligjit”. Ndërsa të tjerë e cilësojnë edhe më historike këtë vendim për faktin se është dhënë kundër Sali

Berishës që për ta simbolizon pjesën më të keqe të politikës shqiptare ndër këto 27 vite tranzicion.

REAGIMI I DEPUTETIT

Balla: Gjyqi i Bollinos theu një tabu! Fitoi gazetari i lirë kundër politikanit

Deputeti dhe njëkohësisht kryetari i Grupit Parlamentar të PS me një reagim në Facebook ka përgëzuar vendimin e gjykatës në çështjen e fituar mes gazetarit Carlo Bollino dhe deputetit Sali Berisha. Fitoren historike ndaj ish-presidentit Berisha, Balla e ka konsideruar një thyrje tabuje dhe një hap para për gazetarin e lirë. “Përsëritja e vendimit të Gjykatës sot në çështjen mes gazetarit Carlo Bollino dhe deputetit Sali Berisha, duke e dënuar deputetin për shpifje. U thye një tabu! Nuk ishte një çështje mes dy politikanësh. Por një fitore e një gazetari të lirë kundër politikanit më gojëprishur në këto 27 vite. Sot është një ditë kur të gjithë gazetarët e lirë duhet të ndihen fitimtarë. Si kudo, sot në Shqipëri gazetaria e lirë ka ende vështirësi, ka edhe raste përplasjesh, por periudha kur gazetarët kërcënoheshin, u vendoseshin gjoba, kur futeshin në burg, kur selive të gazetave u vihej flaka apo kur gazetarët qëlloheshin me armë nga ushtarët e gardës ka marrë fund një herë e përgjithmonë. Sali Berisha dënohet për herë të parë dhe këtë betejë e fitoi një gazetar i lirë. Ky është një ogur i mirë!”



ELEZ ALIKAJ

Fitorja jote ndaj nje shpifsi ordiner sic dhe eshte ky berisha, per mua merr nje vler te jashtezakonshme,, duke i sherbyer dhe gazetaris, qe te jene te verteta ato qe thuhet ,se ne pergjithesi keto 25 vjet ashtu si dhe politika mediat nuk kane as nje here, krahe te vertetes

GANI ELEZI

Po eshte nje kthese, nje sukses i vertete per drejtesine ne Shqiperi. Urojme qe keshtu te vazhdohet edhe shume procese te tjera ndaj Berishes dhe politikaneve te tjere te larte.

KADRI HAXHI

Te lumte per fitoren ndaj nje ish presidenti shume te perfolur . ngelesh simbol dhe je i pari qe ari te fitosh ndaj kesaj mostre shume te uryer nga shqiptaret.

LIDA KITA

Bravo Bravo shpresoj kjo te behet nje praktike normale ne Shqiperi: te gjithet te barabarte para ligjit. Urime!

BONA MULLIÇI

Me ne fund... Bravo drejtesia!!!!

NDUE LAZRI

Fitorja juaj shenon fillimin e funksionimit sadopak te drejtesise ne Shqiperi edhe kunder politikaneve qe shpifjen e kane baze te moralit te tyre. Shpresojme qe ky denim te hape serine e denimeve serioze ndaj Berishes per te keqiat e medha qe i ka sjelle vendit.

TANIA PASHKO

E pabesueshme por e vertete. Te lumte Carlo. Leksion demokracie.

GIJSHI XHOI

Duhet falenderuar jo vetem Carlo Bolino, por edhe gjykata, qe me ne fund tregoi pavaresi dhe integritet. Te gjithet te barabarte para ligjit.

GANI ELEZI

Po eshte nje kthese, nje sukses i vertete per drejtesine ne Shqiperi. Urojme qe keshtu te vazhdohet edhe ne shume procese te tjera ndaj Berishes dhe politikaneve te tjere te larte.

LAVDIEGJINICELA LAVDIEGJINI

Nje lufte e pabarabarte Po me ne fund.... e verteta.... vlen shume....

ANDREA NATHANILI

Urime Carlo, vendimi eshte simbolik por teper i rendesishem. Më teper se politike, fitorja eshte ligjore!

PERPARIM KALO

Per mendimin tim ky rast deshmon per nje hap i hedhur drejt dhenies drejtesie, megjithate nuk te entuziazmon fakti qe vendimi eshte marre ndaj nje ish funksionari te larte..Kur te denohet ndonje qe eshte ne pushtet mund te themi qe drejtesia ka bere kthesen e shumepritur drejt pavaresise e profesionalizmit

SINDIKATA ARSIMIT TE MESEM

Fitore e madhe jo vetem per rastin ne fjale por fitore edhe ne aspektin profesional te gjyqtareve te cilet me se fundi arrijne ti largohen nderhyrjeve te politkaneve dhe ti bashkohen gjykimeve te paanshme qofshin keta me apo pa pushtet. Merita i takon reformes.

ELIZANA XHAMETA

Të gjithë të barabartë përpara ligjit. Më në fund dhe Shqipëria po fillon të shemb korrupsionin në gjyqësor dhe po shndërrohet në shtet ligjor.

MITAT TABAKU

Me ne fund po bie era drejtesie. Kjo po tregon se PD dhe LSI prandaj jane bere si te terbuar po ju vjen fundi. Te gjitha bemat kriminale qe kane bere ne keto vjet te udhehequra dhe drejtuar me devotshmeri nga krye kriminelit me i madh qe ka njohur historia boterore. Merita kryesore i takon Kryeministrit aktual qe kembenguli per reformen ne drejtesie e cila ne keto 27 vjet gjykatat prokuroria SHISH e te gjithet Polici e cdo gje ishin te varura nga ky moster i Quajtur Sali Ram Fazllici. Ky njeri duhet izoluar nje ore e me pare sa nuk eshte von.

Sekuestrohen dy pallate e tokë në zonën e Lezhës

Leja për ndërtimin e tyre dyshohet se është dhënë në kundërshtim me ligjin. Policia referoi rastin

Një bllok pallatesh 5-7 kate me sipërfaqe ndërtimi 6712 m² janë sekuestruar me urdhër të Prokurorisë së Lezhës, pasi leja për ndërtimin e tyre dyshohet se është dhënë në kundërshtim me ligjin. Objekti është duke u ndërtuar nga një shoqëri me qendër në Lezhë. Më konkretisht me urdhër të Prokurorisë janë sekuestruar një pallat 5 katësh dhe në proces kati i fundit, me sipërfaqe të sheshtit të ndërtimit 2000 m² si dhe një pallat 7 katësh dhe në proces kati i fundit, me sipërfaqe të sheshtit të ndërtimit 4712 m². Ka qenë urdhëri datë 13 prill 2018, i Prokurorisë Lezhë, që ka çuar në ekzekutimin e vendimit penal Nr. 127 datë 13 prill 2018 të Gjykatës së Lezhës, e cila ka vendosur masën e sigurimit pasuror "Sekuestro preventive" mbi pasuritë e paluajtshme, pallate



REPORT

në ndërtim të një shoqërie private në Lezhë, në adresë "Kune" Shëngjin, në pronësi dhe administrator të shtetasit Agustin Uldedaj.

SEKUESTROJA E DYTË

Gjithashtu, sekuestro është vendosur edhe për një truall me sipërfaqe 1146.6 m², në adresë lagje "Besëlidhja" Lezhë, në pronësi të shtetasit B.Dedja.

Arsyeja e vendosjes së kësaj sekuestro është bërë pasi, nga vendimi penal i Gjykatës, leja për ndërtim ka rezultuar e sigurtuar në kundërshtim me ligjin. Prokuroria ka regjistruar veprat penale "Ndërtim i paligjshëm" dhe "Fallsifikim dokumentash" si dhe Prokuroria e Rrethit Gjyqësor, e cila ka regjistruar procedimin penal duke kryer më pas veprimet e mëtejshme.

POLICIA REFEROI RASTIN

Arsyeja e vendosjes së kësaj sekuestro është bërë pasi, nga vendimi penal i Gjykatës, leja për ndërtim ka rezultuar e sigurtuar në kundërshtim me ligjin. Njëkohësisht, pranë Zyrës Vendore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Lezhë, u kryen veprimet duke vendosur kufizimet përkatëse në zbatim të vendimit penal të Gjykatës. Ky procedim policor me rezultat "Sekuestro preventive", është rezultat i bashkëpunimit të ngushtë mes Policisë së Lezhës e cila ka referuar në Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Lezhë, materialet proceduriale mbi bazën e dyshimit të arsyeshem, në lidhje me këto 2 raste për veprat penale "Ndërtim i paligjshëm" dhe "Fallsifikim dokumentash" si dhe Prokuroria e Rrethit Gjyqësor e cila ka regjistruar procedimin penal duke kryer më pas veprimet e mëtejshme.

ZBULOHEM GRABITJA NË LEVAN

Jeta e luksit i nxjerr "bllof", "Burg pa afat" për të rinjtë që vodhën 100 mln lekë në Fier

Jeta e luksit nxorri hapur dy të akuzuarit për vjedhjen e një "Benzi" dhe 100 milionë lekëve 1 vit më parë në Levani të Fierit. Ato kanë blerë sende të shterenjta dhe kanë bërë jetë luksi edhe pse të papunë, deri sa kanë rënë në pranga. Policia e Fierit ka mbledhur prova të pakundërshtueshme për fajësinë e dy të rinjëve. Pas shqyrtimit të provave të siguruar gjatë hetimit një vjeçar që implikon dy të rinjtë në vjedhjen 100 milionësh të Xhemal Kalemajt. Gjyqtarja e çështjes Matilda Shalla ka vendosur të lërë në fuqi masën e sigurisë të caktuar me datë 11 prill 2018 "Arrest me burg", pa afat për veprën penale "Vjedhje e kryer në bashkëpunim". Kanë qenë pamjet e një kamere sigurie që kanë çuar në identifikimin e një prej dy të rinjëve të arrestuar si autorë të dyshuar të vjedhjes së një autoveture tip "Benz" dhe 10 milionë lekëve të reja, një banori nga Levani i Fierit. Një prej të arrestuarve të djeshëm, Renaldo Latifi 22 vjeç nga Levani i Fierit, është kapur nga kamera e sigurisë së një objekti, teksa ecte pranë vendit të ngjarjes, me në çelës të ngjashëm me atë të Benz-it të vjedhur. Nga vëzhgimet e pamjeve filmike është konstatuar se rreth orës 07.29 minuta me orën e kameras, ka kaluar Renaldo Latifi në drejtim të vendit të ngjarjes ku në anë të rrugës ka qenë parkuar makina e shtetasit Xhemal Kalemaj.



BULQIZË

Një minator gjen vdekjen nga shpërthimi i minave



Një aksident ka ndodhur dje në Bulqizë, ku një minator me detyrën e zjarrmëtarit, si rezultat i pakujdesisë në procesin e shpimit dhe në një zonë ku duhet të avanconte, ka gjetur vdekjen menjëherëshme nga plasja e minave. Viktima është Angjelosh Shahini, 52-vjeç. Pak ditë më parë, një tjetër minator, me të njëjtën detyrë kishte ndërruar jetën në një minierë të Klosit, po si pasojë e shpërthimit të një mine.

DURRËS

Aksidentohen dy automjete, një prej makinave përmbysset në rrugë

Një aksident rrugor ka ndodhur mbazditen e djeshme. Një automjet me targa AA 430 JF është përmbysur në asfalt dhe pasi ka bërë disa metra, është përplasur me një automjet tjetër, me targa AA 826 NB. Nga aksidenti nuk raportohet për persona të lënduar. Drejtuesi i automjetit të përmbysur në rrugë, ka shpëtuar mrekullisht pa lëndime. Shkak për aksidentin, dyshohet të ketë qenë shpejtësia e automjetit tej normave të lejuara.



REPUBLIKA E SHQIPERISE
KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT



KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT NJOFTON PERSONAT E INTERESUAR TË APLIKOJNË PËR POZICIONIN E SEKRETARIT TË PËRGJITHSHËM NË KËTË INSTITUCION

13.4.2018

Në zbatim të nenit 20 të ligjit nr. 84/2016 "Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë", Komisioni i Pavarur i Kualifikimit rishpall fillimin e procedurave për personat e interesuar që kërkojnë të aplikojnë për pozicionin e Sekretarit të Përgjithshëm në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit, kategoria e pagës: I-a.

Personat e interesuar të aplikojnë për këtë pozicion **brenda 20 ditëve, pas publikimit.**

Të gjithë të interesuarit duhet të dorëzojnë në institucionin e Komisionit të Pavarur të Kualifikimit (me postë apo dorazi) dokumentacionin sipas kriterëve të përcaktuara në pikën 3, të nenit 20 të ligjit nr. 84/2016 "Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë", si më poshtë vijon:

1- Kërkesë me shkrim, shprehje interesi;

2- Dokument që ka përfunduar ciklin e dytë të studimeve universitare për Drejtësi ose në Shkenca Ekonomike me diplomë "Master i shkencave" në Shqipëri ose studimet universitare për Drejtësi ose në Shkenca Ekonomike jashtë vendit dhe ka marrë një diplomë të njësuar sipas rregullave për njësimin e diplomave, të parashikuar me ligj;

Diplomën shoqëruar me listë notash, fotokopje të noterizuar;

Për personat që kanë përfunduar studimet jashtë vendit, dokumentin e njësimit të diplomës të shoqëruar edhe me diplomat dhe listën e notave përkatëse, fotokopje të noterizuar.

3- Dokument që ka pasur një përvojë pune në nivel menaxherial dhe drejtues jo më pak se 10 vjet;

CV, të shoqëruar me librezë pune apo çdo dokument tjetër që vërteton këtë kriter.

(Njohuritë në nivel menaxherial përfshijnë: Njohuri në marrëdhënie pune, organizative, drejtuese apo menaxheriale. Kandidati duhet të zotërojë në mënyrë të mjaftueshme aftësi profesionale dhe organizative për të përfaqësuar institucionin në marrëdhënie me palët e treta, si dhe të ketë aftësi personale për të mbajtur të motivuar dhe produktiv personelin e institucionit.)

Të plotësojë kriteret për pajisjen me certifikatë sigurie të nivelit të lartë.

4- Dokument që ndaj tij të mos ketë nisur një hetim penal, të mos jetë i dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e një krimi ose për kryerjen e një kundërvajtjeje penale me dashje;

Kandidati duhet të informojë gjithashtu për çështje të tjera të konfliktit të mundshëm të interesit apo të konfliktit në dukje. Ai duhet të shfaqë marrëdhënie mirëbesimi me Komitetin ad hoc gjatë procesit, i cili mban në konsideratë sjelljet e kandidatit në vlerësimin përfundimtar.

5- Dokument që zotëron shumë mirë gjuhën angleze. Njohuritë e gjuhës angleze do të testohen edhe nëpërmjet një interviste me gojë me kandidatin.

6- Dokument që ndaj tij të mos jetë marrë masa disiplinore e largimit nga puna ose ndonjë masë tjetër disiplinore, e cila është ende në fuqi, sipas legjislacionit, në momentin e aplikimit;

Do të vlerësohet paraqitja e rekomandimeve pozitive të punës së tyre.

7- Dokument që nuk ka ushtruar funksione politike në administratën publike ose nuk ka mbajtur pozicione drejtuese në një parti politike gjatë 10 viteve të fundit (kjo mund të shprehet edhe me deklaratë individuale).

Shoqëria Përmbarimore
"ZIKE" sh.p.k

ZIKE

me adresë: Blv/Gjergj Fishta" Pallatet "Gora" Kulla 2, Kati 2, Ap 9, Tiranë, në zbatim të dispozitave të Kodit të Procedurës Civile, njofton se do të kryej procedurat për shitjen në ankand-III, të pasurive të paluajtshme në pronësi të z.Azhen Llukan Prifti, si më poshtë:

NË DATË 04.05.2018 ORA 16:45

• Pasuri nr. ZK 2380, lloji i pasurisë (pyll) me sipërfaqe. 2000 m², me adresë Lanabregas, Tiranë, me cmimi fillestar është 5,040,000 lekë.

• Pasuri nr. ZK 2460, lloji i pasurisë (pyll) me sipërfaqe. 5000 m², me adresë Dajt, Tiranë, me cmimi fillestar është 10,080,000 lekë.

Për informacione mund të kontaktoni në numrin e
Tel. 044 500 278 ose adresën e e-mailit: ilirdervishi85@gmail.com

Dosja "Llalla" vjen tek Krimet e Rënda, pritet arrestimi i tij

Çështja për ish-kryeprokurorin do hetohet në Tiranë. Adriatik Llalla nën hetim për katër akuza

Çështja penale kundër ish-kryeprokurorit Adriatik Llalla e nisur një muaj më parë për 4 akuza nga prokuroria e Durrësit, mësohet se është transferuar në Prokurorinë e Krimeve të Rënda. Llalla do vijojë të hetohet nga kjo prokurori dhe se siç mësohet ka shumë gjasa që ish-kolegët e tij të nxjerrin në ditët në vijim, urdhër-arresti për ish-shëfën e tyre, që drejtoi Prokurorinë e Përgjithshme për 5 vite me rradhë. Çështja penale kundër Adriatik Llallës është transferuar tek krimet e rënda, pasi akuza e Durrësit gjatë verifikimeve të kryera ka konstatuar shkelje ligjore, për sa i përket makinacioneve që Llalla ka kryer për ritjen e pasurisë së tij, nëpërmjet shtetasve Gazmen Brahimaj dhe Edison Dushku. Por nuk ka qënë vetëm kjo arsyeja e transferimit të dosjes nga Durrësi në Tiranë, pasi prokurorët kanë shfrytëzuar dhe një vendim të Gjykatës së Lartë, e cila udhëzon prokuroritë e rrethëve që çështjet penale të rregjistruara për zyrtarë të lartë nga 1 gushti 2017, duhet ti kalojnë Prokurorisë së Krimeve të Rënda, pasi kjo e fundit ka kopetencat ligjore për të hetuar këtë kategori. Vetë posti i kryeprokurorit që mbante Llalla, konsiderohet si nivel i lartë i këtij zyrtari, që tashmë është nën hetim për 4 vepra penale. Hetime

për Llallën është rregjistruar për "Refuzimit për deklarim, mosdeklarimit, fshehjes ose deklarimi i rremë i pasurisë, interesave private të zgjedhur dhe nëpunësve publikë ose i çdo personi tjetër që ka detyrimin ligjor për deklarim", "Mosdeklarimit të shumave të të hollave në kufi", "Pastrimit të produkteve të veprës penale" dhe "Shpërdorimit të detyrës". Ish-kryeprokurori Llalla prej muajsh ndan kohën e tij ndërmjet Shqipërisë dhe Gjermanisë, ku jeton edhe familja e tij pas një largimi të ngutshëm në mesin e vitit 2016. Në vitin e fundit të man-

KATËR AKUZAT

"Refuzimit për deklarim, mosdeklarimit, fshehjes ose deklarimi i rremë i pasurisë, interesave private të zgjedhur dhe nëpunësve publikë ose i çdo personi tjetër që ka detyrimin ligjor për deklarim"

"Mosdeklarimit të shumave të të hollave në kufi"

"Pastrimit të produkteve të veprës penale"

"Shpërdorimit të detyrës".

datit të tij, Llalla pati konflikt të hapur me ambasadorin e SHBA në Tiranë Donald Lu, duke e akuzuar këtë të fundit si person që kishte ndikuar tek

ai për arrestimin e Ilir Metës dhe për mbylljen e një procedimi penal në Fier, që bënte fjalë për kompaninë e naftës "Bankers Petroleum". Nga ana



tjetër Lu e ka quajtur Llallën si person të korruptuar dhe që ka dashur të pengojë reformën në drejtësi. Pas largimit të Llallës nga posti i kryeprokurorit, Departamenti i Shtetit ndaloi publikisht hyrjen e Adriatik Llallës dhe familjes së tij në Shtetet e Bashkuara, me argumentin se "ka informacione për përfshirje të tij në raste domethënëse korrupsioni".

Non Grata

Pas largimit të Llallës nga posti i kryeprokurorit, Departamenti i Shtetit ndaloi publikisht hyrjen e Adriatik Llallës dhe familjes së tij në Shtetet e Bashkuara, me argumentin se "ka informacione për përfshirje të tij në raste domethënëse korrupsioni".

Pasuria

Çështja penale kundër Adriatik Llallës është transferuar tek krimet e rënda, pasi akuza e Durrësit gjatë verifikimeve të kryera ka konstatuar shkelje ligjore, për sa i përket makinacioneve që Llalla ka kryer për ritjen e pasurisë së tij, nëpërmjet shtetasve Gazmen Brahimaj dhe Edison Dushku.

që disa javë pas vendimit të Departamentit të Shtetit, Prokuroria e Durrësit nisi hetimin ndaj Adriatik Llallës, për disa vepra që lidhen me pastrimin e parave. Tashmë kjo çështje i ka kaluar për hetime të mëtejshme Prokurorisë së Krimeve të Rënda.

REAGIMI I KRYEPROKURORIT TË PËRGJITHSHËM

Llalla: Lu të ndalet! Po sillet si prokuror e gjykatës në Shqipëri

Ish-kryeprokurori i Përgjithshëm Adriatik Llalla i është përgjigjur akuzave të ambasadorit amerikan Donald Lu nëpërmjet një deklarate për shtyp. Përfaqësuesi i SHBA-ve në Tiranë duke iu përgjigjur një letre të Llallës për Kongresin amerikan, në të cilën ky i fundit ishte shprehur se Lu-ja i kishte kërkuar arrestimin e Ilir Metës, tha pak ditë më parë se Llalla ishte një ish-prokuror i korruptuar dhe i diskredituar, i trembur nga burgu, i cili e kishte trilluar çështjen Meta. Por në deklaratën e tij, Llalla i mohon akuzat që ai të jetë i korruptuar apo që të ketë qënë kundër reformës në drejtësi. Sipas ish-prokurorit, Lu duhet



të ndalet që të sillet si prokuror e gjykatës në Shqipëri, duke hetuar dhe gjykuar të tjerët pa fakte. Llalla thotë se akuzat e Lu-së ndaj tij, mund të rrezoheshin nga çdo gjykatë. "Unë hedh poshtë në mënyrë kategorike akuzat tuzare për korrupsion të lëshuara kundër meje nga Ambasadori i SHBA-ve Donald Lu, gjatë javëve të fundit. Akuzat e Ambasadorit Lu janë pa bazë dhe do të provohen të pavërteta nëse do të paraqiten përpara çdo gjykatë"-shprehet Llalla. "Përfitoj nga mundësia për të ripërsëritur në mënyrë të qartë dhe të prerë se unë kam mbështetur dhe vazhdoj të mbështes Reformën në Drejtësi në Shqipëri. Unë

mbështes çdo reformë që i shërben interesave të popullit shqiptar duke garantuar një sistem të pavarur drejtësie dhe ndarje të pushteteve. Por unë jam kundër çdo përpjekjeje për ta vendosur drejtësinë shqiptare nën ndikimin e kujtdo—qeverisë, partive politike, oligarkëve, apo interesave kriminale dhe të biznesit. Natyrisht, kurdo që ka qënë e nevojshme unë kam dhënë këndvështrimin tim për propozimet konkrete gjatë hartimit të reformës. Qëndrimet e mia kanë reflektuar gjithmonë shqetësimin tim të thellë për detyrimin tim si Prokuror i Përgjithshëm për të siguruar se prokuroritë vazhdonin të luftonin krimin dhe korrupsionin edhe

gjatë kohës që hartohet reforma dhe për të ruajtur moralin e shumë prokurorëve dhe punonjësve publikë që janë të ndershëm dhe të pakorruptuar"-thotë ish-kryeprokurori. Llalla shton se sulmet personale të Ambasadorit Lu janë të papërgjegjshme dhe të papranueshme. "Ambasadori Lu jo vetëm që e ka futur veten e tij në procese hetimore vendase, por ai i ka dhënë vetes të drejtën të sillet si prokuror, gjykatës dhe juri duke shpallur publikisht se unë jam nën hetim dhe pastaj duke më shpallur të fajshëm dhe me çfarë duhet të dënohem, pa patur asnjë provë dhe pa asnjë proces të rregullt"-shprehet Llalla.

SHPALLJE ANKANDI

SHOQËRIA PËRMBARIMORE "CORRECTOR" SHPK, ZHVILLON ANKANDIN E I-RË, PËR SHITJEN E PASURISË SË PALUAJTSHME

Ankandi zhvillohet dt. 19/04/2018, ora 15.30 në adresën, Rruga "Kavajes", Nderesa 27, Hyrja 1, Kati i III –te, Tiranë.

KONTAKT: CEL. 0684000061 OSE NË ADRESËN E E-MAIL: ARMELS.LOLE@NCHB.AL

- Truall + ndërtesë, me numër pasurie 6/55, vol 26, faqe 169, ZK 8571, me sipërfaqe totale 2160 m², regjistruar në ZVRPP Lushnje, në pronësi të Zan Abas Marku;

Cmimi i ankandit të parë është ALL 6,400,000 (gjashtë milion e katërqind mijë) lekë.

SHPALLJE ANKANDI

SHOQËRIA PËRMBARIMORE "CORRECTOR" SHPK, ZHVILLON ANKANDIN E I-RË, PËR SHITJEN E PASURISË SË PALUAJTSHME

Ankandi zhvillohet dt. 19/04/2018, ora 15.00 në adresën, Rruga "Kavajes", Nderesa 27, Hyrja 1, Kati i III –te, Tiranë.

KONTAKT: CEL. 0684000061 OSE NË ADRESËN E E-MAIL: ARMELS.LOLE@NCHB.AL

- Ndërtesë, me numër pasurie 6/36, vol 10, faqe 246, ZK 8571, me sipërfaqe 312 m², regjistruar në ZVRPP Lushnje, në pronësi të Marku shpk;

Cmimi i ankandit të parë është ALL 3,200,000 (tre milion e dyqind mijë) lekë.

SHOQËRIA PËRMBARIMORE "616/A" SHPALL PËR SHITJE PASURINË E PALUAJTSHME

Arë me sip. 400 m² (proçes legalezimi), me nr. pasurie 1049/17, vol.8, faq.115, e ndodhur në zonën kadastrale nr. 3819, fshati Voskopojë, Korçë. Pasuria shpallet për shitje me vlerë fillestare **3.780.000 lekë (tremiljoneshatëqindetëdhjetëmijë)**

ANKANDI ZHVILLOHET DITËN E HËNË NË DATËN 16 PRILL 2018

Personat e interesuar mund te paraqiten ne adresen Lagjia Nr.3, Rruga "Andon Xoxe", Pogradec ose te kontaktojne ne numrin 0692585612 ose ne e-mail: shoqeria616a@gmail.com



Si çdo javë, eksperti për çështjet e pensioneve Fadil Kepi ka sqaruar në Report TV, qytetarët mbi problematikat e pensioneve. Në emisionin "Këndi i Ekspertit" nën drejtimin e gazetares Valbona Mhilli, Fadil Kepi u është përgjigjur pyetjeve të ndryshme të qytetarëve. Eksperti ka sqaruar qytetarët që kanë dalë në pension, por vazhdojnë të punojnë në sektorin privat për detyrimet por edhe privilegjet e tyre. Po kështu profesor Kepi ka sqaruar qytetarët që kanë problem shëndetësorë për procedurën e pensionit të invaliditetit.

Na shkruan z. Abedin nga Tirana: "Më 4 gusht 2017, plotësova moshën 65 vjeç. Kam punuar 39 vite punë të siguruara, por vazhdoj ende të punoj në një bankë private. Kur dal në pension? A mund të vazhdoj të punoj edhe pas daljes në pension?"

Moshën për pension e ka plotësuar më 4 gusht të vitit 2017, kur mbushi 65 vjeç. Nga 36 vjet punë që i duhej për pension të plotë, ai kishte 39 vjet. Meqenëse zotëria punon në një bankë private dhe ka një kontratë pune me bankën private, mund të vazhdojë të punojë edhe mbi moshën e pensionit. Nga data 4 gusht 2017 e në vazhdim, për çdo muaj që punon në bankën private, ai do të përfitojë 0,5% shtesë mbi pension. Pasi të dalë në pension, ai do të përfitojë lejen e zakonshme nga 1 janari i këtij viti deri më 4 gusht 2018 dhe pastaj do të marrë pensionin dhe në qoftë se vazhdon të punojë në bankën private, është i detyruar prapë të paguajë kontributet e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore. Merr edhe pensionin edhe shtesat që i bëhen pensioneve me vendime qeverie, por do të marrë edhe pagën të bankës private, por do të paguajë kontributet e sigurimeve shoqërore e shëndetësore në mënyrë të detyrueshme sikur nuk ka dalë në pension. Të zgjedhë rrugën më të mirë për të.

Flas nga Shkodra. Jam shtruar në spital në datën 6 nëntor dhe më 15 nëntor kam bërë një ndërhyrje në zemër. Jam i vetëpunësuar që kontribuoj. Më kanë thënë që të drejtën për të dalë në KEMP e kam pas 6 muajve, pra më takon më 6 maj. Unë duhet të ndërpres sigurimet dhe të marr pagesën e KEMP-it apo edhe sigurimet edhe KEMP-in?

Të uroj të shkuara e shërim të shpejtë. Pasi del nga spitali, pajiseni me një fletë drejtimi për në KEMP, në Shkodër. Atje ju caktohet dhe data e daljes në komision, por 6 muaj pas ditës së shtrimit në spital. Pas 6 muajve nuk ka të drejtë asnjëri të lëshojë raporte mjekësore në vendin tonë, në asnjë instancë. Nëse del invalid i plotë, do të marrë pensionin e invaliditetit, shuma e të cilit varet nga vitet e punës që ke pasur, sivjet duhen 36 vjet e 4 muaj gjithsej, dhe nga paga mesa-

Fadil Kepi: Përfitimet e detyrimet e pensionistëve që punojnë në privat

Eksperti i çështjeve të pensioneve sqaron qytetarët në Report TV. Si merret pensioni i invaliditetit, procedura e dokumentat

tare bruto mujore që ke marrë gjatë viteve të punës. Por, do të marrësh edhe në bashki 3.300 lekë të reja, nga dita që ju filloni pensionin e invaliditetit. Kjo merret nga fondet e sigurimeve shoqërore. Deri në moshën 65 vjeç që plotëson moshën për pension pleqërie, kjo periudhë të quhet vjetërsi pune. Në moshën 65 vjeç ju lind e drejta për të marrë pension pleqërie. Kjo periudhë, pra, nga dita që ke marrë pensionin e invaliditetit, jo nga dita që je shtruar në spital, të quhet vjetërsi pune për efekt të pensionit të pleqërisë. Pra, në moshën 65 vjeç të lind e drejta për të zgjedhur midis dy pensioneve: ose të marrësh pensionin e plotë të invaliditetit ose të marrësh pensionin e pleqërisë. Bashkërisht me Sigurimet Shoqërore, ti ke të drejtë

të zgjedhësh pensionin më të lartë, por vetëm një pension, jo dy. Dhe pavarësisht se cilin pension zgjedh ti për të marrë, përfiton edhe 3.300 lekët nga bashkia. Gjithashtu do të përfitosh edhe barnat mjekësore me rimbursim të plotë, pavarësisht nga pensioni që do të zgjedhësh.

Jam 70 vjeç, nga Tirana. Kam dalë invalid në vitin 2012, sepse vuaj, nga hipertensioni, zemra dhe nga diabeti. Kam gjithsej 34 vjet punë deri në vitin 2002, kur jam sëmurë dhe deri në vitin 2012 kam qenë nëpër spitale. Pastaj dola invalid. Pensioni që marr është shumë i ulët, 146 mijë lekë. Para 2 muajve bëra një kërkesë për rishikim pensioni dhe ma kanë lënë përsëri aq sa e kisha.

Ju keni të drejtën të shko-

ni për të takuar çdo ditë të mërkurë, me dokumentet me vete, me librezën e pensionit, Drejtorin e Sigurimeve Shoqërore, në Tiranë. Të gjitha pretendimet që keni, do t'ia thoni atij. Në qoftë se përsëri nuk do të bindesh, 100 metra më larg ndodhet Instituti i Sigurimeve Shoqërore. Mundohu që të takosh drejtorin apo njërin nga zëvendës drejtorët. Ky është një problem që zgjidhet.

Flas nga Tirana. Burri im ka dalë në pension. Tani është 70 vjeç. Merr pension të pjesshëm, megjithëse ka punuar 40 vjet. 2 vitet e ushtrisë dhe 3 vite që ka punuar si nënoficer nuk figurojnë në asnjë vend. Si shpjegohet kjo?

Në parim ke të drejtë. Bashkëshorti duhet që me dy dësh-

mitarë të vërtetojë në një proces gjyqësor që ka punuar në atë apo këtë repart ushtarak, sepse ushtarakët kanë lëvizur nëpër reparte e zona të ndryshme. Raste të kësaj natyre ka pasur plot dhe janë sqaruar në këtë formë, edhe pse nuk figuronin të dokumentuara vitet e punës. Ky nuk është faji i Sigurimeve Shoqërore, por i Ministrisë së Mbrojtjes që nuk ka mbajtur dokumente të rregullta. Të këshilloj t'i shkruash edhe një letër Ministres së Mbrojtjes, znj. Olta Xhaçka.

Flas nga Shkodra. Jam 33 vjeç. Kam pësuar një aksident në vitin 2010 dhe gjykata vendosi që unë të dëmshpërblehem me KEMP dhe me siguracione. Kur gjykata vendosi për 45% humbje aftësie, unë përfito-

va KEMP. KEMP-in ma dhanë thjesht si i papunë, gabimisht, sepse unë isha në ushtri. Pastaj dosja ime u zhduk fare. As në komision nuk esillnin. Në bashki ma dhanë dosjen dorazi dhe e dërgova në komision. Komisioni nuk ma pranoi. As bashkia nuk ma pranoi. Më mbeti dosja në dorë. Ndërsa në komision e kishin shkruar "mosparaqitje". KEMP-in e dhanë gabimisht si i papunë sepse u ndërrua qeveria dhe u shtrembëruan ligjet. Kam vetëm 1 vit ushtri.

Në vitin 2012, për të marrë pension të plotë invaliditeti, ty të duheshin vite pune sipas kësaj formule: 33 që është moshë juaj minus 20, një shifër konstante, e pjesëtuar kjo për 2. I takon 6 vjet e 6 muaj punë, do të kishe marrë pension të plotë. Nëse do të kishe 3 vjet e 3 muaj punë, do të kishe marrë 50%. Sqarime më të hollësishme mund të marrësh në Drejtorinë Rajonale të Sigurimeve Shoqërore në Shkodër.

Flas nga Durrësi. Kam 28 vite pune dhe kambërrënjëndërhyrje në zemër para një viti. Jam 53 vjeç. Nuk dola në KEMP sepse të Sigurimet Shoqërore më thanë që marr KEMP minimal. Unë nuk e dija këtë, por ju dëgjova më parë që thatë se ndikojnë vitet e punës në marrjen e KEMP-it. Nëse keni mundësi të më sqaroni.

Pensionin e KEMP-it ka llogaritjet e veta, në bazë të viteve të punës. Ka një formulë standarde. Ju jeni 53 vjeç minus 20, që është një shifër konstante, dhe del 33. E shumëzojmë me 3 dhe del 99. E pjesëtojmë me 4. Për të marrë pension të plotë juve ju duhen 24 vjet e 9 muaj punë. Dhe gjatë 5 vjetëve të fundit, nga dita që jeni shtruar në spital e 5 vite përpara, duhet të keni 1 vit punë. Ligji i Sigurimeve Shoqërore thotë: "Pensionin e invaliditetit për sëmundje të përgjithshme llogaritet njëllor si pensionin e pleqërisë". Do të çosh vërtetimin e rrogës që ke marrë, që nga data 1 janar 1994. Do të çosh librezën e punës. Do t'i çosh të KEMP-it i Sigurimeve Shoqërore në Durrës. Ata të KEMP-it nuk llogarisin pensionin. Ata vetëm pranojnë dokumentet dhe i dërgojnë te Drejtoria e Sigurimeve Shoqërore. Atje, ata e japin me shkrim se sa del pensioni. Nëse ty të del pension i plotë i invaliditetit, atëherë do të marrësh edhe 3.300 lekë të reja në bashki. Pensionin e invaliditetit ka procedurën e vet që ti nuk e di. Prandaj do të shkosh tek Agjencia e Sigurimeve Shoqërore dhe ne nuk bindesh, do të shkosh te Drejtoresha e Sigurimeve Shoqërore në Durrës. Përgjigja duhet të jetë zyrtare, me shkrim dhe e firmosur. Nuk është përgjigje ajo që thua ti se ke marrë. Nuk është serioze. Dhe unë nuk mendoj se punonjësit e Sigurimeve Shoqërore të jenë sjellë në mënyrë jo serioze, duke t'u përgjigjur me hamendje.

SHPALLJE ANKANDI

SHOQËRIA PËRMBARIMORE "CORRECTOR" SHPK, ZHVILLON ANKANDIN E I-RË, PËR SHITJEN E PASURISË SË PALUAJTSHME,

Ankandi zhvillohet dt. 19/04/2018, ora 16.30 në adresën, Rruga "Kavajes", Ndertesat 27, Hyrja 1, Kati i III –te, Tiranë

KONTAKT: CEL. 0684000061 OSE NË ADRESËN E E-MAIL: ARMELS.LOLE@NCHB.AL

SHPALLJE ANKANDI

SHOQËRIA PËRMBARIMORE "CORRECTOR" SHPK, ZHVILLON ANKANDIN E I-RË, PËR SHITJEN E PASURISË SË PALUAJTSHME,

Ankandi zhvillohet dt. 19/04/2018, ora 16.00 në adresën, Rruga "Kavajes", Ndertesat 27, Hyrja 1, Kati i III –te, Tiranë.

KONTAKT: CEL. 0684000061 OSE NË ADRESËN E E-MAIL: ARMELS.LOLE@NCHB.AL



REPUBLIKA E SHqipërisë
INSTITUTI I SIGURIMEVE SHOQËRORE
DRSSH _____
ALSSH _____

Modelar _____

KËRKESË

PËR SIGURIMIN SHOQËROR SUPLEMENTAR, SIPAS LIGJIT NR. 10142, DATË 15.05.2009, I NDRYSHUAR

Nr. _____ Regj, Datë ____ / ____ / _____

Seksioni I - Të dhëna personale të kërkuarit

NID	Emër	Atësi	Mbiemër	Mbiemër para martesës

Datëlindja	Vendlindja	Adresa	Numër Telefoni
____ / ____ / ____	Fshati: _____ Qyteti: _____ Rrethi: _____ Qarku: _____	Lagjia: _____ Rruga: _____ Pall: _____; Shk: _____ Qyteti/Fshati: _____ Qarku/Rrethi: _____	_____

Seksioni II - Kërkesa për pension të parakohshëm për vjetërsi shërbimi

Kërkoj të përfitoj pensionin e parakohshëm për vjetërsi shërbimi, meqenëse kam plotësuar kushtet, sipas nenit 13, të Ligjit nr. 10142, datë 15.05.2009, të ndryshuar:

- Mosha _____ vjeç;
- Vjetërsi në shërbim _____ vite;
- Kam dalë në rezervë/lirim në datën ____ / ____ / _____;
- Kam përfituar pagesën kalimtare nga data ____ / ____ / _____ deri më datë ____ / ____ / _____;
- Nuk kam përfituar pagesë kalimtare, pasi nuk plotësoja kushtet ligjore.

Kërkoj që të ardhurat t'i tërheq pranë:

Qendrës Paguese _____ të Postës Shqiptare;

Bankës _____; me numër llogarie _____.

Seksioni III - Deklarata e periudhave të vjetërsisë në shërbim ushtarak

A. Deklaroj se kam shërbyer si ushtarak aktiv, si më poshtë vijon:

Nr.	Reparti/Institucioni	Nga data	Deri më datë	Funksioni/Grada
1.				
2.				
3.				

B. Deklaroj nën përgjegjësinë time personale se kam shkëputur marrëdhëniet financiare me subjektin

_____ më datë ____ / ____ / ____.

C. Deklaroj nën përgjegjësinë time personale se vazhdoj marrëdhëniet financiare me subjektin

_____.

D. Deklaroj se përfitoj _____, me nr. dosje _____, nga sigurimet shoqërore.

E. Deklaroj se nuk përfitoj asnjë lloj përfitimi nga sigurimet shoqërore.

F. Deklaroj se në rast se do të hyj në marrëdhënie pune, do të ndryshohet përbërja e familjes, ose për ndonjë shkak tjetër ligjor që sjell ndryshimin e pensionit, ose mbyllet e tij, do të njoftoj menjëherë DRSSH.

G. Deklaroj se nuk kam tokë në pronësi.

H. Deklaroj se jam i rregjistruar si punëkërkuar në SHKP.

Seksioni IV - Dokumentacioni shoqëruar

Për të provuar plotësimin e kushteve, bashkëlidhur paraqes:

(Vendos shenjën "X" përkatësisht nëse dokumenti është original, fotokopje apo fotokopje e noterizuar).
(Punonjësi i sigurimeve shoqërore vendos shenjën "V" për çdo dokument të depozituar).

Nr.	Emërtimi i Dokumentacionit	Original	Fotokopje	Fotokopje noterizuar	Konfirmimi nga sig. Shoq.
1.	Kartë identiteti				
2.	Vërtetim nga zyra e regjistrimit të pasurive (tokë bujqësore)				
3.	Të tjera				

Seksioni V - Pranimi dhe nënshkrimi i kërkesës

Pasi u njoha me kushtet ligjore për përfitim, plotësova deklaratën për periudhat e punës dhe ato kontributive dhe konfirmoj dorëzimin e dokumentacionit shoqëruar, si më lart.

Në mbështetje të VKM nr. 495, datë 13.09.2017 "Për miratimin e rregullave të përfitimit të shërbimeve publike elektronike" dhe të Ligjit nr. 9887, datë 10.03.2003 "Për mbrojtjen e të dhënave personale", të ndryshuar, me vullnetin tim të lirë autorizoj punonjësin e ngarkuar nga Drejtoria/Dega Rajonale e Sigurimeve Shoqërore që të sigurojë të dhënat dhe dokumentat administrative të ofruara nëpërmjet shërbimit publik elektronik, në atë masë që është e nevojshme për vlerësimin e kërtimeve të mia në përputhje me aktet ligjore, nënligjore dhe rregulloret që përcaktojnë procedurat e caktimit të përfitimeve që kërkoj të më caktohen nga strukturat përkatëse të sigurimeve shoqërore. PO JO

Kërkuar

(Emër, Mbiemër, Nënshkrimi)

Pasi vlerësua kushtet ligjore, në përputhje me Ligjin nr. 10142, datë 15.05.2009, të ndryshuar, dhe çdo dispozitë tjetër ligjore dhe nënligjore, kontrollova plotësimin e të dhënave të detyrueshme, dokumentacionin e dorëzuar nga kërkuar, konfirmoj regjistrimin e kërkesës.

Specialisti i Pranimit

(Emër, Mbiemër, Nënshkrimi)

Vula

Ish-ushtarakët, si do merret pensioni me ligjin e ri

Zbardhet sqarimi i ISSH për përfitimin e pensionit të pleqërisë. Ish ushtarakët me 15 vite punë pension të parakohshëm. Shembulli sa përfitohet në çdo rast

Instituti i Sigurimeve Shoqërore ka bërë publik mënyrën se si përfitohet pensioni për ish ushtarakët. Ushtaraku i shërbimit aktiv të përhershëm në Forcat e Armatosura, punonjësi i Policisë së Shtetit, i Gardës së Republikës, i SHISH-it, i Policisë së Burgjeve, i Policisë së Mbrojtjes nga Zjarri dhe të Shpëtimit dhe punonjësi i Shërbimit të Kontrollit të Brendshëm, pavarësisht nga koha e daljes në rezervë/lirim, deri në plotësimin e moshës për pension të plotë pleqërie, fitojnë të drejtën e pensionit të parakohshëm, kur: a) plotësojnë vjetërsinë në shërbim, 12 vjet për femrat dhe 15 vjet për meshkujt; b) kanë mbushur moshën 42 vjeç femrat dhe 47 vjeç meshkujt.

MASA E PENSIONIT

Pensioni i parakohshëm për personat, që plotësojnë kushtet e përfitimit, është 50 për qind e pagës mesatare referuese mujore. Për çdo vit tjetër të vjetërsisë në shërbim, sipas përcaktimit, masa e pensionit shtohet me 2 për qind të pagës mesatare referuese. Masa e pensionit të parakohshëm, në çastin që lind e drejta për përfitim: a) për personat, që nuk kanë paguar kontribute suplementare, nuk mund të jetë më e madhe se dyfishi i pensionit bazë, të përcaktuar nga Këshilli i Ministrave, në përputhje me ligjin nr.7703, datë 11.5.1993 "Për sigurimet shoqërore në Republikën

e Shqipërisë", të ndryshuar; b) për personat, që kanë paguar kontribute suplementare, nuk mund të jetë më e madhe se dyfishi i pensionit bazë, të përcaktuar nga Këshilli i Ministrave, në përputhje me ligjin nr.7703, datë 11.5.1993 "Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, shtuar me 2 për qind të pagës mesatare referuese, për çdo vit sigurimi suplementar. Në këtë rast, shumica e pensionit mujor të parakohshëm nuk mund të jetë më e madhe se dyfishi i pensionit bazë

të pleqërisë, plus 20 për qind të pagës referuese të muajit të fundit të punës. Pensioni i parakohshëm për vjetërsi shërbimi ndërpritet kur përfituesi rikthehet në shërbimin aktiv. Kur përfituesi i pensionit të parakohshëm punësohet në vende të tjera pune, që nuk lidhen me funksionin e tij të mëparshëm, masa e pensionit të parakohshëm për vjetërsi shërbimi bëhet sa një pension bazë, i përcaktuar nga Këshilli i Ministrave, në përputhje me ligjin nr.7703, datë 11.5.1993 "Për

sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar. Në rastet kur karriera është ndërprerë, për shkaqet e përcaktuara, e drejta për pension të parakohshëm për vjetërsi shërbimi, nëse plotësohen kushtet e përcaktuara për këtë përfitim, fillon pas 24 muajve.

PENSIONI I PARAKOHSHËM

Llogaritja e një pensioni të parakohshëm për vjetërsi shërbimi: $PPVSH = PMRMN \times VSH \times 1.5\%$. $PPVSH =$ Pensioni i Parakohshëm

për Vjetërsi Shërbimi. $PMRMN =$ Paga Mesatare Referuese Mujore Neto. $VSH =$ Vitet e Shërbimit. Por, në çdo rast, masa e pensionit të parakohshëm nuk mund të jetë më e ulët se pensioni bazë, i cili përcaktohet nga Këshilli i Ministrave, në përputhje me ligjin nr. 7703, datë 11.5.1993 "Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar".

Ushtarakut në rezervë/lirim D.N. i lind e drejta për të përfituar pensionin e parakohshëm për vjetërsi shërbimi më datë 20 Maj 2017. Ai ka 22 vite në shërbim dhe paga mesatare referuese mujore neto është 44,000 lekë në muaj. Llogaritja e pensionit të parakohshëm për vjetërsi shërbimi bëhet në këtë mënyrë:

$PPVSH = 44,000 \text{ lekë} \times 22 \times 1.5\% = 14,520 \text{ lekë} / \text{muaj}$. Por, në çdo rast, masa e pensionit të parakohshëm nuk mund të jetë më e ulët se pensioni bazë, i cili përcaktohet nga Këshilli i Ministrave, në përputhje me Ligjin nr. 7703, datë 11.5.1993 "Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar". Në rastin konkret masa e pensionit bazë më datë 20 Maj 2017 është 13,014 lekë në muaj, pra masa e llogaritjes e $PPVSH$ do të jetë 14,520 lekë në muaj. Pra, ish-ushtaraku D.N. në datën 20 Maj 2017 do të përfitojë pension të parakohshëm për vjetërsi shërbimi në masën 14,520 lekë / muaj.

Si vdiqën 5 fëmijët e familjes së Ramazan Habilit në vitin 1945

Rrëfimi i vajzës së mbijetuar Asije Elezi Habili: Më vdiqën para syve nga uria dy motrat Nexhmije dhe Mukades, vëllai Xhevati dhe mbesa 6-muajshme Fatmira



Xhevat Habili

NERITAN KOLGJINI
TIRANE

Kur kam dëgjuar për herë të parë historinë që vijon më poshtë, m'u duk aq e frikshme për t'u rrëfyer apo për t'u përmendur, sa që nuk më jepej ta memorizoja e aq më pak ta shkruaja. Por me kohë, me zgjerimin e njohjes dhe të leximeve të kësaj natyre, m'u shtua kërshtëria ta njihja më thellë, më së brendshmi e më në tërësi gjithë këtë seri episodesh, që rrëfen se si u martirizua e për pak u zhduk një familje e tërë shqiptare në kampet e shfarosjes në Berat e Tepelenë. Ishte viti 1945 dhe familja e Ramazan Habilit nga Gjinaj (Habilaj) i Kavajës, internohet e gjitha në Berat, pa asnjë bazë ligjore, pa bërë asnjë krim, pa shkelur kurrfarë ligji, pa shkak e arsye njerëzore, por veçse ishin familjarët e një kundërshtari politik, Ramës, asgjë tjetër! Në listën e të internuarve bënin pjesë bashkëshortja e tij dhe fëmijët e vegjël të gjithë 18 vjeç e poshtë; motra e Ramës, Laje Gjoci (Habili) bashkë me djalin e vet; Njerka e Ramës, Pashja; e Reja e Ramës Nafija dhe vëllai i tij, Dalipi. Prej këtyre njerëzve arrijnë të shpëtojnë vetëm më të mëdhenjtë e më të fortët fizikisht, athua se kishim të bënim me një proces seleksionimi biologjik, apo një eksperiment racial ku vetëm më rezistenti arrin t'ia dalë në fund të kësaj sprove çnjerëzore të quajtur internim në kampet e komunizmit. Nga kjo familje vdesin 5 fëmijë dhe njerka e Ramës, një plakë e moshuar e njihej si Nana e Tushes. Vëllai, Dalipi, humb aftësitë mendore për pak kohë, nga torturat e xhelatëve që kishin pushtetin.

Për të dhënë detaje rreth kësaj tragjedie sa familjare aq edhe kombëtare, kemi biseduar me një prej të mbijetuarve të kësaj ngjarjeje rrëqethëse, Asije Elezin (Habili), e cila sot që i ka kapërcyer të 80-tat, me zor reziston të rrëfjë çka parë e vuajtur personalisht në ato vite të skëterrshme në kampet e internimit Berat e Tepelenë.

Kush ishte i internuar prej jush, dhe në ç'kohë?

Jemi internuar në momentin që e kanë marrë komunistët pushtetin e duhet të ketë qenë fillimi i vitit 1945. Kemi qenë Nanë Vathja (gruaja e Ramës shën. ynë), unë, Xhevati, Qefserja, Mukadesi dhe Nexhmija (familja e ngushtë e Ramës shën. ynë); pastaj ishin Pashja ose Nana e Tushes, (njerka e Ramës); Hallë Laja (motra e Ramës, e ve, e martuar me Beqir Gjocin, shën. ynë) bashkë me djalin e saj Osmanin; gjithashtu kishim Nafijen (e reja e Ramës, nusja e djalit, Hamidit), shtatzanë, si edhe xha Dalipi (vëllai i Ramës). Bashkë si grup kemi pasë edhe një grua me dy vajza nga Luzi i Kavajës, Diqe Hoxha, e cila ishte e internuar për shkak se djali i tyre Mal Hoxha, ishte në arrati bashkë me Babë Ramën.

Po Ragipi, djali i dytë i Ramës ku ndodhej?

Ragipi nuk ishte me ne, sepse ditën që kanë ardhë në kullë (në Habilaj, shën. ynë) të na merrnin e të na fusnin në burgun e Kavajës, ai ishte jashtë shtëpisë. Ndërsa po kthehej nga shkolla, ne e pikasëm që na kishin rrethuar dhe Nafija del në dritare e i thotë "largohu, sepse jemi të rrethuem!" Ai largohet nga fshati dhe dimë që Babë Rama e ka lënë amanet te një familje në Romanat të Durrësit. Atje ka ndëjtë mbi 6 muaj dhe pastaj ka ardhë në Bullutje, te familja e Rap Togut (Sadiu), të cilin e kishim nip të shtëpisë. Aty e zbulojnë dhe e arrestojnë. E torturojnë atë dhe të zotin e shtëpisë në mënyrë çnjerëzore, për shkakun se kishin takuar me Ramën

e duhej të tregonin se ku ishte ai. Pasi e mbajnë disa kohë në birucë, e sjellin në Berat edhe Ragipin.

Ku banonit dhe me se jetonit në kampin e Beratit?

Në Berat kemi qendruar rreth 4 vjet. Në fillim na futën në "Shtëpinë e Pashait" në lagjen Mangalem, pastaj më vonë në Kala të Beratit. Verës na çonin në Kuçovë të punonim në bujqësi ose punë që na caktonin, pa kurrfarë pagese, pra punë e detyruar, kurse dimrit na mbyllnin në Kala. Këtu na kanë vdekur dy fëmijë.

Kur ishim në Mangalem vdiqën Nexhmija, motra e vogël tre vjeçe dhe Fatmira, vajza e vëllait tim Hamidit e Nafijes. Ne thonim të dëshpëruara, por dhe nga naiviteti i moshës, se

ç'është ky emër Fatmira, kur kjo e paska pasë këtë fat kaq të zi! Por ajo vdiq shpejt, as 6 muajshe, për shkak të mungesës së ushqimit, qumështit, kushteve primitive ku jetonim.

Nexhi, mbaj mend që ka vdekur duke vjellë gjak nga goja për shumë kohë. Se çfarë sëmundjeje ka qenë, nuk mund ta them, s'e kam idenë. Këtu sëmuret edhe Mukadesi, që shkurt i thërrisnim Desi. Ajo kërkonte trajtim mjekësor dhe kushte spitali e jetese të mira, të cilat, ne që ishim në zgrip të ekzistencës, as që mund t'i përfytyronim. Desi enjtet në të gjithë trupin, me sa mbaj mend ishte problem i veshkave. Ndërkohë na komunikohet se do të na transferojnë në Tepelenë. Kishim dëgjuar që ishte rrugë e keqe dhe e zorshme, prandaj Nanë Vathja i lutet doktorit që e mje-konte, ta mbante e ta shtronte Desin në spital, duke i qarë hallin si nënë dhe duke i rrëfyer vdekjen e fëmijëve të tjerë. Ai i përgjigjet se: "nuk mund ta dimë jetën e kësaj. Merreni me vete!" Ne e dimë se ishte e guximshme të bëje diçka të tillë, pasi Seksioni (i Degës së Brendshme shën. ynë) nuk të lejonte, kur bëhej fjalë për familjen e një të internuari. Pas dy javësh, në Tepelenë, Desi dha shpirt në një gjendje të parrëfyeshme.

Doktori na kishte porositur që të mos e ushqenim me thartira, kripëra, djegësira etj., por ushqimi ynë ishte vetëm me të tilla, pra bukë me kripë, me shëllirë, ose bukë me presh. Mbaj mend që një ditë e gjeta Desin pas derës duke mbledhur e gëlltitur mbeturinat e "vaktit", që ishin disa thërrime buke e bishta preshi të zverdhura, të cilat i kishim fshirë e bërë gati për t'i hedhur në plehra. E qortoj disi rëndë, madje duke i kujtuar edhe porosinë e doktorit! Por ah, si mund ta kuptoja unë adoleshente në atë kohë, se ajo ishte aq e uritur sa mblidhte edhe thërrimet bukës e bishtat e preshit të pangrënshme, që ne i kishim hedhur!

Mbaj mend se kur ishim në Berat, ajo shkonte përditë te Magia, zonja e shtëpisë, që kishte një tufë të vogël delesh. Ne i flisnim ashpër duke i kërkuar hesap pse?! Ajo na përgjigjej, – "më jep një lugë qumësht!" Desi e ndihmonte të luxirte dhentë jashtë e t'i fuste përsëri në kasolle dhe Magia



e shpërblente me një lugë qumësht.

Këtu sëmuret edhe Osmani, djali i hallë Lajes, i cili enjtet gjithashtu në të gjithë trupin. Ka qenë në moshë me vëllain tim Ragipin. Halla bën lutje për ta liruar, që për fat iu aprovua. Osmani vdes pas pak kohësh në shtëpi. Edhe djali tjetër, Sula i kishte vdekur dha ajo ngeli vetëm me vajzën, Filen. Por hallë Lajen do ta takonim në Tepelenë pak kohë më vonë, kur e internojnë për së dyti, bashkë me xha Dalipin, për shkak të takimeve që kishin pasur me Babë Ramën.

Po në Tepelenë, si ju çuan?


-Neve na ngarkuan në një kamion, që shoqërohej me nga 3 policë secila, dhe kemi qenë nga 2 ose 3 familje në një makinë, në karrocë lart, zbuluar. Ishte verë të paktën. Kemi udhëtuar për shumë kohë e dikur mbërritëm të rraskapitur në Turan të Tepelenës, te kazermat e ushtrisë italiane. Gjatë udhëtimit pati një aksident, një makinë u përmbys afër Roskovecit, nëse e mbaj mend, dhe vdesin dy prindërit, por shpëtojnë 4 fëmijët, të cilët "fluturuan" nëpër ferra. Më kujtohet babai i tyre që i ishte ngulur në trup një nga spondet e makinës, si ta kishin kryqëzuar! Tmerr ta shihje me sy atë skenë.

Në Tepelenë nuk e dinim ç'na priste, dhe as që e përfytyronim dot gjithsesi. Por, çfarë vuajtëm e hoqëm ishte jashtë çdo imagjinate. Na lanë 8 ditë rresh pa bukë dhe asnjë mundësi për t'u ushqyer. Njerëzit filluan të vdesin nga uria. Ndërkohë drurët e shkurret rrotull kampit u "pastruan"

 <p>SHPALLJE ANKANDI</p> <p>SHOQËRIA PËRMBARIMORE "CORRECTOR" SHPK, ZHVILLON ANKANDIN E II-TË, PËR SHITJEN E PASURIVE TË PALUAJTSHME</p>	<ul style="list-style-type: none"> Tokë - Trull me Nr. Pasurie 49/25, Volum 9, Faqe 41, Zona Kadastrale 3031, me sipërfaqe 4.000 m², regjistruar në Zyrën Vendore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Fier, në vlerën €ur 16,800 (gjashtëmbëdhjetë mijë e tetëqind euro); 	<ul style="list-style-type: none"> Ndërtesë me Nr. Pasurie 49/25-ND1, Volum 10, Faqe 174, Zona Kadastrale 3031, me sipërfaqe 241.5 m², regjistruar në Zyrën Vendore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Fier, në vlerën €ur 196,000 (njëqind e nëntëdhjetë e gjashtë mijë euro); 	<ul style="list-style-type: none"> Ndërtesë me Nr. Pasurie 49/25-ND2, Volum 10, Faqe 175, Zona Kadastrale 3031, me sipërfaqe 160.3 m², regjistruar në Zyrën Vendore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Fier, në vlerën €ur 164,080 (njëqind e gjashtëdhjetë e katër mijë e tetëdhjetë euro); 	<ul style="list-style-type: none"> Ndërtesë me Nr. Pasurie 49/25-ND3, Volum 10, Faqe 176, Zona Kadastrale 3031, me sipërfaqe 126.8 m², regjistruar në Zyrën Vendore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Fier, në vlerën €ur 183,120 (njëqind e tetëdhjetë e tre mijë e njëqind e njëzetë euro); Cmimi i ankandit të dytë është si më sipër.
	<p>KONTAKT: CEL: 0684000061 OSE NË ADRESËN E E-MAIL: ARMELS.LOLE@NCHB.AL</p> <p>Ankandi zhvillohet dt. 25/04/2018, ora 15.30 në adresën, Rruga "Kavajes", Ndertesat 27, Hyrja 1, Kati i III -te, Tiranë</p>			



Ragib, Asije, Vathe, Qefsere, Habili, Hekuran Saraçi



nga gjethet, që filluam t'i mbledhim e t'i ziejmë në formë lakrash, me një dorë oriz, sa për të shuar urinë. Filloi dizanteria në masë dhe kufiri që dalonte njeriun nga shtaza ishte shumë afër. Njerëzit u bënë si të çmendur e flisnin me vete.

Na trego pak për Desin, si e përbaloi këtë gjendje?

–Në këto kushte ne duhej të mendonim edhe për sëmundjen e Desit të vogël, 8 vjeçe. Ajo ishte e uritur dhe nuk kishim asgjë ç't'i jepnim. Mbjaj mend që i thoshte Nanë Dijes (Dije Hoxha, nga Luzi i Madh, e internuar me dy vajzat, Bakushen dhe Dritën shën.ynë), – “pse, nanë Dijsa, kto laknat tueja zijnë mô shpejt?!...”

– “Ashtu!? Hajt Desi, se të jap nana ty lakna, tashi, menjherë!” I jepte nga pjesa e vajzave të veta, të sëmurës Desi. Ne ishim gjashtë fëmijë, “laknat”, një përzierje gjethesh rrushi të egër, ferrash e barishtesh, i vinim në sasi më të madhe çka kërkonte më shumë kohë të zienin, por Desi nuk priste dot.

Pas 8 ditësh urie të skajshme, filluan të na sjellin bukë misri nga Berati. Bukë kishte emrin, sepse në fakt ishte diçka si punë brumi, i mykur, gati jeshil, i papjekur fare dhe në sasi krejt të vogël për nevojat e një rëzve. Filluam ta racionojmë dhe ta ndajmë. I takonte pa ekzagjerim, një copë e barabartë me një kuti shkrepe të sotme që mban 50 fije. A mund të rronte njeriu me këtë sasi ushqimi?!... Por vdekjet e shumta, në fakt sikur e lehtësuan disi këtë uri. Vdisnin mbi

8 ose 10 vetë në ditë. Kur vdisnin 3 ose 4, quhej ditë me pak të vdekur. Aty ishin 8 kazerma dhe për 2 muaj vdiqën, kush i mban mend sa njerëz, gjysma ndoshta.

Njëherë e shoh Desin që hëngri një racion tepër dhe si më e madhe, i them: –pse e hëngre edhe racionin tim? Ajo më sheh e trembur dhe si e habitur, ndërsa ndërhyt Nanë Vathja që thotë: –s'ka gjë, se unë nuk dua, le ta hajë Desi copën time!

Deri sa të vdes nuk me harrohen ato pamje kur ne s'kishim si ta ushqenim apo kuronim motrën tonë të vogël, e cila vdiq më shumë nga uria sesa nga sëmundja. Kushtet higjienike ishin të tmerrshme. Na jepnin mundësi vetëm një herë në javë të lanim rrobat në përrua, thjesht me ujë mali, pa sapun, detergjente etj.. Na shoqëronin e ruanin me policë, të cilët ishin ca ish-partizanë, që s'kishin asgjë të përbashkët me njeriun.

Të internuarit i ndanë në 2 grupe, të aftët për punë dhe të pamundshmit, për shkak të moshës etj.. Neve që quheshim të rinj, unë dhe Ragipi, na dërguan në Memaliaj, ku punonim me kazmë për hapjen e rrugës automobilistike. Jetonim në çadra të ushtrisë.

Një mëngjez vjen një roje dhe më njofton se më kërkonte vëllai. Dal të rrethimi dhe takoj tim vëlla, Ragipin, i cili më thotë të bëhem gati e të shkoj në kamp, sepse kishte ardhur Dajë Hekri (Hekuran Saraçi, daja, shën. ynë) që kishte porosi nga Bab Rama të mos kthehej pa i parë të gjithë fëmijët. Unë e kundërshtoj dhe i them: “po ti, pse nuk vjen?” Ai më shpjegon se nuk e

linim të ikte nga puna.

Nisem për në kazerma bashkë me një plak që na sillte ushqimin me kalë, i cili ishte nga Malësia e Shkodrës. Rrugës ai më pyeste se sa motra apo vëllezër kisha, sa vjeç ishin etj., etj.. Unë nuk po u jepja dum fjalëve të tij, megjithatë i thashë se jemi 3 motra e 3 vëllezër! Ai më pyeste për emrat e për moshën dhe gati më bezdisi me ato pyetje që unë i quaja trashanike! Kur afrohem afër kampit në Turan, aty dëgjoj zëra grash që pëshpërisnin: “ja kësaj i ka vdekur motra!” Nuk po e kuptoja dhe më dukej e pabesueshme që ato fjalë të ishin për mua! Kur mbërrij në kazermën nr.2 ku ishte familja ime, mësoj se Desi ishte varrosur! Filloj e ulurij dhe sot e kësaj dite nuk më del hidhërimi për humbjen e motrës. Doja të shkoja ta shihja edhe njëherë e këmbëngula të hapnim varrin, sa për ta puthur për herë të fundit. Më sqaruan se e kishin futur direkt në tokë, pa arkivol, apo “shulse”, ose dërrasa varri që të mund të mbronin kufomën. Ma bënë të qartë se gjithë ato gurë e dhë e kishin prishur tashmë fytyrën e saj të njomë! Qaj aty deri sa s'më dilnin më lotë e kthehem me shpirtin copë në kazermë, ku vazhdonte jeta e internimit! Edhe sot, më thotë mendja, e di vendin ku është varrosur, në atë shpat kodre në Turan...

Nanë Vathja kishte kërkuar t'i sillnin djalin, Ragipin, që të varrose të motrën, por nuk i dhanë leje. Desin e varrosën disa pleq që ishin ende gjallë. Vdekja e Desit në moshën 8 vjeçe, na e rëndoi gjendjen shpirtërore

dhe mbaj mend që shumicën e kohës e unë e kaloja në vaj e lotë.

Ju kenë pasur edhe një vëlla që ju ka vdekur në Tepelenë...

–Po, Xhevat... Ju betohem që çastet e fundit të jetës së tij janë të pabesueshme, po të mos i kesh parë me sy. Unë qëllova fatkeqe që i kam parë e po jua rrëfej. Ishte muaji gusht, një vit pas vdekjes së Desit. Xhevat in e zu dizanteria, por nuk na tha. Për 2 ditë rresht shkonte e vinte pa pushim në banjot që ishin 40m larg kazermës ku rrinim. Pastaj u dorëzua e i tha Nanë Vathes: “Jam keq, më dhemb barku, jam sëmurë!” Ajo e vizitoi te mjeku, në fakt një infermiere e kampit. Ajo konstatoj se kishte dizanteri dhe thotë se do t'i bëjë inxheksione. Fillon kura, çdo ditë nga një gjilpërë, por asnjë efekt. Gjendja rëndohet. Vetëm 5 ditë munda të shkoj në banjo. Pastaj nuk çohesh dot më nga krevati. Filloi të nxjerrë veç gjak nga zorrët, sepse nuk hante gjë. Nuk i treguam njeriu, sepse kishim frikë mos na nxirrnin nga kampi, pasi dizanteria është ngjitëse. Dy–tri ditët e fundit gjaku nuk pushonte. Nana ia lante lecat që ia vinim poshtë dyshekut, në çezme dhe na thoshte që kullonin shumë gjak, sikur të ishte ndonjë kafshë e therur, aq gjak rridhte.

Ditën e fundit, kur po jep shpirt, vjen infermierja për të bërë adetin. Xhevat i thotë: –“kot vjen, nuk po më bójnë gjë gjylponat e tuja! Nesër mos hajde mô!”

Pak kohë pasi ikën infermierja, ai kërkon një gotë ujë. Nana më thërret e thotë: –hyr në krevat, merre e ngreje ndenjor, që të pijë ujë më lehtë. Ulem në krevat, e sistemoj mes këmbëve të mia dhe ia fus krahët rreth trupit për ta mbajtur drejt, duke ia mbështetur kokën në gjok. Afrohet nana dhe i zgjat filxhanin me ujë. Ai përcjell glënjëkën e parë, ndërsa të dytën nuk e kalon dot, duke e derdhur buzëve anash. Nana në këtë çast e sheh mirë se çfarë ndodhi, por me të lehtë më thotë:

–“Mbaje mirë, se po e zë gjumi! Shtrije me kujdes në shtrat!” I bindem dhe kthehem duke e parë në fytyrë. M'u duk se ishte pakëz i ndryshuar dhe sikur i kishte rënë një hije e veçantë. Në atë moment shoh nanën që t'ia mbyllte sytë e t'i thotë:

–Të keqen nona, shpejt më le! Qaj tesalallik (jetë të përbashkët shën.ynë) paske pasë ti me mu!?

Në atë moment kuptova që vëllai kishte dhënë shpirt dhe ia dhashë kujës, sa besoj më kanë ndier në të gjitha kazermat. Xhevat u sëmur të premtën e dha shpirt të shtunën pas 8 ditësh! Ishte vetëm 13 vjeç.

Nana lidh dyshemenë për beli dhe nisjet për në Drejtorinë e Kampit. Takohet me Nëndrejtorin, i cili mbaj mend që quhej Syrja. E njofton se i ka vdekur djali dhe i lutet t'i thotë një polici të shkojë në Tepelenë sa për t'i blerë pak metra kambrik, për qefin. Të internuarit nuk i linin të dilnin jashtë kampit. I drejtohet me fjalët:

–Zotni, më ka vdekur djali!

Mirë e ka bërë! – i përgjigjet ai.

Mirë, thua ti, por unë kam hall ta varros, e s'kam qefin! – i thotë nana e shkretë!

Ka sa të duash fier, gur e dhë! – ia kthen zyrtari me emrin Syrja.

Nana kthehet në kazermë, gris disa rroba e sajton me to një qefin. Ndërkohë kishim lajmëruar një hoxhë, të internuar kuptohet, i cili i bën adetet e xhenazes, sipas rregullit mysliman duke e larë e pastruar. Ndërsa një plak tjetër na ndihmon të rregullojmë një arkivol, i cili u sajua prej një arke dërrase që kishim me vete. Kishim nijetin që t'ia merrnin eshtrat Xhevatit prej aty, e t'ia varrosim në Kavajë.

Një grup pleqsh, njësoj si në rastin e vdekjes së Desit, e morën dhe e çuan vëllain e vogël në varreza të këmbët e urës së Tepelenës rreth 400 metra nga kampi. Varret ishin gati, s'kishte nevojë me i hapë.

Edhe këtë xhenaze e fusin në tokë jashtë rregullit, duke mos i vënë shulse apo dërrasa vorri, ndërsa arka që luante rolin e arkivolit është copëtuar me të rënë gurët e parë, duke ia shtrydhur trupin e copëtuar kockat. Ne si myslimanë besojmë se trupi duhet ruajtur, pasi vetëm në krye të 40 ditëve ai fillon prishjen e dekompozimin. Nana na urdhëron përsëri:

–“Ecni të hajmë darkë! Ju kôm juve tash që ka ikë Xhevat! Ai ka shku në vend të vet! Nuk ôsht mir' të mos hajmë sonte, se i bôhet keq atij!”

Kishte varrosë 4 fëmijë të vetët e kishte frikë e shkreta se do t'i vdisnim edhe ne dy motrat që kishim ngelë! Nana e Tushes, njerka e Bab Ramës s'levizte dot nga shtrati. Mallkonte veten që po rronte e po shihte vdekjen e fëmijëve. Pas 6 muajsh vdiq edhe ajo dhe e varrosëm po te varreza e të internuarve.

(Marrë me shkurtime nga “Zërat e Kujtesës” mbledhur nga Instituti i Studimit të Krimeve dhe Pasojave të Komunizmit)



SHPALLJE ANKANDI

SHOQËRIA PËRMBARIMORE “CORRECTOR” SHPK, ZHVILLON ANKANDIN E II-TË PËR SHITJEN E PASURISË TË PALUAJTSHME

- Ndërtesë me Nr.7/64-N5; Vol.4, Fq.60, Zona kadastrale 2646, me regjistër hipotekor Nr. 2, datë 5 Shkurt 2008, me sipërfaqe 50 m², ndodhur në Memaliaj, Tepelenë, në pronësi të Muin Çela;

Çmimi i ankandit të dytë është EUR 12,880 (dymbëdhjetë mijë e tetëqind e tetëdhjetë euro);

Ankandi zhvillohet dt. 24/04/2018, ora 16.00 në adresën, Rruga “Kavajes”, Ndertes 27, Hyrja 1, Kati i III –te, Tiranë.

KONTAKT: CEL. 0684000061 OSE NË ADRESËN E E-MAIL: ARMELS.LOLE@NCHB.AL

SHBA, Britania dhe Franca godasin regjimin e Assadit në Siri me raketa

Lëshohen 110 armë "inteligjente" nga anijet dhe avionët kundër tre objekteve

Trump ka hyrë në aksion pas sulmit të armëve kimike nga ana e forcave të presidentit Assad. Tre objekte janë goditur në Siri duke u gdhirë dita e shtunë nga zjarri i luftanijeve dhe aeroplanëve të shteteve perëndimore. Presidenti amerikan Donald Trump u shfaq në televizion në orën 3, sipas orrës evropiane dhe bëri të ditur se SHBA, bashkë me Mbretërinë e Bashkuar dhe Francën, po nisnin një sulm me raketa kundër Sirisë. Tre janë objektivat e goditur nga sulmi që zgjati për rreth një orë: një qendër kërkimesh në Damask, një depo për armë kimike dhe një qendër komande në Homs. Sipas asaj që tha vetë Trump, sulmet kishin si qëllim të godisnin vendet e prodhimit të armëve kimike. "Ne nuk duam të përmbysim Assadin, por të ndalojmë përdorimin e armëve kimike", ka theksuar Theresa May, kryeministria e Britanisë. I vetmi lajm i mundshëm për civilët e përfshirë në sulm vjen nga televizioni sirian, sipas të cilit tre janë të plagosurit nga sulmi në bazën e Homs. Mund të jenë lëshuar mbi 110 raketa. Operacioni i Trumpit vjen një javë pas sulmit me armë kimike në Siri, kundër civilëve rebelë të fshehur. Për këtë sulm fajtor është quajtur presidenti Assad. Të paktën pesë njerëz vdiqën. Trump, përveç Assad, kishte vendosur gishtin dhe mbi Rusinë dhe Iranin, bashkëpunëtor dhe aleat të regjimit. Ai kishte premtuar një përgjigje. Efortë ka qenë përgjigja e Rusisë, përmes ambasadorit rus në SHBA. "Sulmi është një shuplakë për presidentin tonë Putin dhe nuk do të mbetet pa pasojë", ka thënë ai. Por Franca siguron se "Rusia ishte paralajmëruar për përshpejtim të sulmeve". E më pas vjen dhe komenti i ministrit të Jashtëm sirian: "Një sulm barbar dhe brutal". Sulmi u dënua dhe nga ministri i Jashtëm iranian: "Do të ketë



pasoja rajonale". Mes lojtarëve të tjerë të Lindjes së Mesme, komente në favor kanë bërë Izraeli dhe Turqia. Mbështetje për sulmin edhe nga Kanadaja dhe Japonia.

ÇFARË NDODH TANI?

Aksioni për momentin u fokusua vetëm në një natë dhe ka qenë një paralajmërim për qeverinë e Assadit, edhe pse burimet e mëvonshme të administratës amerikane kanë shpjeguar se "operacioni nuk ka përfunduar. Ajo që patë sot nuk është fundi i përgjigjes së Shteteve të Bashkuara".

GODITJA

Sulmi i bashkërenduar me

Francën dhe Britaninë, shënon herën e dytë që presidenti Trump përdor forcën ushtarake kundër Sirisë. Presidenti Trump e njoftoi goditjen ushtarake të premtën në mbremje gjatë një fjalimi drejtuar vendit me televizion. Presidenti tha se sulmet synojnë t'i japin fund përdorimit të armëve kimike nga qeveria e Sirisë. Javën e kaluar të paktën 40 vetë u vranë dhe qindra u sëmurën në qytetin e Dumës, për shkak të asaj që Shtetet e Bashkuara dhe vende të tjera besojnë se ishte një sulm me armë kimike nga qeveria e Sirisë. Qeveria e Sirisë e ka mohuar përdorimin e armëve kimike. Kryeministria britanike Theresa May tha se veprimi i

aleatëve nuk synon "përfshirjen në një luftë civile". "Nuk ka të bëjë me ndryshimin e regjimit. Është një goditje e kufizuar dhe me objektiva të qartë, që nuk synon përshkallëzimin e tensioneve në rajon dhe bën gjithshka mundet për të parandaluar viktimat mes banorëve civilë", tha kryeministria May të shtunën. Agjencitë e lajmeve Reuters dhe AFP njoftuan se shpërthime të fuqishme janë dëgjuar në kryeqytetin e Sirisë, Damask, në kohën që presidenti Trump njoftoi fillimin e goditjes ushtarake. Sipas Sekretarit amerikan të Mbrojtjes James Mattis, operacioni ka përfunduar dhe "ai dërgoi një mesazh shumë të fortë". Presidenti Trump veçoi mbështetësit kryesorë të Sirisë: Rusinë dhe Iranin, që nuk e ndaluan regjimin sirian të përdorte armë kimike. Ai kritikoi veçanërisht Rusinë, që nuk mbajti premtimin e vitit 2013 për të eliminuar armët kimike të Sirisë. "Sulmet e ditëve të fundit nga Asadi dhe reagimi ynë i sotëm, është pasojë e drejtpërdrejtë e dështimit të Rusisë për të vepruar", tha presidenti Trump.

VEPRIMI

Ndryshe nga sa ndodhi me Kim Jong un-in, Donald Trump këtë herë nuk u mjaftua



vetëm me retorikë: Presidenti amerikan, së bashku me atë francez dhe shefen e Ekzekutivit britanik, i dhanë dritën jeshile goditjen së tre objektivave në Damask dhe Homs gjatë natës. Në shënjestrën e bombardimeve u vendos arsenal i kimik i regjimit të Bashar al Assadit, përbindëshi që vret njerëzit e vet siç e etiketon shefi i Shtëpisë së Bardhë, ndërsa sulmi shihet edhe si sfida direkte e tij ndaj Putinit për mbështetjen e vrasjes masive të të pafajshmeve. "Kombet e Britanisë, Francës dhe Shteteve të Bashkuara të Amerikës përdorën fuqinë e tyre legjitime kundër barbarizmit dhe brutalitetit. Synimi i veprimeve tona sonte është të krijojë një pengesë të fortë kundër prodhimit, përhapjes dhe përdorimit të armëve kimike", u shpreh Trump.

Pas tij, ishte Theresa May ajo që sqaroi në një konferencë për shtyp arsyet e këtij vendimi. "Ne nuk mund të lejojmë që përdorimi i armëve kimike të kthehet në një normalitet brenda Sirisë apo dhe rrugëve britanike. Do të kishim preferuar një zgjidhje alternative, por në këtë rast, nuk ekzistonte një e tillë", tha Theresa May. Kryeministria britanike theksoi se aksioni nuk kishte për qëllim rrëzimin e Assad duke shtuar se ndaj përdorimit

të forcës nuk kishte praktikisht asnjë alternativë tjetër.

Por pavarësisht kësaj, dy aleatët e Sirisë, Moska dhe Teherani kërcënojnë me shpagim. Ambasadori rus në OKB deklaroi se sulmi nuk do të kalojë kaq lehtë. Të njëjtat tone përdori edhe Ministria e Jashtme iraniane, e cila paralajmëron për pasoja rajonale. Moska sqaroi për çdo rast se raketat nuk kanë sulmuar as bazat, as njerëzit dhe as mjetet e saj. Megjithatë ekspertët e saj të politikës se jashtme si Konstantin Kosachov, e cilësuan sulmin një shkelje të jashtëzakonshme të së drejtës ndërkombëtare, sepse "është një goditje ndaj një shteti sovran, pa ndonjë shkak ligjor."

Ndërsa NATO, Izraeli dhe Turqia dolën në mbështetje të sulmeve, që zvogëlojnë sipas aleancës, aftësinë e regjimit sirian për të vazhduar sulmet me armë kimike ndaj popullit të tij. Kjo valë bombardimesh përbën goditjen më të qenësishme ndaj qeverisë së Bashar al Assadit nga fuqitë perëndimore në shtatë vite lufte civile që kanë gjujzuar vendin. Ajo vjen si përgjigje ndaj sulmit të dyshuar kimik në Douma javën e kaluar.

Damasku zyrtar pretendon se gjithsej janë lëshuar gati 30 raketa, një e treta e të cilave janë goditur nga sistemet e tij të mbrojtjes antiajrore.

REAGIMET

BE dhe NATO, OK për sulmin kundër Assadit, kundër Moska dhe Irani

Presidenti i Komisionit Evropian, Jean-Claude Juncker, duke rikujtuar se regjimi sirian nuk ka shënjestruar civilët me armë kimike për herë të parë, theksoi se ky sulm duhet të jetë i fundit. Juncker në një deklaratë me shkrim tha se bashkësia ndërkombëtare ka detyrim që të identifikojë dhe të kërktojë llogari prej atyre që përdorin armë kimike. Ai duke theksuar se BE-ja fuqishëm dënon përdorimin e armëve kimike, theksoi se të gjitha palët duhet të bëjnë përpjekje për një zgjidhje politike e ne-

gocuar nën kujdesin e OKB në Siri, ku lufta ka hyrë në vitin e 8-të. "Regjimi sirian nuk përdori për herë të parë armë kimike ndaj civilëve, por kjo duhet të jetë e fundit", paralajmëroi Juncker.

NATO ka mbështetur ndërhyrjen ushtarake të Shteteve të Bashkuara të Amerikës, Britanisë së Madhe dhe Francës në Siri, në të cilin u bombarduan disa fabrika ku prodhoheshin armë kimike për regjimin e Assad. "Ky sulm do të dobëson fuqinë e regjimit të Assadit në kuptimin e sulmit të sërishëm me

armë kimike", ka deklaruar sekretari i përgjithshëm i NATO-s, Jens Stoltenberg. Ai po ashtu rikujtoi se, aleatët edhe më parë kanë dënuar sulmet me armë kimike në Siri, duke theksuar se ato paraqesin shkelje të qartë të rregullave dhe marrëveshjeve ndërkombëtare.

Kancelarja gjermane Angela Merkel është shprehur dhe më herët se Gjermania nuk bën ndërhyrje ushtarake në Siri, teksa mbështet sulmet e SHBA, Britanisë dhe Francës kundër përdorimit të armëve kimike ndaj civilëve.

Në një deklartë të saj Merkel thotë se Rusia ka penguar një hetim të pavarur të asaj që ndodhi me armët kimike, përmes bllokadës së saj në Këshillin e Sigurimit të OKB-së. "Duke pasur parasysh këtë, aleatët tanë amerikanë, britanikë dhe francezë kryen sulme ajrore kundër objekteve ushtarake të regjimit sirian sonte. Kjo qasje synon të kufizojë aftësinë e regjimit për të përdorur armë kimike dhe për të parandaluar atë nga shkelje të mëtejshme të Konventës për Armët Kimike. Ne mbështesim që aleatët



tanë amerikanë, britanikë dhe francezë, si anëtarë të përhershëm të Këshillit të Sigurimit të OKB-së, kanë marrë përgjegjësinë në këtë mënyrë. Operacioni ushtarak ishte i nevojshëm dhe i përshtatshëm

për të ruajtur efektivitetin e ndalimit ndërkombëtar për përdorimin e armëve kimike dhe për të paralajmëruar regjimin sirian për shkelje të mëtejshme", shprehet Merkel në deklaratën e saj.

Tava e Elbasanit, fama që i dha Mehmeti II kur pushtoi Krujën



NGA **DR. ARIOLA PRIFTI**

(Vijon nga numri i kaluar)


Përsa i përket përdorimit të perimeve në ushqimin e përditshëm të fshatarësisë, duhet thënë se kishte diferencë të mëdha krahinore. Në shumë zona malore të vendit, përdorimi i perimeve ka qenë shumë i pakët, madje edhe në ditët tona atje perimet po përhapen me shumë vështirësi. Nga regjistri osman i vitit 1485 për Sanxhakun e Shkodrës, mësojmë se në zonën e ulët të Shkodrës mbilleshin më shumë bathë e thjerza dhe fare pak qemë

e spinaq, kurse në Rrafshin e Dukagjinit më shumë qepë e spinaq e pastaj thjerza e bathë. Në shekujt e mëvonshëm kanë hyrë gradualisht në përdorim bizelet e fasulet etj. Madje, ka pasë zona në Shqipërinë e Mesme ku fasulet e ziera në poçe përbënin gjellën e përditshme pothuaj për shumicën e familjeve fshatare. Aty-këtu u hidhej edhe pak bulmet.

Përsa i përket patates, ajo duket se ka hyrë në Shqipëri që në fillim të shekullit XIX, sipas F. Konicës në vitin 1805 ("Albania", Bruksel 1898, f. 33). Por në përdorim të fshatarësisë ajo mundi të hyjë vetëm në

shekullin XX e sidomos mbas Luftës së Parë Botërore. Në Shqipëri kishte zona ku rritja e perimeve ishte specialitet i fshatit apo i krahinës. Si të tillë mund të përmenden perimerritësit e Drishtit (në rrethin e Shkodrës), ata të Lunxhërisë, të Përmetit, të Leskovikut e të Korçës etj., që kultivonin lloje të shumta perimesh dhe me cilësi të lartë. Aktualisht në Shqipëri përdoren për ushqim mbi 35 lloje perimesh, sepse në shumë zona klima është shumë e favorshme për rritjen e tyre....

vijon në faqet 13-16



Identite të lëvizshme, rasti i Elena Gjikes në Lëvizjen Kombëtare Shqiptare

Identitetet janë të lëvizshme. Në rrethana dhe situata ku një kulturë preonimon në formimin e një popullate, atëherë dhe përfaqimi i identitetit etnik të kulturës që është përfaqësuese, është më i lehtë për njerzit dhe përfaqësues të shquar të komunitetit. Përfaqësjet moderne përsa i përket identiteteve etnike dhe kulturore e quajnë si diçka të natyrshme braktisjen dhe përfaqimin e një identiteti tjetër....

NGA **DR. DORIAN KOÇI**

faqe 17



"Anija Vlora", si silleshin në kushte sekretit absolut raketat nga Kina në Durrës

Enveri i tha inxhierit: Këto raketa janë blerë me florinj të popullit! Në vitin 1959 – 1960, kohë kur Shqipëria ishte anëtare e Traktatit të Varshavës, vendi ynë u armatos me raketa moderne sovjetike, që e rritën fuqishëm potencën ushtarake mbrojtëse në raport me fqinjët potencialisht armiqësorë. Me nderprerjen e marrëdhënjëve me BS, u ndërpre si për të gjitha furnizimet, edhe furnizimi me raketat e drejtuara kundërajrore Sam 2, krenaria e teknologjisë ushtarake të asaj periudhe që përbënin garanci për fuqizimin e mbrojtjes së Atdheut....

NGA **MARK BRUNGA**

faqe 20-21

Kulinaria/ Ushqimi dhe mënyra e të ngrënit tradicional në Shqipëri në shekullin XV-XX

Tradita / 1637, shënimet e Frang Bardhit për ushqyerjen e shqiptarëve, festat dhe hidherimet

TRADITA | KULINARIA

Tava e Elbasanit, fama që i dha Mehmeti II kur pushtoi Krujën

Ushqimi dhe mënyra e të ngrënit tradicional në Shqipëri në shekullin XV-XX. Servirja e ushqimit në enë balte dhe argjendi

NGA DR. ARIOLA PRIFTI

vijon nga faqja 13

Për përdorimin e pemëve (frutave të freskëta ose të thara) në ushqimin e popullsisë fshatare, kemi disa dëshmi që nga shekulli XVII. Në një relacion për Zadrime, një autor shqiptar i këtij shekulli, Frang Bardhi, më 1638, thotë se atje përdorshin rëndom: fiq, dardha, kumbulla, shegë, si edhe pjepra e shalqinj, kurse për rrethin e Pukës ai thotë se përdorin shumë: arrat, gështenjat e sidomos boronicat. Edhe pothuaj dy shekuj më parë, sipas regjistrat osman të vitit 1485, në Malësi të Shkodrës përdorshin si pemë: gështenja, arra, kumbulla, qersh, mollë e dardha, për të cilat merrej nga qeveria edhe tatimi përkatës.

Gështenjat rriteshin dhe konsumoheshin shumë në disa rrethe, si: Tropoja, Kukësi e Puka, ku deri vonë ka patur pyje të tërë gështenjash. Në Mirditë përdorej për të ngrënë një qull i posaçëm arrash të shtypura. Skrapari përmendej për rehaninë dhe pekmez-in prej rrushi. Disa zona, si: Përmeti, Korça, Berati e ndonjë tjetër kanë qenë të përmendura për reçelrat me cilësi të lartë që i përgatisnin me fruta të stinës.

Ndër artikujt me prejardhje nga bota bimore duhet të përmendim edhe ullirin, qoftë për kokrrat e tij, qoftë për vajin që nxirrej prej tyre dhe që, deri nga mesi i këtij shekulli, përdorej si yndyra kryesore për të gatuar gjellët e ndryshme në zonat e ulta ku ai rritej.

Deri në Luftën e Parë Botërore, mjalti zinte një vend nderi në Shqipëri, megjithëse kishte kohë që gradualisht po hynte në përdorim sheqeri. Ka dëshmi dokumentare që tregojnë se në viset tona sheqeri tregtohej të paktën që në shekullin XVII: ai përmendet krahas mjaltit, në një listë ushqimesh të përgatitura për një gosti në Berat, në vitin 1689.

Pija më e zakonshme ishte uji. Vendi ynë ka sasira uji të mjaftueshme për nevojat e popullsisë, megjithatë ka zona me ujëra të shumta e zona mjaft të thata ku uji mungon edhe për nevojat e përditshme të familjeve fshatare, kështu që duhet transportuar nga distanca jo të vogla. Populli dallon ujë të pijshëm ose jo, ujë të lehtë ose të rëndë, ujëra që kanë shumë gëlqere e pas një përdorimi të gjatë të prishin dhembët (si ishte uji i Shkodrës), ujëra të cilëve u vishen veti afrodiziake etj.

Tjetër pije e përdorur gjerësisht në vendin tonë që nga koha antike e sidomos me përhapjen e krishterimit, ishte pa dyshim vera, e cila ka lidhje me përhapjen e pjergullave e të vreshtave, sidomos në Mesjetë. Duke gjykuar sipas numrit të vreshtave të shënuara në regjistrat osmanë dhe të fuçive ose

tjera, duke përdorur një teknologji artizanale për distilimin e tyre. Kishte pastaj një varg lëngjesh të tjera, përdorimi i të cilave kufizohej në një zonë apo krahinë të caktuar, lidhur me prodhimet dhe traditat lokale. Mund të përmendim, bie fjala, bozën, një pije e lehtë dhe freskuese, kryesisht e Shqipërisë së Mesme, ardallin e Shqipërisë Verilindore (Dibër, Tetovë), që ishte një lëng i nxjerrë nga mollët e egra dhe i fermentuar lehtë, rehaninë e Skraparit, lëng rrushi të zier me shije pak të thartë, apo lëngje të aromatizuara, për shembull me petale trëndafili etj.

Ndër pijet e importuara që janë bërë mjaft popullore, duhet të përmendim kafënë, çajin dhe që nga viti '30, birrën.

Në shekujt XVI-XVIII, sikurse dëshmohej në disa dokumente, shqiptarët, kur uleshin për të ngrënë,

mente të shumëllojshme të kohës përmenden rëndom sahanë, tasa, tenxhere, fultere, gjyma e jamake, pastaj tava e tepsi të madhësive të ndryshme, si edhe sini "të shkrura". Më pas, e sidomos gjatë shekullit XX, ky repertori i enëve ndryshoi shumë në sasi e në cilësi, me hyrjen në përdorim të pjatave prej gresi, të enëve prej xingoje e alumini, me shtimin e enëve prej qelqi e më tej të enëve prej lëndësh plastike, të tenxhereve prej metali të paoksidueshëm etj.

Ushqimi i përditshëm nuk ishte si ai që përgatitej për raste festash të mëdha ose për mysafirë të lartë. Kështu, për shembull, në disa zona të varfra të vendit, në periudhën e kreshmëve, fshatarët hanin bukë thekre ose sorgu të shoqëruar me perime pa vaj, domethënë me qepë ose me hudhra, kurse në raste gostish hanin shumë më mirë.

Relatori M. Bici tregon se gjatë një vizite të tij në Blinisht, më 1610, kur u shtruan për të ngrënë, "sofra ishte plot me shpendë e me mish". Kurse Fra Cherubini, më 1638, tregon se në Zadrime fshatarët i kremtonin festat e tyre me shpenzime të mëdha dhe shumë herë, me teprime të mëdha, duke bërë gosti me miqtë, veçanërisht me ata që ishin martuar rishmë. Edhe në dasma bënin shpenzime të shumta dhe pastaj, në ditët që pasonin, hiqnin keq. Pjesëmarrja në festat e gostitë ishte shumë e gjerë, por edhe të ngrënë me

shumicë, sidomos kur kremtonin shenjtin e kishës së tyre famullitare. F. Bardhi, më 1637, shkruan: "(në rrethin e Pukës) Festat e veta i kremtojnë me dëm të madh, sepse e kanë zakon që, së paku tre dit, t'u nxjerrin për të ngrënë e për të pirë deri në grykësi gjithë miqësisë së tyre, që u shkojnë për festë dhe mund të gjendet ndonjë shtëpi ndër ta ku shkojnë më shumë se 200 vetë. Kanë një zakon shumë të keq, rrijnë shumë gjatë në tryezë, duke filluar nga dreka, që e nisin para mesdite, e gjatë gjithë ditës e gjithë natës, deri në agim, hanë e

shtronin përpara një mësallë të trashë prej pëlhere liri, mbi të cilën vendosnin ushqime por, në të shumtat e rasteve, përdornin sofrat e ulta prej druri. Kishte zona të thella e të varfra, që përdornin më fort tasa druri, lugë druri, enë uji gjithashtu prej druri dhe më pak enë bakri. Kurse në shumë zona të tjera që ishin më të zhvilluara, krahas enëve prej qeramike, të glazuara ose jo, si: shtamba, bardhakë, vorbe, qypa e poçe, misurë e tasa qeramike, përdorim të gjerë kishin edhe enët prej bakri, por të kallajisura, dhe sahanë prej tunxhi. Kështu, në doku-

enëve të tjera për mbajtjen e verës, që përmenden nëpër inventarë e testamente të ndryshme, mund të thuhet se fshatarët konsumonin sasi të konsiderueshme vere e mushti. Por dihet se, me përhapjen e fesë myslimane, konsumi i tyre erdhi duke u pakësuar. Në shekullin XVII fillojnë të duken shenjta e para të përdorimit të rakisë, të cilën F. Bardhi, më 1637 e quan "verë e mirë, e bardhë si uji, por shumë e fortë". Në shekujt që pasuan, kjo pije alkoolike u përhap shumë dhe filloi të përgatitej jo vetëm prej rrushi, por edhe nga mani, nga kumbullat e nga fruta të



Tava e kosit e Elbasanit



Grua me dybek që nxjerr gjalpin nga qumështi - Pikturë nga Fatmir Haxhiu

pinë..." Sidoqoftë, dihet se teprimet në të ngrënë ishin të zakonshme, në këtë kohë edhe në popuj të tjerë të Evropës.

Gosti të mëdha e me shumë shpenzime bëheshin edhe në raste vdekjesh. Për këtë Fra Cherubini, më 1638, thotë: "Kur ka vdekje, bëjnë një drekë, në të cilën ftojnë gjithë katundin. Ndër male e ftojnë gjithë katundin edhe tri herë të tjera brenda vitit. Edhe në qoftë i vobektë ai që vdes e ta ketë lënë familjen e vet të varfër, e sikur asgjë tjetër të mos ketë veç pendën e qeve, duan të bëhet dreka dhe i hanë çdo gjë. Kështu, asaj shtëpie që e bën, i duhet pastaj të lypë ose të vjedhë". Zakone të ngjashme për kësi rastesh ka pasur edhe në zona të tjera të



► Lakrori me dy pete e qepe te njoma i Korçës

njerëzit uleshin për të ngrënë rreth një softe të rrumbullakët. Sofrat më të mëdha ishin ato ku mund të rrinin përqark 10-12 persona. Burrat uleshin këmbëkryq, kurse gratë në stola ose në gjunjë. Në shumë zona nuk përdorshin piceta të veçanta duarsh për çdo person, por një picetë e gjatë, që mund t'u shërbente të gjithëve e që kalonte rreth e qark sofrës, e hapur mbi gjunjët e atyre që ishin ulur për të ngrënë. Megjithatë, kishte edhe zona ku në kostumin popullor të burrave fshatarë bënte pjesë një peshqir i pambuktë, rreth 50x50 cm, që mbahej i fiksuar te brezi dhe shërbente zakonisht për të fshirë duart. Por ka dokumente të tjera që tregojnë se në qytete niveli i kulturës së të ngrënit ishte mjaft i ngritur. Mund të përmendim këtu një vendim të viti 1769, të marrë nga komuniteti i krishterë i qytetit të Gjirokastrës, ku thuhej se, ata që shkonin në gosti martesash, duhet të merrnin secili me vete "thikën, pirunin e vet, si edhe picetën e vet".

K i s h t e gjellë që serveshin në sofër ashtu si ishin përgatitur, në tepsi ose në tavë; të tjera që zbrazeshin në sahan bakri ose në misurë qeramike të glazuar, ose edhe në enë druri. Në fshat përdorshin zakonisht vetëm lugët dhe vetëm në shekullin tonë në fshatrat më të zhvilluar filluan të hyjnë në përdorim lugë dhe piruj metalikë, që importoheshin nga Kina dhe Japonia.

Gjatë rrjedhjes së shekujve, marrja e ushqimit ka ardhur duke u përmirësuar e stërholluar, jo vetëm në zgjedhjen e lëndëve ushqimore dhe të mënyrës së gatimit të tyre, por edhe në mënyrën e servirjes në tryezë, duke e kthyer kohën e të

ngrënit nga plotësim të nevojave të organizmit në një interval kohe që mund të kalojë në mënyrë të këndshme, me biseda të ditës e shkëmbime mendimesh, qoftë edhe thjesht me vlerësime për atë që po hahet.

Ushqimi tradicional për të cilën folëm më sipër nuk pasqyron veçse një sferë të kufizuar të ushqimit në vendin tonë. Gjatë shekullit XX, e sidomos në gjysmën e dytë të tij, repertori i artikujve ushqimorë, që kanë hyrë tashmë në ushqimin që konsumohet në familje e aq më shumë në ushqimin social, është zgjeruar shumë, ashtu si janë shtuar e përmirësuar shumë veglat e punës në kuzhinë, mjetet e konservimit e të ftohjes. Vihet re edhe prirja për

ushqimi është varur tërësisht nga mjedisi përreth tyre. Kështu, çdo krahinë kishte krijuar mënyrë e saj ditore apo atë festive, e cila përcaktonte dhe standardin e jetesës. Nga njëra periudhë në tjetrën edhe ushqimi si pjesë e mënyrës së jetesës, pësoi ndikime kulturash të tjera, veçanërisht kjo dukuri u ndje në ushqimet e gatuar për raste ceremoniale të rëndësishme familjare.

Në fshatrat e Alpeve të Shqipërisë Veriore, ushqimet bazë ishin: bulmeti, barishtet e egra e ato të kultivuara, mishi i derrit, frutat e egra e ato të kultivuara. Në krahinat e Shqipërisë Verilindore dhe asaj Juglindore, përveç bulmetit, pjesë e rëndësishme e ushqimit të përditshëm ishin fasulet, lakrat,

preshi, barishtet e ndryshme dhe mishi i bagëtive të imta.

Ndërsa në fshatrat e Shqipërisë Jugperëndimore, vend me rëndësi në ushqimin e përditshëm, zinin ulliri dhe vaji i tij, perimet e ndryshme, agrumet dhe prodhimet e detit.

Ushqimi rregullat e të ngrënit njihen më mirë, sepse shumë artikuj ushqimorë shfaqen në mallrat tregtare të kohës. Krahas bukës e gatimeve të tjera me bazë mielli (si qulli, mëmëliga, përseshi, pitet, petullat,

etj.) në shekujt e mesjetës vinte përdorimi i bulmetit dhe i yndyrave.Në dokumentacionin e kohës, krahas djathit përmendet në eksportet edhe qumështi. Në gjelëtarinë e kohës është i pranishëm shpesh vaji i ullirit e kokrrat e tij, artikuj ushqimorë tipikë mesjetarë por që njiheshin që në antikitet. Mullinj vaji kishte tashmë jo vetëm pranë banesave të zotërve feudalë, por edhe pranë manastireve që kishin ullishte. Tava e Elbasanit bën pjesë në kuzhinën e pasur shqiptare. Ajo bëhet me kofshët e qengjit të marinuar në kos....

vendit. Madje, disa prej tyre, deri në njëfarë mase, mbetën gjallë edhe në shekujt që pasuan.

Në fshat, deri aty nga mesi i shekullit tonë, mëngjesi hahej përgjithësisht herët, para se të fillohej puna, dhe ishte disi i lehtë, shumë herë një përsesh me qumësht të ngrohtë ose trahana, po të ishte dimër. Gjatë stinës së verës, kur pjesëtarët e rritur të familjes punonin në ara, për të prashitur ose për të korrur, një grua nga shtëpia ua çonte sillën në fushë, në vendin e punës. Në këtë periudhë përgatiteshin për drekë lloje të ndryshëm lakrorësh me barishte të stinës, që bëheshin në tepsi dhe piqeshin me saç. Ata mund të shoqëroheshin me dhallë ose kos, ndonjë kokërr qepe etj. Në

dimër, për drekë bëheshin gjellë të ndryshme të ziera në tenxhere, duke përdorur perimet më të zakonshme, si: fasule, qepë, presh, lakra, thjërza, bizele dhe qiçra të thata, spinaq, lëpjeta e hithra, specia, kunguj, patate dhe për aq sa kishin mundësi, edhe mish.

Pjesëtarët e familjes mblidheshin për të ngrënë së bashku më fort në darkë sesa në drekë. Ata që shkonin për të kullotur bagëtinë, merrnin ushqim me vete në trastat e tyre të bukës, në kupacët e tyre prej druri, ndërsa gjellë të ngrohtë mund të hanin vetëm në darkë, kur ktheheshin në shtëpi.

Kishte zona (si Bregdeti i Himarës etj) ku fshatarët hanin në tryezë, po në pjesën dërrmuese të fshatrave



► Pispili me qepë te njoma dhe miell misri

një ndërkombëtarizim të ushqimit, me shtrirjen e gjerë të prodhimeve të gatshme ose gjysmë të gatshme, që qarkullojnë ngado (hamburger, cisburger et) dhe kjo sjell një uniformizim të tejkajshëm të ushqimit, që mënjanon nga përdorimi gatesat lokale. Në këto rrethana, del e nevojshme që gjurmimet e studimit në këtë fushë të shpejtohen.

USHQIMET

Çdo popull ka gjetur në mjedisin e tij gjeografik ushqimin për të mbijetuar. Edhe shqiptarët kanë krijuar traditën e të ushqyerit me ato asortimente që klima dhe bimësia vendase u ka ofruar. Në fshatra

TRADITA | KULINARIA

1637, shënimet e F. Bardhit për ushqyerjen e shqiptarëve

vijon nga faqja 14

Festat e veta i kremtojnë me dëm të madh. Edhe për vdekjet ftojnë për të ngrënë gjithë fshatin mbi 200 vetë dhe mbeten të varfër

...Kjo tavë u bë e famshme në Perandorinë Osmane për shkak se atë e pëlqeu Mehmeti II, i cili e provoi gjatë fushatës për marrjen e Krujës më 1452, aty ku dha urdhër të ndërtohet një qytet mbi rrënojat e një qyteti të vjetër me qëllim mbajtjen në presion të Krujës. Mishi konsumohej më shumë në dimër se në verë. Në qytet ai konsumohej veçanërisht në tryezat e fisnikëve e të kështjellarëve të kohës. Baza ishte mishi i pjekur, për të ftuarit më të nderuar edhe mish shpendësh e zogjsh gjahu. Përdorej shumë edhe vera. Në kushtet e kohës mishi ose konsumohej pas therjes ose ruhej i kripur shumë, prandaj para gatimit duhej lënë në ujë që t'i dilte kripa. Edhe peshku konsumohej mjaft sidomos në qytetet e bregdetit, i freskët ose i tharë. Në dokumente të kohës përmenden ngjallat, krapit e putargat e Shkodrës por dëshmon edhe ekzistenca e dajlaneve, përveç mënyrave të tjera të peshkimit. Pak a shumë këto ishin ushqimet që konsumoheshin edhe në tavarnat e qyteteve kryesore, si Durrësi, Vlora, Shkodra. Llojet më të përdorura të perimeve ishin qepët, preshtë, hudhurat, specat djegës, të freskëta dhe të regjura (turshi). Gjithashtu gjerësisht përdorshin fruta të freskëta, të thata dhe shurube, si kumbullat, mollët, dardhat, qershitë, fiqtë etj. Në gjellët e ndryshme të kësaj kohe përdorej shumë edhe uthulla, për të shtuar shijen, gjë që vazhdon edhe në shekujt e mëvonshëm. Mjalti ishte gjithashtu një artikull i përdorur gjerësisht. Ndonëse asnjë prej qyteteve shqiptare nuk u shkëput krejtësisht nga prodhimi bujqësor, baza ekonomike e tyre ne shek. XVI ishte në radhë të parë zejtaria. Zejtaritë që morën hov të shpejtë ishin ato që lidheshin më tepër me përpunimin e produkteve bujqësore-blegtores, siç ishin regjia e lëkurëve dhe përpunimi i leshit. Krahas tyre u rritën edhe zejtaritë e tjera, prodhimi i të cilave plotësonte nevojat e fshatarëve, qytetarëve dhe të ushtarëve. Por mbizotërimi i ekonomisë natyrore në fshat nuk lejoi zhvillimin e gjerë të këtyre zejtarive. Gjatë shek. XVII, fshatarët,

zejtarët dhe bujqit shtuan numrin e banorëve të qyteteve.

BUKA

Buka është respektuar si gjë e shenjtë, para saj bëheshin lutje e betime. Pasha bukën, Për këtë bukë un po them të vërtetën, apo Më vraftë buka. Për pjesën më të madhe të vendit, artikulli kryesor ishte buka prej gruri, sidomos në zonat ku toka punohej mirë, siç ishte rrethi i Tiranës, por edhe pllajet e kultivuara me grurë, thekër, mel etj. Drithi,

hahej edhe meli, megjithëse prej tij dilte një bukë shumë e qullët. Në disa dokumente, krahas artikujve të tjerë për eksport, përmendet edhe buka. Këtu është fjala për bukë të thekur (peksimadhe), artikull shumë i nevojshëm për detarët sa kohë ishin në lundrim, sepse i qëndronte më mirë lagështirës, dhe ky ishte një zakon i përhapur gjithandej në brigjet e Mesdheut.

Drithi bluhej në mullinj, që punonin tashmë me forcën e ujit, megjithatë mokrat prej guri vazhuan të bëjnë pjesë në orenditë

bluar trashë e i zier është padyshim një nga gatimet e hershme, që i paraprin bukës. Me kohë ai mbeti në përdorim jo si ushqim i përditshëm, por si ushqim ritual për të kremtet e motmotit e sidomos për rastet e përkujtimit të të vdekurve.

Deri në shekullin e XVII, buka bëhej prej thekre, prej gruri, me miell gështenjash, e më pas prej misri. Po aq shumë respektoheshin e kishin simbolikën e tyre edhe bukët ritual, të cilat ishin të pranishme në festa të ndryshme me rite pagane, por edhe në ato fetare. Ato shoqëronin ritualet për të sjellë mbarësi, shëndet, për fat e mbarësi në familje. Një ndër bukët ritual me simbolikë të veçantë, ishte ajo që gatuhej herët në mëngjes ditën e parë të mbjelljes së drithërave. Kur fillonte brazda e parë, buka apo kulaçi i gatuar thyhej mbi këtë pjesë, mbi brirët e njërit ka. Dy pjesë ua jepnin qeve për ti ngrënë e një pjesë të saj e hante bujku i parmendës, pjesën e katërt e hidhnin në brazdën e parë që hapte parmenda.

PUNIMI I ENËVE PREJ BALTE

Nëse në tryezat e fisnikëve të kohës mbizotëronin enët prej argjendi masiv, në forma disqesh e pjatancash të mëdha, si edhe

potirët me fron dhe kupat po ashtu prej argjendi, në tryezat e shtresave të mesme qytetare përdorshin gjerësisht tasat, pjatat dhe pjatancat prej qeramike, të glazuruara me kujdes e hijeshi si brenda, ashtu edhe jashtë, format e të cilave shihen në gjetjet arkeologjike të mesjetës së hershme.

Në mënyrën e jetesës zinin vend edhe ngrohja e ndriçimi. Lënda djegëse në këta shekuj duket se ishin shkarpat e drutë. Është përdorur edhe qymyri i drurit, i cili njihet që në lashtësi, por në një masë shumë më të kufizuar. Lënda djegëse sigurohej që gjatë verës dhe vendosej në stiva pranë banesës. Drutë digjeshin në vatër dhe për të lehtësuar djegjen mbështeteshin te një almise e thjeshtë prej hekuri, që quhej "kali i druve". Rreth këtij zjarri i kalonte familja fshatare orët e gjata të mbrëmjeve gjatë dimrit.

Në banesat qytetare, sidomos në kështjellat e zotërve feudalë, kishte vatra e oxhakë të mëdhenj (ndoshta të ngjashëm me ato që shihen në kuzhinat e manastireve më të vjetra të vendit). Në banesat e vogla fshatare mjetet e ndriçimit ishin, copat e pishës, të vendosura mbi një pishtar të thjeshtë hekuri, pranë vatrës.

Sipas një tradite që vjen nga antikiteti, zonat ku rritej ulliri përdorin për ndriçim kandilat me vaj. Ndiriçimi me këto kandila me vaj është ruajtur deri në shek. XX në kishat ortodokse të vendit. Kandilat me vaj, në format e tyre kryesore, bëheshin krejtësisht prej argjendi dhe të mbuluara me gdhendje artistike, që u jepnin një shkëlqim të veçantë mjediseve që ndriçonin. Këta kandilë të kushtueshëm janë pjesë e artit dhe e kulturës bizantine të këtyre shekujve dhe janë përdorur gjithandej në viset e Bizantit.

Përdorim të gjerë kishin edhe qirinjtë prej dylli, me trashësi të ndryshme, që vendoseshin në shandanë argjendi, me dy, tri ose me më shumë lambadha, që vendoseshin mbi tryezat a në vende të tjera të ngritura, për të ndriçuar më mirë. Në shekullin e XIX, në një varg fshatrash e qytetesh të Shqipërisë, ushtrohej mjeshhtëria e punimit të enëve prej balte. Në pjesën veriore të saj, për punime të këtij lloji njiheshin fshati Gojan në rrethin e Pukës dhe fshatrat Luf e Gërman në rrethin e Matit. Në Shqipërinë e Mesme njiheshin fshati Farkë në rrethin e Tiranës dhe qyteti i Kavajës. Të tjera qendra të përmendura për punime në baltë ishin dhe fshatrat Bradavicë, Vërren e Grapsh në rrethin e Korçës.



► Ene Balte



► Kupe floriri



► Enë argjendi e floriri, pjesë e koleksionit të Thesarit të Vrapit

si artikull i rëndësishëm eksporti, duket se i plotësonte mirë kërkesat e kultivuesve, por padyshim, kishte edhe zona në luginat e thella ku nuk mjaftonte gruri dhe kështu

shtëpiake, duke bluar në to edhe grurin për trahan etj. Të tjera orendi për të grimtuar ose shtypur sende ushqimore ishin shtypësat e ndryshëm prej druri ose prej guri. Gruri i

INTELEKTUALJA | LËVIZJA

Identite të lëvizshmeRasti i Elena Gjikes
në Lëvizjen
Kombëtare Shqiptare**Dhimitër Kamarda: "Vepra e Dora D'Istrias është një unazë qytetërimi ndërmjet Lindjes dhe Perëndimit"**

NGA DR. DORIAN KOÇI

Identitetet janë të lëvizshme. Në rrethana dhe situata ku një kulturë predonimon në formimin e një popullate, atëherë dhe përfaqësi i identitetit etnik të kulturës që është përfaqësuese, është më i lehtë për njerzit dhe përfaqësues të shquar të komunitetit. Përfaqësjet moderne përsa i përket identiteve etnike dhe kulturore e quajnë si diçka të natyrshme braktisjen dhe përfaqësimin e një identiteti tjetër, gjë që ka ndodhur rëndom sidomos në popullatat emigrante që kanë populluar Europën pas Luftës së Dytë Botërore. Sigurisht që kjo përfaqësi identitare ka hasur në kritika të shumta dhe nuk është një realitet lehtësisht i pranueshëm sidomos në vendet ku etnocentrizmi dhe nacionalizmi kanë predominuar kulturën dhe jetën publike të vendit. E gjithë kjo përzgjedhje identitetesh në fakt nuk është diçka e re. Në Europën e mesit të shekullit të XIX pa triumfuar ende nacionalizmi si ideologji shtetformuese në Perandoritë e Mëdha të Juglindjes së Europës si ajo e Shenjtë Austriake dhe më 1867 Austro-Hungareze, Osmane dhe Ruse popullatat që jetonin pranë njëra-tjetërsh e identifikonin veten shumë shpesh me identitetin e kultures që përfaqësonin duke mos reflektuar gjithmone origjinën etnike. Raste të tilla mund të përmenden shumë në Ballkan, si p.sh rasti i mësuesit të gjuhës greke Grigor Stavrev Parlichev, bullgar për nga kombësia që shkruajti një poemë për Skënderbeun në gjuhën greke duke banuar në Tiranë në mes të shekullit të XIX.

Është e kuptueshme sesi kanë përmendur dhe studiues të tjerë se nuk egzistonin kufij shumë të qartë të identitetit sidomos nëse marrim për të mirëqenë përkufizimin e Gellsherit për hierarkinë midis kulturave. Në Ballkan janë shumë të radhë rastet kur një anëtar i elitës kozmopolit përfaqon kulturën ende të pazhvilluar të një etnie tjetër. Një shembull tipik dhe interesant në këtë drejtim është figura e Elena Gjikes apo e Dora D'Istrias, e lindur në Bukuresht më 22 janar 1828, kozmopolite në formimin e saj kulturor duke njohur shumë mirë kulturën franceze, italiane dhe greke. Mësimet

e para i mori në Konstancë e më pas në Bukuresht, kurse studimet e larta i filloi në Vjenë e pastaj i vazhdoi në Dresden e në Berlin. Në shkurt të vitit 1849, Elena u kthye në Bukuresht. Ajo ishte pajisur me një kulturë të gjerë; njihje mirë frëngjishten, italishten, gjermanishten anglishten, rusishten, greqishten shqipen (për këtë të fundit ka një debat të hapur) e sidomos rumanishten, gjuhën e saj të nënës nëpërmjet të cilave zgjeroi horizontin e diturisë dhe dha mendime me vlerë në shumë studime e vepra letrare. E pajisur me këtë kulturë të gjerë, ajo debuton për herë të parë në 1855 në frëngjisht *La vie monastique dans l'Église orientale*. Nga veprat e saj mund të përmendim: "La nationalite Albanaise d'après les Chants populaires-Les Albanais des deux Cotes de l'Adriatique" (1866) "Kombësia shqiptare, sipas këngëve popullore, Shqiptarët e dy brigjeve të Adriatikut", "Les ecrivains Albanais de d'Italia meridionale" (1867) "Shkrimtarët shqiptarë të Italisë së Jugut", "Excuisses albanaises" (1869) "Vizatime shqiptare", "Gli Albanesi in Romania" (1873) "Shqiptarët në Rumani" etj. Ajo ka bashkëpunuar me organe të rëndësishme të kohës si: "Revue de Deux-Mondes", "Independence hellenique", "Nuova Antologia" etj. 11 vjet pas debutimit të saj të parë me botimin e një vere që pati një jehonë në mendimin intelektual të kohës, në 1865, Dora D'Istria filloi të përfshihet në korrespondencë me eksponentë të rëndësishëm të zgjimit kulturor të shqiptarëve. Ky implikim dhe përfshirje e saj në Lëvizjen Kombëtare Shqiptare është parë gjithnjë me dyshim nga studiues të ndryshëm duke ia faturuar më tepër një egzotimi romantik të saj sesa një angazhimi e mobilizimi të vërtetë identitar. Po kështu për të përforcuar këtë argument nënvizohet fakti se Dora D'Istria se me të njëjtën simpati që shkruajti për shqiptarët, shkruajti dhe për kombësitë e tjera në Ballkan, si grekë, serbë e bullgarë. Nuk ka dyshim se vepra e Dora D'Istrias është një dokument i mirë për t'iu referuar dhe sigurisht përmes saj mund të nxirren dhe përfundime për identitetin e demonstruar kombëtar dhe kulturor, por një pjesë shumë e rëndësishme besoj është dhe letërkëmbimi i saj privat me patriotë dhe figura të shquara të

shqiptarizmit si Dhimitër Kamarda, Jeronim De Rada, Zef Jubani, Thimi Mitko etj. që ruhet në Arkivin e Qendrës dhe nga ku mund të hidhet shumë më tepër dritë. Në mars të vitit 1865, kur gjendej në Livorno, Elena Gjika u njoh me Dhimitër Kamardën, folkloristin dhe gjuhëtarin arbëresh nga Hora e Sicilisë. Nga Livorno Elena Gjika ka shkëmbyer letra të shumta me Thimi Mitkon, Zef Jubanin, Dhimitër Kamardën, Jeronim de Radën etj.

Në këto letra për herë të parë në mendimin shqiptar hidhet dritë mbi origjinën etnike të Princërve Gjika, si dhe përfshirja e tyre në krenarinë kombëtare që duhet të kenë shqiptarët duke përfshirë edhe figura të tjera të shquara si Mehmet Ali Pasha i Egjiptit dhe vezirët Qyprillinj. Kjo simbiozë identitare fetare e këtyre personazheve në letrat e Dora D'Istrias drejtuar Jeronim De Radës, shkrihet në një simbiozë identitare kombëtare shqiptare dhe si e tillë, Dora D'Istria është pararendëse e një mendimi që u maturua gradualisht në Lëvizjen Kombëtare Shqiptare dhe që u bë një realitet i prekshëm përmes një shekulli pavarësi. Në letra të tjera ajo shprehet pas lajmeve që ka marrë nga Shqipëria se shpresoj se ne do të jetojmë deri në atë ditë kur mbi kullat e Rozafës do valëvitet përsëri flamuri i Skënderbeut. apo në botimin e veprës së saj voluminoze "Shqiptarët në Rumani" do të deklarojë origjinën shqiptare të familjes së vet.

Dora D'Istria në këtë letërkëmbim reflekton teorinë historisë parahistorike të kohës ku shqiptarët, grekët dhe italianët i shikon si një bllok popullor që duhet të kundërshtojnë hegjemoninë sllave dhe gjermane në Europë. Në këtë mënyrë ajo reflekton shqetsimin gjeostrategjik të kohës, prej nga shpesh herë është keqkuptuar dhe përkatësia identitare e saj. Në letrën dërguar nga Firenze më 14 dhjetor 1876 ajo shkruan se ajo që mbetet më e çuditshme ndër të tjerët për paraardhësit tanë, është fakti që në një kohë kur gjermanët dhe sllavët bashkohen midis tyre në lidhje të ngushta, bijtë e racës pellazge kanë mbetur krejt të huaj njëri me tjetrin. Teoria e historisë parahistorike ishte një përpjekje për të penguar pansllavizmin dhe pangjermanizmin dhe në mesin e



Dora D'Istria

shekullit të XIX, dhe sipas saj konsiderohej si një shkencë që porsa ka lindur në ditët tona dhe si të gjithë shkencat e tjera, ajo ka themele shumë të shëndosha në filologjinë dhe në mitologjinë e krahasuar, në shqyrtimin e karaktereve morale dhe fizike, në arkeologjinë primitive, në traditat kombëtare etj. Në këtë drejtim duhet parë dhe angazhimi i saj sëbashku me Gjeneral Garibaldin për të dërguar 15- 20.000 pushkë në 1866 në Shqipëri për të filluar një kryengritje kundër osmanëve por që do të shqetsonte dhe pozitën austriake në Ballkan. Viti 1866 është një vit shumë i rëndësishëm për bashkimin e Italisë dhe përfitimin e krahinës së Venecias, pas humbjes së Austrisë në luftën me Prusinë. Mesa duket një diversion i nisur nga Garibaldi në viset e Shqipërisë përveçse një pasion romantik për të siguruar lirinë do të dobësonte dhe pozitën austriake që kishin interesa madhore në këto vise.

Dora D'Istria tek origjina e saj e largët kërkoi strehë në formën e një identiteti kulturor panpallazgjik, por në përfshirjen e saj në Lëvizjen Kombëtare shqiptare dashur pa dashur krijoi një stereotip të admirueshëm të përfshirjes së elitave kozmopolite europiane në çështjet kombëtare të popujve të vegjël. Më tepër sesa një aktiviste e mirëfilltë e nacionalizmit, Dora D'Istria me devizën e saj dedikuar shqiptarëve se "pa rilindje letrare nuk ka ringjallje politike", duhet konsideruar si një prototip i intelektualës europiane dhe aktivistes kulturore që mbështet kauzat e drejta të popujve të vegjël. Si të tillë e pranoi dhe

elita arbëreshe-shqiptare e kohës. Dhimitër Kamarda, hartuesi i një antologjie në vargje për Dora D'Istria do të shkruante për të: "Një emër i tillë veçanërisht është i vyer për të zbuluar këtë hyrje, sepse është mbushur me nderin e racës shqiptare si nga origjina e familjes së saj, si nga lavdia, që t'i përkasë sërës të shkrimtarëve më të gjallë të Evropës, si dhe të diturve dhe bukurisë, që ka mundur të bashkojë kulti plot fryte të shkencës dhe të letërsisë, ndërkaq nuk lë rast të ndihmojë me shkrime dhe vepra kombin shqiptar që nuk ia harron përjetë". Dhimitër Kamarda në librin e tij "Fyletia arbërore", që u botua në Livorno në vitin 1867, paraqet tiparet e kësaj gruaje të ditur, duke përshkruar portretin e saj, të punuar me mjeshtëri nga piktori italian Felice Schiavoni (1803 – 1881). Librat e saj, letërkëmbimet apo dhe rekomandimet kulturore letrare siç ishte ai drejtuar poetit amerikan Longfellow për të shkruajtur një poemë për Skënderbeun krijuan habitatin e vërtetë paneuropian ku u frymëzua dhe Lëvizja Kombëtare Shqiptare.

BIBLIOGRAFI:

- 1- Ahmet Kondo. Dora D'Istria për çështjet kombëtare shqiptare. Tiranë: Flish, 2002
- 2- Grigor Parlichev. Skënderbeu. Parathënie nga Spiro Çomora.
- 3- Nasho Jorgaqi, Antologji e mendimit estetik shqiptar 1504-1944, Tiranë 1979
- 4- V. Bala, Jeta e Elena Gjikes "Dora d'Istrias", Tiranë 1967

LIBRI RECENSA

NGA VLASH PRENDI

Treva e Mirditës ka qenë dhe është një nga trevat më të njohura në Shqipëri dhe më gjërë ku kanë lindur dhe rritur figura të shquara të kombit tonë, kontributi i të cilëve ka patur dhe ka peshë kombëtare si në lëvizjet patriotike, atdhetare, letrare, artistike dhe krijuese. Vite të shkuara, po kërkoja një vepër të një poeti mirditor dhe si për çudi më ra në dorë "Këndo Mirdita ime" e poetit Pal Përlala. Vargje të bukura, plot ndjenjë dhe mendim artistik, ndoshta ndërmarrja e parë në poezi. Sot nuk është e vështirë të gjesh qindra poetë nga kjo trevë, madje poetë elitare që zënë vend me dinjitet në letërsinë kombëtare, një prej të cilëve është edhe poeti i mirënjohur Viktor Gjikalaj.

Me Viktorin më ka njohur miku ynë i përbashkët shkrimtari Ndue Dedaj këtu e 25 vite më parë. Kisha dëgjuar për krijimtarinë e tij, pasi aso kohe merresha me krijimtarin dhe mbledhje folklorike, por dëshiroja ta njihja më shumë, pasi ansamblin "Mirdita", një nga më të njohurit në vendin tonë në fushën e folklorit e "ushqenin" me tekste poetikë Gjokë Beci dhe Viktor Gjikalaj. Kur u takova me të vetvetiu më vinin në mendje tituj këngësh shkruar nga dora e tij, madje kujtoja edhe vargje nga këngët e tij. Në fakt, njerëz të tillë ishin gjëni në fushën ku krijonin. Respektoheshin dhe nderoheshin të paktën nga ana morale nga shoqëria. Edhe mua, në takimin e parë me la pershtypjen e një gjeniu të vërtetë në fushën e krijimtarisë poetike dhe nuk isha gabuar. Poeti Viktor Gjikalaj vinte nga fshati Selitë i Kurbneshit, rajon malor i Mirditës, i njohur për minierat e famshme të nxjerrjes së kromit. Ishte familje e persekutuar, pasi shumë njerëz nga fisi i tij ishte burgosur, ekzekutuar dhe internuar. Ishte kjo arsyeja që poeti i ardhshëm nuk do të lejohej nga organet e pushtetit komunist as të shkruante dhe as të vazhdonte shkollën. Dhe kur shkruante ndonjë këngë për vendlindjen, atdheun, njeriun, punën etj, ishte i detyruar ta firmoste si autor anonim. Ndërsa shkollën, e kishte mjaft pasion dhe nuk e la pas dore. Ka mbaruar Universitetin "Luigj Gurakuqi", në qytetin e Shkodrës, fakultetin e Gjuhës dhe Letërsisë Shqipe.

I qetë, fjalëpakë, njerzorë, i matur dhe gjithmonë të buzëqeshur e takon rrugëve të qytetit të Lezhës. Pasi punoi vite të tëra në kooperativën bujqësore të Selitës malore dhe pak kohë minierën e bakrit në Kurbnesh, madje atje thellë në galeri, sepse të persekutuarit "atje e kishin vendin", sipas porosive të partisë, Viktori atë pak kohë të lirë që kishte kërkonte motive për këngët e tij të bukura që sot janë kthyer në hite. Edhe sot, jo pa emocion, ai tregon për vështirësitë e mëdha në jetë, për gjendjen e mjeruar të familjes, për vëshirësitë e medha dhe rreziqet e shumta në punë. Madje, pikërisht atje në frontin e punës, në mes bukurive të maleve të Kurbneshit,



▶ Viktor Gjikalaj

"Amaneti" i poetit Viktor Gjikalaj

Rreth librit "AMANET!" të poetit Viktor Gjikalaj, ku gërshetohet epikja, lirikja dhe heroikja e popullit heroik të Mirditës. Në tërësi vepra dëshmon për një pasurim të figuracionit poetik, fuqi të jashtëzakonshme të mendimit artistic, të fjalës poetike dhe të muzikalitetit të vargut...

ne gurgullimën e burimeve të Urakës, linden motivet dhe u rritën poezitë dhe këngët e tij. Këtu u strukturua dhe u botua vite më vonë edhe vepra e tij e parë "E kam shtëpinë e vogël" 1998, në të cilin poeti i njohur përmbodhi disa nga poezitë e tij të rinisë së hershme, duke sjellë para lexuesit motivet e vendlindjes, jetën e fshatit, atmosferën e punës dhe jetën e vështirë të minatorit apo edhe të ushtarit. Shtëpia e Viktorit në realitet ishte e

madhe, ashtu si sofra dhe zemra e tij bujare, po i vogël ishte respekti i organeve shtetërore të asaj kohe për njeriun, punëtorin, krijuesin. Puna në bujqësi dhe minierë e kaliti, e njohu me vështirësitë, e rrahu me jetën. Tani ai ka krijuar profilin e tij perfekt, si njeri, si poet, si krijues. Prandaj në fillimet e epokës demokratike zgjidhet për dy mandate Kryetar i Komunës së Kurbneshit, detyrë të cilën e kreu me përkushtim dhe korrektesë,

pa lënë menjëherë këngën dhe poezinë.


Me Viktor Gjikalajn më lidhin shumë faktorë si puna krijuese, jeta artistike, vlerat shoqërore dhe miqësia e hershme. Është nga ata njerëz të rrallë që e vlerësojnë shoqërinë dhe e njohin mirë atë. Ke dëshirë të kalosh pak kohë me të, të bisedosh, të mësosh prej tij. Atje në Lezhë, punoi në administratën e Qarkut, në sektorin e Marrëdhënieve me Publikun dhe

Median. Shpesh ka organizuar dhe ideuar mjaft aktivitete artistike duke pasqyruar punën e mirë të këtij institucioni në fushën e artit. Aktivitetet i moderonte vetë, sepse ishte njeri i artit, i letërsisë. Ka organizuar dhe moderuar dhjetra prezantime librash, ekspozita në pikturë, aktivitete artistike, etj. Madje me inisiativën e tij, u iniciua edhe cmimin vjetor "Gjergj Fishta" në krijimtarin letrare. Pikërisht në këtë ambient të vrullshëm artistik u ngjiz edhe libri i tij i dytë "Shira dhe Ylberë" 2010, me të cilin Viktori tashmë ishte afirmuar dhe kishte zënë vend nderi në letërsinë e shkruar. Per këtë liber të bukur, Viktori që nderuar me çmimik kombëtar – letrar "Serembe" në vitin 2012. Poezitë e tij të bukura ruajnë si margaritarë mallin dhe dashurinë për vendlindjen, Kurbneshin malorë, dikur qytet i minatorëve, sot vend i braktisur, por që poetit i zgjon kujtime të bukura dhe mbresëlënëse. Kjo poezi e trazon shpirtin e tij, por edhe e lumturon atë. Lexojmë poezitë "Kroi i bardhë", "Te suka e gjollëve", "Lumi mallë", "Ka 100 vjet", "Minatorëve të Kurbneshit", "Gryka e Selitës", "Është një mollë në Kurbnesh" etj. Përmes këtyre poezive kundërmon aroma dehëse e vendlindjes, bjeshkëve krenare të Mirditës ku poeti Viktor, u ngjiz si krijues. Poezitë e Viktor Gjikalaj mbartin peshën e viteve të mundimshme, jetën plot tallazet e poetit. Çdo varg, çdo tingull ka të pranishëm botën e pasur poetike, grishjen artistike, por dallohet edhe për formën moderne të të shprehurit poetik, për elegancën, ritmin dhe muzikalitetin emocional. Në poezitë e tij gjen të dashurën, nënën, djalin, bariun, minatorin, malësorin, por edhe kroin, kalin, lulen, lëndinat, lumin, zogjtë, përmes të cilave hyn thellë në qënien poetike duke dhënë sublimen, emocionalen apo drithëruesen përmes artit poetik. Poeti ngrihet madhështor, përmes dëshpërimesh, sepse ka karakter të fortë poetik, karakter malësori. E kapërcen ftohtësinë dhe kthehet në zjarr ngrohës kur shkruan poezinë lirike. Lirizmi i tij të riron, të jep krah, të jep jetë: "... Më dritëronin sytë kah binin Ylberë, / Ecja në shteg dimri me një këngë pranvere, / Une isha i njomë e ti krejt e re, / Shekulli i njezetë – Viti shtatëdhjetë e tre. Seç po vjen nga Lindja, fryn një erë e ftohtë, / Mbi qerpik më ngrin, lotin tim të ngrohtë...", ndërsa tek poezia "Dhorkë moj Dhorkë e vogël", poeti shprehet: "...Deti leshterikët sillte mbi tallaz, / Trok i hapit tënd, bregut më ndjek pas, / Ç'i hip atij kali ngarkuar me ëndrra, / Mos i thuj ushtarit, atë që t' thotë zemra. Unë zbres nga Mirdita, nga bjeshkët vij unë, / Kur shkrep syri i çikës, ndizet një furtunë. Eci për gjatë bregut, deti ka tallaz, / Ç'ke moj Dhorkë e bukur, përse më ndjek pas?!..." Siç shihet, fjalët e tij janë si mineralet e çmuara të nentokës së Mirditës të nxjerra nga galeritë e vështira të Kurbneshit dhe të vendosura në kurorën e maleve krenare, mishëruar në vargje përmes krahasimeve, metaforave, simboleve. Kështu, me këtë vëllim poetik Viktor Gjikalaj "betonoi" themelet e krijimtarisë së tij poetike për një liber të ri poetik edhe më të bukur, më të thellë dhe më me nivel artistik, të cilin lexuesi e ka tashmë në duar.

Para ca ditësh e takova në lulishten para Pallatit të Kulturës në Lezhë. Si gjithmonë i qeshur,

plot humor. Më zgjati librin e tij të tretë botuar kohët e fundit. Mbushur me vjersha, ndjesi të padiskutueshme shpirtërore dhe impresione nga jeta dhe natyra e bukur e vendlindjes. I këndonte poeti Mirditës, rolin të saj në historiografinë kombëtare, vajzës së bukur mirditore, maleve krenare të krahinës së tij, aktit burrorë të qindra minatorëve të Kurbneshit që për hir të së vërtetës hynin në galeri, por shpesh nuk dilnin, bukurive mahnitëse të trojeve shqiptare, heroizmit të popullit martir kosovar kundër shovinistëve serb etj. Një libër i kompletuar me nivel të lartë artistik dhe me vlera të veçanta njohëse me një titull mjaft domethënës "Amaneti", një term tradicional, që populli ynë, vecanërisht ai mirditorë e ka përdorur për të transmetuar traditat, zakonet, vlerat krahinore brez pas brezi. Këtë ka synuar edhe poeti dhe ia ka arritur qëllimit. Janë vargje të bukura, plot bukuri, emocion dhe vlera artistike. "Amaneti" për më tepër është edhe një vepër lapidare kushtuar të madhit Gjokë Beci, poetit të njohur mirditorë, me të cilin Viktor Gjokolajn e lidhin shumë kujtime dhe mbresa të pashlyeshme. Vëllimi poetik "Amaneti" është konceptuar si përmbledhje me këngë popullore, që autori ka shkruar ndër vite, interpretuar nga solistët më të shquar të ansambllit "Mirdita" dhe vënë në pentagram nga muzikantët më në zë të trevave të Veriut si Mark Gjoka – Mjeshtëri i Madh, Kolë Susaj, Servet Caraj, Kolë Zefi, Agim Velaj, kënduar nga solistët më në zë të këngës folklorike të trivet së njohur të Mirditës si Mark Gjoka – Mjeshtëri i Madh, Fran Vorfi, Nikollë Deda, Nikollë Preçi, Kastriot Kola, Gjin Dona, Tonë Gjoka, Prenë Beci, Gjela Duka dhe i mirënjohuri Arif Vladi. Është një punë padyshim e mundimshme, por që poetit i dha një emër që do të mbetet në kujtesë edhe pas shumë vitesh. pasi këngët e tij janë si ata lulet e bukura të vendlindjes së tij Selitës malore, mbledhur me kujdes nëpër lëndina. Përmes kësaj poezie tejet të bukur, pasqyrohen luftrat shekullore, rolin parësorë të burrave të shquar të Mirditës, përpjekjeve të popullit tonë për të ruajtur dhe transmetuar brez pas brezi gjuhën, zakonet, traditat. Kjo poezi ka sjellë deri në ditët e sotme, madje vazhdon të pasyrojë forma të larta artistike të gjenit krijuar duke sjellë para popullit kurdoherë melodi e ritme të papërsëritshme popullore si dhe vargje, ngjyra dhe motive të mahnitshme. Kështu poeti i madh Viktor Gjokolaj mbetet bard i këngës popullore, mjeshtëri i vargut, përvijues i qartësisë, thjeshtësisë dhe lakonizmit të rrallë të krijimit dhe mendimit popullor.

Poezitë e këtij vëllimi janë produkt i veprimtarisë njerëzore, pasqyrimi i fenomeneve të ndryshme shoqërore, që ndodhin në jetën e përditshme duke dhënë realitetin artistik shoqërorë. Autori, në shumë raste, sidomos para viteve 1990, detyrohej të shkruante dhe të firmoste krijimtarinë e tij artistike, si autor anonim. Për fat të mirë, shumica e këtyre krijimeve janë ruajtur në fondin e artë të muzikologjisë dhe arkivat e folklorit shqiptar. Këngët e "Shtegut të Bjeshtës", "Në këtë jetë s'ka moshë merak", "Brigjeve të Urakës", "Falmi Zot edhe dy sy", "Në një mal, dy kedhe vetëm" etj, u kthyen në hit për kohën.



Një numër i madh mbledhesh folklorike nga goja e popullit janë bërë pjesë e volumeve "Mbledhës të hershëm të Folklorit Shqiptar", nga Instituti i Kulturës Popullore, gjithnjë si autor anonim, por masa dhe specialistët e vargjeve popullore e identifikonin, sepse njihnin stilin e tij. Poezitë e Viktor Gjokolës, janë një tribunë e vërtetë e pasqyrimin të aspiratave dhe vlerave kombëtare të masave, pa mohuar rolin e rëndësishëm edukativ dhe frymën atdhetare. Kjo poezi është pasqyrim i gjallë i aktualitetit patriotik të ngjarjeve të ndodhura në periudha të ndryshme historike, janë kronikë poetike për dokumentimin e të dhënave historike. Mjafton të lexojmë këngën "Nga Stambolli vjen një letër", ku poeti thotë: "Nga Stambolli vjen një letër, / Pyet Prengë Biba kullin e vjetër, / -N'ato shkrep, n'ato grigja, / A ka lanë dimni filiza, / A vec delet rinë në mriza, / Edhe lahatat var në lisa? . . . Ka brof n'kamë Preng Marka Prenga, / -Sa t'na rrjedhë

gjaku ndër rrema, / Pushkë për shpi, shpi e flamurë, / Dheun e t'parëve se lshojmë kurrë... ose "Qesin pushkë djemt e Selitës", ku shkruan: "- C'janë kta krisma n'bjeshkë t'Mirditës, / Qesin pushkë djemt e Selitës, / Zjarm tek zemrat, flakë tek armët, / Mbë këtë tokë si lajmë nizamët. Mbi Valmor për pa u ngrit flaka, / Për pa u shtërrë gurrat e bjeshkës, / Nuk kalojnë urditë e nepses...", bie në se edhe kënga e bukur kushtuar Prengë Markolës bajraktarit të Oroshit, për të cilin poeti ngre vargje lapidare: "...Sa të jetë dita e sat ë jetë moti, / Se harron t'birin Oroshi, / Sa ti bjeri dielli tokës, / Do t'rrojë emir i Prengë Markolës". Të kësaj natyre tejet patriotike janë edhe këngët të tjera si "Nuk e ndrojt vllaun me mbretin", "Martirëve të Selitës", "Qielli i Arbnit plot me yje", "Gjokë Dodë Lleshi si rrem drite, etj, ku u skalitën në artin e këngës, për të mos u harruar kurrë figura patriotësh, luftëtarësh dhe grnjarje me vlera historike.

Një nga motivet më të spikatu-

ra në krijimtarinë e poetit Viktor Gjokolaj është edhe ai i dashurisë. Kush më mirë se mirditori ia ka kënduar kësaj ndjenjë të mrekullueshme njerëzore, që e ka shoqëruar shoqërinë njerëzore ndër shekuj. Janë vargje të thjeshta, plot bukuri artistike dhe emocionale sic është edhe vetë autori i këtyre këngëve plot pathos artistik dhe vlera njerëzore. Dashuria lind natyrshëm, përmes dhe aktivitetit shoqëror, pasi vajza dhe djali vlerësojnë tek njëri-tjetri virtytet më të qenësishme njerëzore. Tek kënga "Brigjeve të Urakës", autori pasqyron me thjeshtësi lindjen e dashurisë mes dy të rinjve malësorë. "Brigjeve të Urakës fryn veri i hollë, / Përmbi flakë të vajzës, ra një lulemollë. Zgjati dorën djali, lulen me ta hjekun, / Pa ty gushë-gastare, nuk jam gjallë as dekun. Mos e merr atë lule, se ma kan falë brigjet, / Merre zemrën time, se për ty po digjet". Në këtë poezi tepër kuptimplotë, simboli është lulja, ashtu sic janë vajzat e bukura mirditore. Më tej autori kërkon

të sakrifikojë artistikisht për këtë njerëzore sublime njerëzore, "Falmi Zot edhe dy sy, / E të cmallen tue t'pa ty, / At'rrem floku derdh mbi ballë, / Gris tek gjoksi këmishën e bardhë, / Buzët pjeshkë me tu shkri n'gojë, / Manej deka të vijë kur t'dojë...", madje kjo ndjenjë fisnikërie e ka shoqëruar mirditorin për momentin e dasmës mes të rinjve: "Ajo vjeshtë e bardhë, / Më shfaqet si andërr, / Ty të bani nuse, / Mua m'bani dhandërr, / Dita e bekuar, / Nuk harrohet kurrë, / Unë të bana grua, / Ti më bane burrë...", por përshkruan edhe mënyrën si lindi dashuria: "...Matanë bregut në një kodër, Cucat korin grunin, / Vrik e vrik njaj cucës vogël, / Djali ja lshon synin...", ku vlerat shpirtërore ndërthuren me ata njerëzore duke krijuar një model të përkryer shoqërore dhe njerëzore. Një vend të veçantë në vëllim zënë edhe këngët popullore humoristike të cilat poeti i përpunon dhe jep një nivel të lartë artistik dhe edukativ. Mbështeten këta këngë në realitetin jetësor, duke krijuar atmosferë gazmore dhe vlera emocionale krahas vlerave shoqërore. Ja disa vargje: "...Qeshi plaka ha, ha, ha, / N'dorën tanë paca ra, Tjetër gja Zotit si due, / Veç me ty me hokatuë. Fjalët s'vonojnë, ulet shamata, / Kuvendojnë plaku e plaka, / C'ka tha plaka, e tha plaku, / Në këtë jetë s'ka moshë merak". Vlera të tilla artistike kanë edhe këngët "Plaku i Lezhës ra n'dashtni", ose "Kanga e pijetarit". Vlera të veçanta ka edhe cikli i këngëve të mbledhura në vendlindje që autori i titullon "Kangë që këndohen edhe në Selitë", ku mbledhen një numër i kufizuar këngësh patriotike, dasme, dhe në vajë të krahinës ku ka jetuar, duke synuar që këta perla të folklorit tonë të ruhen dhe trashëgohen ndër breza. Jashtë vëmendjes së poetit nuk mbeten edhe figurat e njohura të artit dhe skenës që hodhën themelet e zhvillimit të letërsisë dhe kulturës në këto anë. Vargjet kushtuar poetit të paharruar Gjokë Beci, janë tepër prekëse dhe me vlera të veçanta emocionale, madje edhe ky vëllim duket si një homazh për poetin e madh: "...Amanet kam prej poetit, / Amanet Gjok Beci m'la, / Një zambak shkule prej shkrepit, / Falja qiellit mbi kala... Merr nje shkullm n'gurrat e thella, / Me legjenda e kangë motmotit, / I ka rujt Lokja ndër breza, / Si Kristal me pika lotit...". Edhe rapsodi i mirënjohur Fran Vorfi vjen në këtë vëllim i përkujtuar në disa vargje mjaft të bukura dhe me vlera, "Rend një shqipë n'qiell t'Ndërfanës, / I thotë diellit, i thotë hanës, / Dheut të Arbnit, tokës Zotit, / Nder i dha, kanga e Fran Vorfit. Zani i tij si valë kristali, / Si fllad bjeshtë e ushtimë mali, / Krah për krah me vllazën bashkë, / E ka shtang kalanë e lashtë...", duke e bërë rapsodin të kujtohet me nderim dhe respekt ndër breza.

Duhet theksuar se vepra më e fundit e poetit të mirënjohur Viktor Gjokolaj është prirur vazhdimisht në atë lloj poezie ku gërshetohet epika, lirikja dhe heroikja e popullit heroik të Mirditës. Në tërësi vepra dëshmon për një pasurim të figuracionit poetik që karakterizohet nga vecoritë estetike dhe mënyra direkte e shprehjes së mendimit që dallohet për fuqinë e jashtëzakonshme e mendimit artistik dhe të fjalës poetike dhe të muzikalitetit të vargut. Kësajsoji, poeti Viktor Gjokolaj është futur natyrshëm në radhën e krijuesve më të shquar të vendit tonë.

HISTORI DOSSIER



► Sam -2

► Sam -2 ne qender mesimore

► Raketat ne paraden e 20 nentorit

"Anija Vlora"

Si silleshin në kushte sekreti absolut raketat nga Kina në Durrës

NGA MARK BRUNGA

Enveri i tha inxhierit: Këto raketa janë blerë me florinjte e popullit!

Në vitin 1959 – 1960, kohë kur Shqipëria ishte anëtare e Traktatit të Varshavës, vëndi ynë u armatos me raketa moderne sovjetike, që e rritën fuqishëm potencën ushtarake mbrojtëse në raport me fqinjët potencialisht armiqësorë. Me ndërprerjen e mardhënjeve me BS, u ndërpre si për të gjitha furnizimet, edhe furnizimi me raketat e drejtuara kundërajrore Sam 2, krenaria e teknologjisë ushtarake të asaj periudhe që përbënin garanci për fuqizimin e mbrojtjes së Atdheut. Pas prishjes historike dhe largimit të turpshëm të sovjetikëve nga baza më e madhe ushtarake detare e mesdheut, raketat filluan të furnizoheshin nga shteti aleat më i ri, Kina. Transportin kryesor të tyre e kreu transoqeaniku "Vlora" i cili komandohej nga Kapiteni Qemal Hate, Hero i Punës Socialiste. I ndarë nga jeta disa vite më parë.

Raketa që vinin nga Kina, për shkak të distancës së gjatë, dhe moslejimit të mjeteve detare për këtë transport, nisehin në fshetësi të plotë duke qënë të çmontuara dhe të mbuluara me ngarkesa orizi në vaporr. Po ashtu edhe për avionet Mig të variantit kinez dhe armatime të tjera. Ardhja e tyre dhe vetë raketat që për atë periudhe ishin nga më modernet, qënë kthyer dhe mbeten ende pjesë krenarie kombëtare, sidomos pas largimit të trupave dhe anijeve sovjetike nga baza e Pasha Limanit. Punonjësit e Portit tregojnë se këto mallra të rëndësishme së veçantë janë shkarkuar vazhdimisht natën. Lidhur me transportin detar të raketave me anijen "Vlora" flet për suplementin "Rilindasi" dhëndërrin i Qemal Hates, edhe ky ish kapiten anije transporti, Ylli Bare, i cili thotë se transportin e raketave nga Kina e kreu anija "Vlora".

Misioni sekret i 2 nëndetëseve shqiptare nga Aleksandria në Durrës sa herë vinin ngarkesat me raketa nga Kina. Raketa e para nga Bashkimi Sovjetik i priten në Portin e Durrësit Enver Hoxha me Kadri Hazbiun

Kapiteni Ylli Bare tregon se anija, përveç rugetimit nga Kejpotauni, kalonte kryesisht nëpër Kanalin e Suezit dhe se për këtë anije shteti kishte gjetur kanale dhe u paguante autoriteteve të egjiptiane, dollarë me valixhe dhe

vaportit në pjesën fundore të tyre, nga 8 deri në 10 copë. Përveç tyre në vaporr transportoheshin tanke, topa deri aeroplanët reaktivë mig. Madje edhe aviatorët e parë ushtarakë që do të shkoni në Kinë për tu trajnuar shkuan me këtë

rrinte në radhë si anijet e tjera. Dhe duhet të kemi parasyshë se këtu kishte rrallë të madhe për të kaluar nga anijet e tjera, por anija jonë kalonte pa radhë, thekson Ylli. Në Egjipt duke qënë se dihej që kishte diplomatë dhe oficerë shërbimesh që rinë nëpër ambasadat e ndryshme, zakonisht praktika e mallit që transportohej deklarohesh se ishte ngarkesë me oriz dhe mekanizama bujqësore. Ngarkesa që mbulonte objektet ushtarake. Ndërkohë në guvertë lehohej që të organizoheshin deri mikropanaire nga tregtarët vëndas. Për pazarin siç i thonin, lehohej që të hypnin në guvertë 30-40 egjiptianë që vinin me varka për tu shitur gjësendi marinarëve. Ishte një manover e goditur psikologjike për të hequr cdo dyshim që mund të kishte ndokush për llojin e ngarkesës e për të qetësuar vëzhguesit e huaj, se anija nuk kishte ngarkuar gjëra të rëndësishme nga ato që dyshoheshin...Ndërkohë kur anija dilte nga Kanali, 2 nëndetëset tona e prisnin atë në afërsi të portit të Aleksandrisë dhe e shoqëronin me pas nëpër mesdhe gjatë gjithë rrugëtimin të mëtejshëm deri në gjirin



► Ylli Bare



► Ish Marinari Kajo Hima

anija i shpëtonte kontrollit të imtësishëm, që mund të rrezikonte ngarkesën strategjike që sillte në atdhe. Rreth këtij transporti me rëndësi të jashtëzakonshme politike dhe strategjike Ylli tregon se raketat futeshin në hambarët e

vaporr, rreth 17 vetë. U nisën nga Durrësi dhe u kthyen po me këtë vaporr sëbashku me avionet e parë nga më modernët të saj periudhe. Vetëkuptohet që avionët ishin të zmontuar. Duke qënë se paguhej për kalimin në Suez, "Vlora" nuk

e Durrësit. Rrugëtimi i nëndetëseve drejt portit të Aleksandrisë në Egjipt, rakordohej me nisjen e "Vlorë"-s nga Kina. Kur vinte në Durrës "Vlora" priste natën përsëri për tu futurë në portin, ku puna ishte e ndërprerë në të gjithë sektoret. Mjetet i shkarkonte ushtria natën dhe i transportonte më pas në kushtet e sekretit të plotë ushtarak për në destinacion. Zakonisht transportet ushtarake Kinë – Shqipëri, priteshin nga Mehmet Shehu, tregon Kapiteni Ylli.

SI ERDHEN RAKETAT E PARA SOVJETIKE NË PORTIN E DURRËSIT

Raketa e para të drejtuara kundërajrore erdhën nga Bashkimi Sovietik. Ardhja e tyre ishte tepër e rëndësishme për vëndin tonë pasi ishim shteti i 2-të në botë, pas BS që paiseshim me këtë teknologji moderne të sofistikuar për atë periudhë. Raketat e para kanë arritur në vitin 1959. Lidhur me këtë ngjarje shumë të rëndësishme, sipas ish-komandantit të repartit të raketave kundërajrore Lelo Leli, raketat e para tokë-ajër në Shqipëri, erdhën nga ish BS në muajin dhjetor 1959. Ato u pritën në portin e Durrësit dhe natën, me masa të rrepta ruajtje u transportuan në Pezë-Helmes. Atje, me kohë ishin ndërtuar baza e ruajtjes dhe e furnizimit të raketave, si dhe objektet e vendosjes së efektivit e aparatave radioteknike dhe shtretërit e lëshimit. Ajo u quajt qendra mësimore. Ndërsa baza e mbushjes u emërtua repartit teknik ose repartit 3700k. Ato kishin një gjatësi prej 10,88 metrash. Raketat që kanë qënë pjesë e armatimit të Mbrojtjes Kundër Ajrore të Ushtrisë Shqiptare nuk kanë pasur mbushje bërthamore, por kanë pasur vetëm mbushje luftarake, e cila kur shpërthente ndahej në 3600 copa. Peshja e tyre realative ishte reth 2 ton. Arsenali raketor i vëndit tonë përbëhej nga rreth 300 raketa të tipeve SAM-2, (sovjetike) si dhe HQ-1, HQ-2 të



▶ Leshimi i nje rakete

i peshkimit, për çdo raketë të shkarkuar shënonte një shënjë + në një paketë cigaresh diamanti. Qirjako Moçi që shkarkoi raketat e para që erdhën në portin e Durrësit ka punuar si vinxhier nga viti 1952 deri në vitin 1989 kur doli në pension. Ishte vinxhier më jetegjatë në Portin e Durrësit. Në të gjitha rastet e tjera kur vinin raketat nga Kina ato në port i priste Mehmet Shehu dhe Beqir Balluku.

KAJO HIMA ISH MARINARI I "VLORËS" TREGON

Kajo Hima është një marinar i vjetër. Ka punuar 38 vite në det. Nga këto vite, 9 prej tyre ai i ka kaluar në anijen "Vlora", dhe kujton momentet kur transportonte raketat si dhe objekte të tjera të rëndësishme ushtarake. Ai sjell në kujtesë se si edhe në Kinë raketat ngarkoheshin natën. Masat e sigurisë edhe atje ishin shumë të larta sidomos kur në port kishte anije sovjetike. -Na nxirrnin në Radë dhe prisnim që të binte nata për të hyre në port dhe ngarkoheshim. Hambarët e anijes kishin 3 kate. Në katin e poshtëm ngarkonim raketat dhe tanket që ishin të paketuara në arka. Ngarkesën e bragonim fort me kavo dhe me shumë kujdes me qëllim që në se gjatë lundrimit do të kishte furtunë ato të mos luhateshin dhe dëmtoheshin nga përplasjet që shkaktonin dallgëzimet e mëdha në oqean. Mbi armatimet e rralla ne hidhnim ngarkesa orizi dhe gruri. Që të maskonim udhëtimin me transportin e ushqimeve. Kur vinim në Durrës, "Vlora" po natën hynte në port për tu shkarkuar. Në kushte maksimale sigurie. Fike-

shin të gjithë dritat. Lejohej vetëm një koridor drite për shkarkimin ndërkohë punonjësit tradicionalë të portit kishin bllokuar turnin dhe shkoni në shtëpi. Po ashtu edhe policia. Në ato momente porti ruhej vetëm nga oficerë sigurimi të shtetit. Ndërsa ekuipazhi i anijes paisej me një lejë të posaçme dhe kur linim shërbimin kontrollohej nga oficerët e sigurimit që vëzhgonin gjithçka. Madje nga rigoroziteti i tyre, një natë pata edhe një incident me ta. Bëra një dush dhe u nisa me nxitim. Kur me kontrolluan u kerkova që të kthehem në anije për ta marrë lejen. Po ata s'më besuan dhe më dërguan direkt e në dhomat e izolimit të Degës së Punëve të Brëndëshme. Pas pak kohe u desh ardhja e Kryetarit të Degës Kopi Niko i cili më njihte dhe e zhblokoi situatën.

Kajo thotë se anija "Vlora" ishte nga më të mirat e flotës detare të vendit tonë me kapacitet transportues 12.600 ton. Ajo kishte vetëm një vit që ishte prodhuar, kur u ble në Xhenova të Italisë në vitin 1961, me rreth 4 milionë USD. Anija punonte edhe me solar. Sapo hyri në përdorim të flotës sonë tregtare, duke qënë se ishte piketuar për transportin e raketave dhe mjeteve të tjera ushtarake që furnizonte në atë periudhë shteti kinez, po në vitin 1961, stafi i saj u kompletua me oficerë të marinës luftarake. Anija kujtohet nga njohësit e saj dhe marinarët si një mjet detar shumë i fortë, pasi nuk kishte ndodhur të bënte asnjë defekt rrugës. Edhe kur kishte përballuar lundrime të gjata e tajfune në oqeanet që përshkonte.

në fshetësi të madhe dhe kanë qënë rreth 28 copë raketa tokë-ajër, të blera në BS. Ato kanë ardhur me me anije transporti ushtarake sovjetik. Vinxhier që i ka shkarkuar ato me vinçin e tij tip Ganz në port ka qënë një nga vinxhierët më të vjetër dhe më me përvojë në port Qirjako Moçi. Shkarkimin e tyre e ka ndjekur pranë vinxhit, vetë Enver Hoxha dhe Kadri Hazbiu. Enveri ishte i shqetësuar për përfundimin e operacionit të shkarkimit. Vinxhier kujtonte se Enveri i kishte shkruar te vinxhi dhe i kishte thënë: - Dëgjo Qirjako, këto raketa i kemi blerë me djersën dhe gjakun e popullit, me flori. Ndjaj duhet kujdes i madh-. Qirjako kujtonte se si kanë shkarkuar rreth 28 copë raketa atë natë. Po ka çfaqur edhe dyshime se ky shkarkim ishte vëzhguar nga ndonjë shërbim i huaj zbulimi pasi në një distancë të konsiderueshme një person që gjuante peshk me grep te moli



▶ Qirjako Moçi Vinxhier i qe shkarkoi raketat 1959



▶ Qemal Hate Kapiteni i vaborrit Vlora


prodhimit kinez. Ato vazhduan të jetë në shërbim të mbrojtjes së vendit deri në periudhën e shpërthimit të Gërdecit.

Raketat e para në Port i priti Enver Hoxha

Ish vinxhier i Portit të Durrësit që i ka shkarkuar këto raketa, ka lënë në kujtimet e tija para ndarjes nga jeta se raketat kanë arritur natën e 16 dhjetorit 1959 në portin e Durrësit. Ato janë shkarkuar



▶ Anija Vlora



▶ Nendeteset shqiptare

Kukësi shkatërron Partizanin, fiton edhe Skënderbeu

Të kuqtë shpartallohen 4-0 në Kukës, korçarët mundin me vështirësi Kamzën, fitojnë edhe Flamurtari e Luftëtari

Partizani ka regjistruar humbjen e dytë më të thellë këtë sezon. Pas humbjes 6-0 në Gjirokastrë, të kuqtë janë mposhtur dhe në Kukës me rezultatin 4-0. Një humbje që u jep fund shpresave për vendin e dytë, pasi Kukësi "arratiset" me 9 pikë, kur mbeten edhe 7 javë kampionat. Sidrit Guri ishte protagonist i takimit në Kukës, teksa ka shënuar 3 gola, të parin, të tretin dhe katërtin, i fundit një perlë e vërtetë. Pjesa e parë ka përfunduar

3-0, me Partizanin që është shturur totalisht.

LUFTETARI-LAÇI 2-1

Luftëtari ka marrë një fitore mjaft të vyer përballë një rivali direkt si Laçi. Gjirokastritët kanë fituar 2-1 në shtëpi ndaj kurbinasve, duke u marrë vendin e katërt dhe tashmë janë vetëm 1 pikë larg Partizanit të vendit të tretë. Bregu dhe Shkurtaç ishin shënuesit e golave për Luftëtarin, ndërsa Sefgjini ngushtoi diferencën për miqtë në mesin e pjesës së dytë. Githsesi, gara për

Europën nuk ka mbaruar për këto dy skuadra.

LUSHNJA-FLAMURTARI 0-2

Një fitore me rëndësi ka marrë edhe Flamurtari, që rikthehet të suksesi pas 7 ndeshjeve. Vlonjatët fituan 2-0 në Lushnjë dhe largojnë rrezikun e rënies nga kategoria, madje kanë shpresa për një vend në Europë.

SKENDERBEU - KAMZA 3-2

Bollëk golash në ndeshjen e parafundit të javës së 29-të të Kategorisë Superiore në

futboll mes Skënderbeut dhe Kamzës, sfidë e luajtur në Korçë dhe e përfunduar 3-2 për vendasit. Gjatë pjesës së parë janë shënuar 4 gola, teksa golave të Muzakës dhe Sowe-s, u janë përgjigjur Rezi dhe Zguro në limit. Goli i futbollistit të Kamzës nga goditja e dënimit ishte "korniza" më e bukur për 45 minutat e para. Pjesa e dytë i ka rikthyer menjëherë avantazhin korçarëve, teksa James ka shënuar golin që vulosi fitoren e Skënderbeut. Miqtë kanë pretenduar për



një penallti, por nuk ka qenë i të njëjtit mendim arbitri. Në Korçë ka pasur edhe një ceremoni sa i përket titullit

kampion, jo të këtij sezoni, por të atij të vitit 2016, kur dje CAS i ka dhënë të drejtë dhe ia ka rikthyer Skënderbeut.


KATEGORIA E PARË

Tirana e Kastrioti sigurojnë ngjitjen në Superligë

KF Tirana ka siguruar dhe kalimin matematikisht në Superligë pasi fitoi 3-2 ndaj ekipit të Pogradecit. Në këtë mënyrë klubi bardheblu është rikthyer mes më të mëdhenjve të futbollit shqiptar, pas rënies dramatike në Kategorinë e Parë vjet, për herë të parë në historinë e skuadrës. Në këtë mënyrë, duke nisur nga viti

i ardhshëm, tifozët do të mund të shohin sërish derbin e flaktë të kryeqytetit Tirana-Partizani.

Kategoria e Parë ka dhënë verdiktin edhe për skuadrën e dytë që do të ngjitet në Superiore. Kastrioti ka fituar me rezultatin 3-0 përballë Besëlidhjes, duke kaluar në këtë mënyrë matematikisht në Kategorinë Superiore.



SPANJE

Barcelona me rekord të ri në La Liga pasi mund Valencian

Barcelona ka vënë një rekord të ri në kampionatin spanjoll. Katalanasit ka lënë pas shpine eliminimin e hidhur ndaj Roma në çerekfinalin e Champions League dhe prek me njëren dorë titullin në La Liga, pasi ka fituar 2-1 ndaj Valencias në "Camp Nou". Kur u mbush çerekore lojë, katalanasit kaluan në avantazh me anë të Luis Suarez. Sulmuesi nga Uruguaji tundi rjetën, pas pasimit "të artë" nga Coutinho, duke realizuar golin e tij të 10-të kundër Valencias, të cilës i ka shënuar më shumë se çdo ekipi tjetër. Ky ishte goli i 23-të i Suarez në këtë kampionat, aq sa Cristiano Ronaldo, gjashtë më pak se

Messi. Sapo nisi pjesa e dytë, Samuel Umtiti shënoi golin e dytë për Barcelona, sërish nga një krosim i Coutinho, ndërsa përgjigja e Valencia, vendi i tretë në La Liga, e gjeti golin e nderit me penallti, katër minuta para fundit, pas faullit të shkaktuar nga Ousmane Dembele. Penalltinë e ktheu në gol Dani Parejo. Kur mbeten edhe gjashtë javë nga fundi, Barcelona ka 14 pikë më shumë se Atletico Madrid e vendit të dytë, që nesër do të presë Levante. Barcelona theu rekordin në La Liga me 39 ndeshje pa humbje, rekord që ishte vënë në vitin 1980 nga Real Sociedad.

Formula 1

Ferrari dominon provat në garën e Kinës, Vettel niset i pari

Dominimi i Ferrarit në provat kualifikuese të Çmimit të Madh të Kinës që përkon edhe me garën e tretë të Botërorit të F1. Në një mot në ftohtë ai që ka dhënë kohën më të shpejtë në pistën e Shanghai ka qenë gjermani Sebastian Vettel që ka firmosur një xhiro fantastike me rekordin 1'31"095.

Ndërsa nga vendi i dytë në garën e sotme do të niset Ferrari tjetër ai i Kimi Raikkonen. Ndërsa pas dy makinave Ferrari që do të jenë të parat në start vijonë makinat Mercedes me Bottas që do të niset nga pozicioni i tretë dhe më pas Hamilton. Gara e Shanghait është e treta e këtij Botërori dhe nis në orën 08:10 me orën shqiptare.



**OFERTË
PUNËSIMI**

Kompania mediatike Shqiptarja.com
kërkon të punësojë agjent
marketingu që plotëson
kriteret e mëposhtme :

TË KETË
ARSIM
TË LARTË

VLERËSOHET
TË KETË NJOHURI TË
GJUHËVE TË HUAJA
DHE TË KETË
PËRVOJË PUNE

TË JETË I
GATSHËM PËR
TË PUNUAR
NË TEREN

PERSONAT E INTERESUAR TË
DËRGOJNË CV E TYRE NË KËTË ADRESË:
marketing@shqiptarja.com

[SH]
.com



FJALËKRYQI PA SKEMË

DUHET TË NXINI 35 KUTI

17x17 grid for the crossword puzzle.

HORIZONTAL

- 1. Eshhtë pjesë e romanit -Eshhtë ... fare Top Channel. -Fillojne sefte. 2. Janë vargmale në Itali. -Fillojë muzikën. -Sillen pergjysme 3. Griffith aktore. -Eshhtë dimension. 4. Eshhtë nusja me vello -Ford qe Interpretin Idiana Jones. 5. Kujtohet me nostalgji në Pleqëri. -Nje S ne LSI. 6. Një sulm kardiak. -Udhëtojnë për qeif. 7. Eshhtë legjenda. -Qe kambist dikur. -Fillojnë tjetrën -Gjysme sadist 8. Në krye të avokatëve. -Eshhtë borxh. -Mondrian piktor. -Fillojne titrat 9. Unë dhe ti. -Morisette këngëtare. -Parajsa e humbur. 10. Hanks aktor. -Kështu është lëvizja në konfuzion. -Ka shume i pasuri 11. Një simbol lëkurëkqsh -El Kun te Manchester City 12. Këndon English man in New York.

PËRGJIGJE E FJALËKRYQIT PA SKEMË

Grid with filled-in words for the crossword puzzle.

-Studion të bukurën. -Me te nxjerrin trare.

VERTIKAL

- 1. Një specialist për zoom. -Në fund majtas. 2. Një pije për oreks. 3. Janë për të mbështjellë foshnjat. -Motiv pa kufij. 4. Gjysma e inatit. -Diku në qendër. -Matt aktor.

5. Kurti aktore. -Një pjesë e seleksionimit. -Ekstre me treg. 6. I vetmi në orar. -Janë fletët e letrave. 7. Tommy... Jones aktor -Shteti me Paramaribo. 8. Kufizojnë lëvizjet. -Nelson që ra në Trafalgar. 9. Janë kundër luftës. 10. Michelangelo, alias Caravaggio 11. Janë pjekjeje.

- Nganjëherë duhen vënë mbi i. 12. Thirrej nga tekllalli -Vegim pa ekstreme. 13. Bëhet një duke rralluar degët e pëmës 14. Një sinjal dramatik. -Më shumë se shumë. 15. Qe skuadra e Pelé-së. -Eshhtë vegël... rrethimi. 16. Sikur jane ne krye -Eshhtë kujdesi i babait 17. Kazan regjisor. -Dashurohet nga Nemorino

FJALËKRYQI SPORTIV

Grid for the sports crossword puzzle with images of athletes.

PËRGJIGJE E FJALËKRYQIT SPORTIV

Grid with filled-in words for the sports crossword puzzle.

HORIZONTAL

- 2. Gabim pa ekstreme 5. Hapin seancën. 7. Kufizojnë punimet. 9. Lloj njeriu. 10. Janë në qendër. 11. Janë në temë. 12. Janë Bob për të rrëshkitur. 13. Merret me të bukurën. 15. Ben i interpretuar nga Charlton Heston. 16. Alexis te Arsenal. 18. Fillojnë bastisjen 20. Një kërcim në atletikë. 23. Kurora pa zanore 24. Lidh brigje.

- 25. Ushtrohet edhe ajo fizike. 26. Kalime në ekstreme. 27. Pak amoralitet. 28. Fillojnë sintaksën. 29. Pausini këngëtare. 30. Sergio te Real Madrid. 34. Eshhtë i lartë ai i kampionit. 35. Personazhi në foto. 43. Tom Hanks. 44. Personazhi në foto

VERTIKAL

- 1. Gerulaitis që qe tenist. 3. Janë komunitetet. 4. Luan derby me Milan 5. Një lojë me games. 6. Sanchez tenist. 7. Një qumshq që... duhet shkundur. 8. Eshhtë skuadra bardheblu. 9. Ela e volejbollit. 12. Ramadan trainer. 13. Inicialet e Cantona. 14. Pound që qe poet. 17. Ndodh në kufij. 18. Alban trainer i kuqezinjve U 21 19. Eshhtë për medaljen e kampionit. 21. Radha pa cifte. 22. Fillojnë panikon. 26. Eshhtë triplikësh një nga distanca. 30. Mbyllin një hark. 31. Oerter që hidhte diskun. 32. Juan mesfushor spanjoll. 33. Hamm ish-futbollsite amerikene 36. Luis Pasteur. 37. Qendër në tour. 38. Ndal në kufij 39. Fillojnë një lojë 40. Ilir Daja 41. Jo ai 42. Antonio Banderas

SUDOKU

PLOTËSONI VENDET BOSH NË MËNYRË QË ÇDO RRESHT E KOLONË TË KETË NUMRAT NGA 1 9

9x9 Sudoku grid with some numbers filled in.

9x9 Sudoku grid with some numbers filled in.

HOROSKOPI

DASHI

Ngarkesa juaj erotike dhe një dëshirë e madhe për të bërë sot do të jenë më të mëdha se zakonisht. Kushtojni më shumë vëmendje partnerit/ës i/e cili/a do t'ju përgjigjet menjëherë kërkesave tuaja! Beqarët do të përhapen nga aq shumë energji dhe do të vazhdojnë me iniciativa interesante. Kujdes nga çështjet financiare, fati mund të mos jetë në anën tuaj. Jini të kujdesshëm.

DEMI

Do të jetë një ditë e bukur për çiftet, edhe pse me disa keqkuptime të vogla me siguri nuk do t'ju prishin harmoninë. Jini të qartë dhe të sinqertë, partneri/ja duhet të jetë në gjendje t'ju besojë. Beqarët do të duhet të dëgjojnë zemrën para se të heqin dorë nga një person. Mos nxitoni të vendosni dhe merrni kohën e duhur për të kontrolluar çdo aspekt të biznesit tuaj.

BINJAKËT

E enjte e mbarë për çiftet, shumë projekte në horizont për ata që duan të formalizojnë një bashkim. Shumë dashuri do të lulëzojnë përtej pritjeve. Për beqarët, rrugë të reja po hapen, të gjitha emocionuese, për të jetuar aventura vërtetë të bukura. Ju do të jeni të patëmët si gjithmonë dhe në gjendje të përfundoni me sukses çdo negociim. Shpërblime të shkëlqyera në horizont.

GAFORRJA

Nuk është një kohë e mirë për takimet romantike, të duhet pak kohë për të reflektuar më mirë mbi çështjet që janë pranë zemrës suaj. Beqarët mund të kenë nevojë për siguri më emocionale nga njerëzit e besuar. Jini të qetë në disa çështje të punës dhe prisi kohën e duhur për të avancuar idetë tuaja.

LUANI

Nëse jeni xheloz, kjo mund të shkaktojë keqkuptime të bezdisshme në çift. Për fat të mirë, pagja do të jetë e menjëhershme dhe marrëdhënia do të kthehet më e mirë se më parë. Për beqarët është një ditë me fat dhe ata mund të kenë përvoja të reja dhe takime të mrekullueshme. Një fatkeqësi në punë ka të ngjarë të prishë ekuilibrin e të ardhurave. Mos i kushtoni vëmendje zilisë së kolegëve.

VIRGJËRESHA

Gjatë kësaj dite ju nuk do të dini se në cilën mënyrë do të ktheheni: keqkuptimet, gëzimet, ndjenjat e përziera do t'ju sulmojnë dhe do të jeni paksa të hutuar! Për beqarët çështjet që duhet të përcaktohen do të jenë aq shumë sa që nuk do të dinë se çfarë të bëjnë më parë! Mundohuni të kapni mundësitë më të mira që do t'ju ndodhin. Përfitoni nga përvojat e kaluara.

PESHORJA

Lufta për atë që besoni: nëse mendoni se marrëdhënia juaj mund të ketë një të ardhme, mos i braktisni armët, por vazhdoni të kuptoni ndjenjat tuaja. Zemrat e vetmuara do të jenë në gjendje të fillojnë një udhëtim të ri dhe ndoshta do të njohin një person të veçantë. Mundohuni të bëni një diskutim pune në favorin tuaj dhe të kontrolloni përfitimet e veprimt tuaj. Ju do të godisni në shenjë.

AKREPI

Dëshira për të filluar besimin dhe shpresën në dashuri sot do të bëjë që ju të jetoni një ditë plot emocione. Por mos besoni se të gjitha ato shkëlqime janë ar, kini kujdes për zhgënjimet! Beqarët do të duhet të përgatisin zemrat e tyre për dashuri të reja, yjet janë në favor. Mos i kushtoni vëmendje fatit të papritur, ai do t'ju ndihmojë të merrni përsëri frenat e situatës suaj të punës.

SHIGJETARI

Mos u fiksoni me idetë e ankthit dhe shqetësimet, por përpiquni të kënaqeni me partnerin/en tuaj duke blerë ose duke ngrënë drekë jashtë. Beqarët mund të marrin një surprizë të këndshme që do t'u lejojë atyre të marrin një vendim të rëndësishëm. Perspektiva të shkëlqyera për të përmirësuar pozicionin tuaj në punë. Sot ju do të jeni në gjendje të shfrytëzoni mundësitë të mira.

BRICJAPI

Nuk keni më dyshime për partnerin/en, sot ju do të keni një mendje të lirë dhe mund të bëni projekte në çift pa frikën se gjithçka do të zhduket. Venusi mbron marrëdhënien tuaj! Beqarët do të gjejnë një miqësi që duket e humbur, një sqarim do të jetë vendimtar! Në sferën e punës, prit një ndryshim. Duke pasur parasysh ndryshimet e reja, rezultatet do jenë pozitive.

UJORI

Ju do të mbyteni nga shumë emocione që do të krijojnë harmoni në marrëdhënien tuaj. Duket se më e keqja është larg, shijoni këtë afat të bukur. Beqarët do të kenë mundësi të shkëlqyera për të gjetur dashurinë, mos lejoni që ju të kapërceheni nga hutimet. Sot do të jeni të sigurt dhe optimist dhe nëse duhet të jepni një intervistë pune, do të merrni atë prisi.

PESHQIT

Në dashuri sot nuk do të keni kohë për t'u mërziur. Gjendja nuk do të jetë shumë e mirë, por ju do të përpiqeni ta mbani nën kontroll. Marrëdhënie e mirë me të dashurin/en. Beqarët do të jenë të hutuar nga shumë gjëra, ndoshta do të ishte e përshtatshme që të përqendrohni në një çështje të vetme. Ka shumë angazhime dhe pak hapësirë për një pushim!

FJALËKRYQI I KRIPTOGRAFUAR

Grid for the cryptogram crossword puzzle.

PËRGJIGJE

Grid with filled-in words for the cryptogram crossword puzzle.

SHKRONJA E NJËJTË PËR NUMËR TË NJËJTË

VENDE UNIKE PËR TË VIZITUAR! THE MOST UNIQUE PLACES TO VISIT!



BUNK'ART 1

- Ekspozita video-muzeale e periudhës së komunizmit në Shqipëri e ndërtuar brenda bunkerit anti-bërthamor të Luftës së Ftohtë

- The video-museum exhibition of Albania's communist era build inside the anti-nuclear bunker of the Cold War



BUNK'ART 2

- Ekspozita e parë video-muzeale e ndërtuar në kujtim të viktimave të terrorit komunist


- The first video-museum exhibition built in memory of the victims of the communist terror



Ku ndodhet BUNK'ART 1?

Rr. Fadil Deliu
(afër teleferikut) - Tiranë

ORARI: 09:00 - 16:00 të hënë & të martë pushim



Ku ndodhet BUNK'ART 2?

Rr. Abdi Toptani
(përballë Bashkisë) - Tiranë

ORARI: 09:00 - 18:00 çdo ditë

www.bunkart.al / info@bunkart.al

Prenotime / Reservations: +355 (0) 67 20 72 905

